Raport

Balkans Group-Research and Policy for peacebuilding
and statebuilding in Southeast Europe.

Integrimi i Serbëve në Kosovë Pas Marrëveshjes së Brukselit

19 Mars 2015

www.balkansgroup.org

Integrimi i Serbëve në Kosovë
Pas Marrëveshjes së Brukselit

Ky raport është financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Norvegjisë.

Deklarim:

Këndvështrimet dhe analizat e këtij raporti, janë vetëm të Grupit për Ballkan të Ballkanit, dhe nuk pasqyrojnë këndvështrimet e donatorëve.

Autorë: Marko Prelec dhe Naim Rashiti

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... **I**
REKOMANDIMET ..... **IV**
HYRJE **2**
SERBËT NË PJESËN VERIORE TË KOSOVËS **5**
PJESA VERIORE E KOSOVËS 7
KOMUNAT E KOSOVËS JUGORE 9
ENKLAVAT NË ZONAT ME SHUMICË SHQIPTARE 11
INSTITUCIONET E SHTETIT **14**
BEOGRADI NË KOSOVË 15
ADMINISTRATA QENDRORE 17
KËMBËNGULJA E PARALELIZMIT NË QEVERISJEN LOKALE 20
ORIGJINAT E INSTITUCIONEVE KOMUNALE SERBE 22
HUTIM NË PJESËN VERIORE TË KOSOVËS 23
POZITAT E DYFISHTA NË PJESËN JUGORE TË KOSOVËS 24
SEKTORI PUBLIK SERB 25
INTEGRIMI I ADMINISTRATËS LOKALE 28
GJYKATAT, DREJTËSIA DHE POLICIA 30
ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE **33**
THEMELET LIGJORE 36
ARKITEKTURA E ASOCIACIONIT 40
SPEKTRI I NDARJES 43
PËRFUNDIMI **45**
SHTOJCA A: PËRLLOGARITJA E POPULLSISË SERBE **47**
SHTOJCA B: KRAHASIMI MIDIS RS DHE ASOCIACIONIT **50**
SHTOJCA C: NJË SHËNIM PËR EMRAT **51**

Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit

Përmbledhje ekzekutive

Kosova dhe Serbia kanë filluar një detyrë të madhe, e ajo është integrimin e serbëve të Kosovës dhe të infrastrukturës administrative dhe financiare të Beogradit në territorin dhe sistemin e Kosovës – thënë shkurtë, "integrimin e serbëve". Ky është rezultat i një marrëveshjeje të arritur me shumë vështirësi me ndërmjetësimin e BE-së dhe e cilësuar si ndër arritjet më të mëdha të Brukselit. Megjithatë, implementimi i saj ka qenë dhe vazhdon të jetë tepër sfidues. Integrimi po zgjon emocione të thella tek shqiptarët dhe serbët, dhe keqkuptimet e vogla mund shumë lehtë të prodhojnë reagime të dhunshme. Numri i institucioneve të cilat i përfshinë integrimi – pushtetet lokale, shkollat, kujdesi shëndetësor, gjykatat, shërbimet e sigurisë dhe të tjera, të cilat operojnë me disa qindra miliona euro – e bën misionin sfidues. Nuk ekziston ndonjë precedent, praktike apo udhëzues që duhet zgjedhur. Prishtina dhe Beogradi e filluan këtë proces për arsye të ndryshme, e para për të përforcuar sovranitetin dhe integritetin territorial, kurse e dyta për ta kënaqur BE-në. Asnjëra prej tyre nuk janë në nivel të detyrës, apo duan të investojnë kapitalin e tyre politik e financiar. Me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, Kosova dhe Serbia duhet të vënë një pikësynim të integrimit të plotë të serbë brenda sistemit të Kosovës deri në fund të vitit 2015 dhe të përparojnë më shpejtë në bërjen e marrëveshjes së tyre realitet.

Raundet e mëparshme të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke filluar nga bisedimet për "statusin përfundimtar" të udhëhequra nga OKB-ja ne vitin 2005 e deri tek "dialogu teknik" i ndërmjetësuar nga BE më 2011, patën një fillim premtues por hasën në pengesa. Prishtina deklaron se të drejtat e serbëve i kanë negociuar disa herë, me Beogradin që vazhdimisht kërkon më shumë mirëpo në shkëmbim jepnin shumë pak apo fare, dhe pa një përfundim të suksesshëm. Beogradi thotë se të gjitha koncesionet kanë ardhur nga ana e tyre, derisa Kosova vendos çështjen e statusit – njohjen e pavarësisë së saj – në çdo temë diskutimi. Të dy palët tentojnë vazhdimisht që të fitojnë simpatinë e ndërmjetësve të BE-së. Janë disa çështje të rëndësishme: pjesëmarrja e serbëve në institucionet e Kosovës, përfundimi i ndërhyrjes së Serbisë brenda territorit të Kosovës, qasja e Kosovës në arenën ndërkombëtare, dhe çështjet e luftës së vitit 1998/9. Qëllimi kryesor është që Kosova dhe Serbia të bashkëpunojnë normalisht, si dy fqinjë të mirë, dhe që secila të trajtoj me respekt popullatën minoritare të tyre. Marrëdhënia bilaterale është çelësi dhe do të vendos suksesin e integrimit.

Risku është i lartë për të gjithë të përfshirët, dhe ky proces nuk është mjaftë mirë i kuptuar në terren. Një konfrontim i vogël ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Gjakovë më 6 janar dhe një deklaratë e pakujdesshme dhe provokative nga një ministër serb bëri që, një muaj më vonë, të organizohen protesta në Prishtinë, të shkarkohet një ministër serb dhe parlamentarët

serb të bojkotojnë institucionet, siç po vazhdon edhe gjatë kësaj periudhe.. Shqiptarët nuk durojnë rolin e Beogradit në shtetin e tyre dhe kontestimin e pavarësisë së tyre; një pjesë e madhe e njerëzve gjithashtu irritohen nga keqmenaxhimi për vite të tëra nga një elitë e pandryshuar politike. Serbët po transferohen nga njëri shtet në tjetrin dhe iu frikësohen pasojave. Suksesi apo dështimi i integrimit serb mund të reflektoj tek shtetet multi-etnike fqinje.

Komuniteti serb i Kosovës mund të ndahet në tri grupe të dallueshme. Veriu i Kosovës është një zonë serbe homogjene që i ka rezistuar autoritetit të Prishtinës që nga viti 1999; shumica e banorëve në atë pjesë kanë pak apo nuk kanë fare përvojë me shqiptarët apo qeverinë e Kosovës dhe i shikojnë që të dyja me frikë dhe mosbesim. Institucionet serbe ishin, deri vonë, të vetmet organe qeverisëse në atë zonë. Grupi i dytë përbëhet prej gjashtë komunave me shumicë serbe të shpërndara përgjatë pjesës tjetër të shtetit; shumica e serbëve këtu i binden ligjeve të Kosovës por gjenden në listat serbe të pagave në një mënyrë apo tjetër. Grupi i tretë janë serbët që jetojnë nëpër fshatrat dhe lagjet e shpërndara diku nëpër Kosovë. Në mungesë të kontrollimit të një pushteti komunal dhe shërbimet e dëshiruara që ato mund të ofrojnë, ata gjithashtu mbështeten shumë në institucionet serbe.

Të gjithë serbët e Kosovës kanë disa shqetësime thelbësore. Gjetja e një vendi pune zë vend të rëndësishëm - siguria e vendeve serbe të punës që shumica i kanë, dhe mundësia e alternativave në momentin që atyre vendeve të punës u vjen fundi. Tregu i punës nuk është i hapur për ata. Punëtorët e moshuar janë të merakosur nëse duhet të qëndrojnë në skemën e pensioneve të Serbisë. Qasja në sistemin e kujdesit shëndetësorë të Serbisë – klinikat e saj, spitalet në Kosovë, rekomandimet për kujdestar specialist në Serbi dhe skemën e saj të sigurimeve – është shumë e rëndësishme. Familjet mbështeten tek shkollat serbe, dhe studentët kanë nevojë që të marrin diploma që do të nderohen çoftë nëse mbesin në Kosovë apo zhvendosen në Serbi. Nëse nuk iu mundësohet edukimi serb ata do të largohen. E fundit, sigurimi fizik është një shqetësim. Serbët e enklavave janë veçanërisht të cenueshëm ndaj kërcënimeve dhe sulmeve rastësore.

Gjatë vitit të fundit, shumë zyrtarë lokal serb kanë luajtur lojë të dyfishtë, duke fituar zgjedhjet për t'u vendosur nëpër zyret e qeverisë së Kosovës dhe në anën tjetër duke u emëruar në pozita të tjera në rrjetin e komunave paralele të Serbisë. Kjo bashkëjetesë dallon në detaje por ekziston në të gjitha zonat me shumicë serbe. Sistemi paralel serb ka shumë pak fuqi efektive qeverisëse, por ka në dorë një fuqi financiare shumë më të madhe; mbulon një pjesë të madhe të Kosovës dhe punëson dhjetëra mijëra serb. Pagat e fryra për arsye politike – përmes të cilave Beogradi i ka mbajtur serbët e Kosovës të qetë dhe besnik – dhe pas 15 viteve ajo popullatë është e varur nga ato vende pune. Disa punojnë drejtpërdrejt për komunat paralele; shumë më shumë për kompanitë publike dhe institucionet që ata administrojnë; dhe një pjesë tjetër nëpër shkolla dhe spitale që udhëhiqen nga Beogradi. Beogradi duhet që së shpejti të mbyllë institucionet e saj dhe transferimi i punëtorëve të tyre nga listat e pagave serbe në ato të Kosovës do të jetë një detyrë e kushtueshme dhe shqetësuese.

Beogradi dhe Prishtina zgjodhën që të modelojnë marrëveshjen e tyre rreth një lloj entiteti hibrid, një Asociacion i komunave serbe. Kanë kaluar pothuajse dy vite që prej arritjes së marrëveshjes dhe ende nuk ka shumë qartësi për rolin dhe organizimin e saj, por është jetësore për projektin e integrimit. Ka gjasë që për shumë vite të mbetet vetëm si punë në progres, derisa serbët të gjejnë vendin e tyre në Kosovën e pavarur, dhe Prishtina dhe Beogradi të zhvillojnë dhe thellojnë marrëdhëniet e tyre. Mirëpo përkufizimet e integrimit dhe të Asociacionit duhet të caktohen së shpejti. Si pikë fillestare do të jenë provizionet e Planit të Ahtisaarit, Marrëveshja e Brukselit dhe ligjet e Kosovës. Në esencë, kjo u mundëson serbëve që të ushtrojnë shumë prej fuqive komunale të tyre së bashku, përmes një asociacioni të përbashkët – nëse ata zgjedhin. Në disa fusha, veçanërisht edukimi dhe shëndetësia, iu mundëson serbëve që me më shumë efikasitet të ushtrojnë fuqitë që tashmë ata kanë; nuk ka të bëjë me ofrimin e më shumë fuqive për ta. Beogradi nuk duhet që të tentoj të bëjë këtë institucion të dobët të bartë më shumë peshë se sa që mundet. Komuniteti nuk është një zëvendësim për integrim, ose për marrëdhënie të shëndetshme bilaterale me Prishtinën.

Implementimi ka nevojë që të organizohet nëe disa fronte dhe të tejkaloj një numër pengesash, disa prej tyre politike. Kosova dëshiron që të filloj implementimin një nga një, duke filluar me heqjen e strukturave të sigurisë dhe komunave paralele të formuara nga Serbia, dhe më pastaj të vazhdoj me formimin e Asociacionit. Agjenda e Serbisë parasheh të kundërtën e kësaj, dhe fillon me Asociacionin, e më pas heqjen e institucioneve serbe. Gjithë ky konflikt mbi sekuencën e ngjarjeve që duhet të ndodhin vetëm sa ka zgjatur vonesën. Megjithatë, ende ka shumë gjëra që mund të kryhen njëkohësisht, dhe hapat e hershëm që do të ndërmerren do të rrisin besimin. Serbia duhet që menjëherë të shpërbëjë Mbrojtjen Civile, gjykatat dhe institucionet e tjera të sigurisë që ende janë aktive dhe të inkurajojë personelin e tyre që të pranojnë pozitat e ofruara nga sistemi i Kosovës. Pjesëmarrja e plotë e serbëve në institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë është një etapë jetësore. Në të njëjtën kohë Beogradi duhet të filloj një rishikimin të listave të tyre të pagave, duke filluar me komunat paralele. Paralelisht me këtë duhet të ndodhin edhe bisedimet për finalizimin e statutit të Asociacionit, duke përfshirë përfaqësues të dhjetë komunave anëtare. Integrimi i sistemit të edukimit dhe të kujdesit shëndetësor mund të zgjas më gjatë, dhe mund të përfshijë një rol në Asociacion..

Të dy palët e lidershipit të serbëve të Kosovës – ministrat dhe parlamentarët në Prishtinë dhe kryetarët dhe asamblistët e komunave – duhet të punojnë shumë në mënyrë që integrimi të ketë sukses. Kosova ka bërë një zgjedhje strategjike të përkrahur edhe nga miqtë e saj ndërkombëtar që të besoj tek Beogradi në dorëzimin e serbëve lokal tek rendi ligjor i Kosovës; kjo funksionoi dhe i dha fund shqetësimeve disa vjeçare, por në të njëjtën kohë krijoi një elitë të re serbe që është disi pa përvojë dhe shumë e varur nga Beogradi. Serbët e përzgjedhur do të duhet që të ndërtojnë një rol për vetvete, një identitet që shkon përtej te qenit shërbëtorë besnik të Serbisë dhe përqendrohet tek popullata që i zgjodhi ata. Ata do të duhet të mësojnë që të veprojnë në sistemin parlamentar që iu ofron atyre mundësi të shumta, fuqi, përfshirë veton mbi amendamentet kushtetuese dhe një rol të rëndësishëm në ligjvënie. Në qeveri, serbët kanë arritur që të vendosen nëpër ministritë që më së shumti

ndikojnë në komunitetin e tyre, por nuk do të duhej që të injoronin portofolet e tjera. Detyrë për ta gjithashtu është edhe bashkimi i serbëve të veriut dhe të jugut dhe të krijojnë politika të përbashkëta për të ardhmen e tyre brenda territorit të Kosovës.

Për pjesën më të madhe të serbëve, institucionet e vetëqeverisjeve lokale dhe vendet e punës që ato ofrojnë janë jetësore. Integrimi i tyre nënkupton bashkimi i listave lokale të pagave të Serbisë me buxhetin e Kosovës – një detyrë e komplikuar, meqenëse shpenzimet e Beogradit nuk janë transparente. Ka nevojë për një audit të thellë në mënyrë që të kuptohet se kush gjendet në atë listë dhe çfarë kosto ka në përgjithësi. Kjo padyshim që do të shpaloste manipulime dhe shpenzime thjeshtë të panevojshme, për shembull për punëtorët teorikisht nga Kosova që jetojnë diku në Serbi; këta duhet të hiqen menjëherë. Komunat me shumicë serbe duhet të punësojnë pjesën e mbetur të serbëve të papunë. Qëllimi do të duhej të ishte për përfundimin e këtij procesi dhe shpërbërjen e sistemit paralel serb deri në fund të vitit 2015. Si rezultat i kësaj do të ishte pezmatimi i qeverisjeve lokale me shumë dublifikime, por kjo është hap i parë i nevojshëm. Prishtina duhet të rris buxhetin për këto komuna por nuk mund të mbajë mbi supe gjithë peshën e kësaj; Beogradi do të duhej të paguante pjesën e mbetur për komunat përmes transfereve transparente. Duke filluar që nga viti 2016, listat e integruara lokale të pagave do të duhej të zvogëlohen dhe të racionalizohen, me fonde të mjaftueshme të shpërndara për ri-trajnime dhe masa për krijimin e vendeve të punës në sektorin privat.

Koordinimi dhe investimi i kapitalit politik është i nevojshëm. Qeveria e Kosovës ka qenë e prirë që të kujdeset për çështjet serbe përmes ministrisë së saj për vetëqeverisjen lokale, e cila ka arritur shumë duke marrë parasysh burimet modeste të saj. Mirëpo, faza e radhës e integrimit duhet të jetë një qasje gjithëpërfshirëse e qeverisë e mbështetur me mjete të mjaftueshme financiare. Beogradi ka kontrolluar serbët e Kosovës dhe duhet të fillojë që t'i lërë të lirë në mënyrë që ata të zgjedhin vet rrugën e tyre. Do të duhej ta respektonte Prishtinën si një partner të barabartë. Lidershipi lokal serb e njeh komunitetin e tyre më mirë se kushdo në Beograd, Prishtinë apo Bruksel, dhe mirëqenia e tij është përgjegjësi e tyre. Për ta siguruar atë, ata do të duhej të pranonin mbështetjen vëllazërore të Serbisë por të bashkëpunonin me liderët shqiptar në ndërtimin e të ardhmes së përbashkët në Kosovë.

Rekomandimet

Kosova, Serbia dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të vendosin një pikësynim për integrimin e plotë serb – që nënkupton një paketë e vetme ku përfshihen institucionet komunale të Kosovës, një Asociacion funksional i komunave serbe dhe një pajtim i plotë i serbëve me termat e Planit të Ahtisarit, ligjit të Kosovës dhe Marrëveshjes së Brukselit – deri më 1 janar 2016. Për të arritur këtë,

Parimet udhëzuese për qeveritë e Kosovës dhe Serbisë dhe për komunitetin ndërkombëtarë:

Integrimi në nivel lokal duhet të avancojë në hap me rritjen e pjesëmarrjes së serbëve në institucionet qendrore; vetëqeverisja lokale dhe Asociacioni nuk do të duhej të tërhiqnin serbët nga institucionet qendrore në Prishtinë.

Puna rreth formimit të Asociacionit nuk do duhet të vonojë integrimin e komunave me shumicë serbe si dhe të institucioneve të tjera.

Integrimi me gjasë do të matet me vite; qeveria e Kosovës dhe përfaqësuesit serb duhet të zhvillojnë në mënyrë periodike dhe rishikojnë integrimin me numra e shifra. Zëvendës kryeministri serb i Kosovës duhet të luaj një rol në këtë proces.

Serbët brenda Kosovës do të përfitojnë nga rritja lidhjeve bilaterale ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, fillimisht përmes dialogut të mbështetur nga BE në normalizimin e marrëdhënieve. Kosova dhe Serbia duhet të shtojnë kontaktet e drejtpërdrejta dhe të gjejnë zgjidhje për çështjet tjera pa vonesa.

Prishtina, komuniteti ndërkombëtarë dhe Beogradi duhet të bashkëpunojnë ne nxitjen dhe rritjen e liderëve serb të nivelit lokal që përfaqësojnë interesat e votuesve të tyre.

Qeveria e Kosovës dhe e Serbisë:

Ministria e Kosovës për vetëqeverisjen lokale (MAPL) dhe zyra për Kosovën dhe Metohi (KiM) e Serbisë duhet, në mënyrë të koordinuar, të mbikëqyrin një auditim gjithëpërfshirës të punësimit në institucionet e financuara nga Serbia dhe në komunat me shumicë serbe, auditim ky i cili do të realizohet nga zyrtarët lokal me mbështetje nga BE dhe SHBA. Institucionet përkatëse lokale duhet të bashkëpunojnë. Punëtorët që gjenden në listat e pagave të Kosovës por që jetojnë në Serbi duhet të hiqen menjëherë, dhe atyre të cilët janë pranë moshës së pensionimit duhet t'u ofrohen pensioni i parakohshëm.

Stafi serb komunal do të duhej të transferohej në institucionet përkatëse komunale të Kosovës dhe të hiqeshin nga listat e pagave të Serbisë sa më shpejtë që jetë e mundur gjatë vitit 2015. Një zyre e vogël duhet të qëndroj në sistemin serb edhe pas 1 janarit 2016 në mënyrë që të administroj pagesat e punëtorëve të cikët ende nuk kanë mundur të transferohen.

Pasi të përfundojë integrimi i plotë i institucioneve komunale, duke filluar që nga viti 2016, qeveria e Prishtinës duhet të zhvilloj profilet minimale të stafit për komunat me shumicë serbe, dhe të vendos një strategji për largimin e punëtorëve të tepërt nga puna. Kjo do të duhej të bëhej gradualisht, për të minimizuar përçarjen e komunitetit. Përmes largimeve graduale dhe pensionimeve të parakohshme duhet të bëhet sa më shumë që të jetë e mundur, ku humbjet e vendeve të punës do të jenë të baraspeshuara me trajnimet për punë që do të jepen, asistim për vendosje në vende pune, vende të hapura diku në sistemin e Kosovës, dhe inkurajimin e rritjes së vendeve të punës në sektorin publik.

Të ftohen përfaqësuesit serb, përfshirë zyrtarët lokal dhe të shoqërisë civile, që të marrin pjesë në procesin e krijimit të Asociacionit.

Ministritë e arsimit te dy vendeve duhet të zgjidhin problemet me diplomat universitare.

Prishtina dhe Beogradi duhet të pajtohen që të lejojnë zyrat e ndërlidhëse në lokacionet e përzgjedhura për të ndihmuar në lëshimin e dokumenteve serbe.

Qeveria e Kosovës:

Qeveria e Kosovës duhet ta bej integrimin vendos si prioritet politik e financiar, në mënyrë që integrimi të funksionojë, dhe duhet të emëroj një grup ndër-qeveritar ku përfshihen ministrat e qeverisjes lokale, financave, ekonomisë, arsimit, bujqësisë dhe të gjithë ministrat serb, për të koordinuar programet e qeverisë për integrimin e serbëve.

Të autorizohet menjëherë Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) që të rishqyrtoj kalkulimin e popullsisë për dhjetë komunat me shumicë serbe duke u bazuar në të gjitha të dhënat e mundshme. Kosova duhet ta përsëritë regjistrimin e popullsisë në dhjetë komunat me shumicë serbe sa më shpejtë që të jetë e mundur, dhe së bashku me donatorët, të përdoren rezultatet për të krijuar politika efektive që synojnë krijimin e vendeve të punës, asistencës sociale dhe aspekteve të tjera të integrimit serb.

Struktura dhe buxheti i pushtetit lokal të komunave me shumicë serbe duhet eventualisht të përputhet me kërkesat e komunitetit siç është paraqitur me rastin e regjistrimit të ri të përgjithshëm, por qeveria duhet të planifikoj një buxhet më të lartë për një periudhë tranzicioni prej tre deri në pesë vite me nivele të larta të administratës.

Zyra për komunitete duhet të rifilloj një program të rregullt për përcjelljen e numrit dhe nivelit të stafit minoritar në listat e pagesave të sektorit publik dhe t'i bëjë publike informatat e mbledhura.

Institucionet e qeverisë qendrore duhet të lansojnë një program të ri të rekrutimit për të përkrahur përfaqësuesit e serbëve dhe ata të minoriteteve të tjera në të gjitha nivelet; për të qenë efektiv, një program rekrutimi do të ketë nevojë për përkrahje nga liderët e komunitetit në të gjitha nivelet qendrore dhe lokale dhe nga shoqëria civile, si dhe mbështetje të fuqishme diplomatik dhe donatoret.

Ringjallja e MAPL-së dhe dhënia e mbështetjes së fuqishme politike për ministrat e saj.

Përfaqësuesit serb të ftohen për të luajtur një rol aktiv në politikat e shtetit.

Të rritet financimi për gjyqësorin dhe të rekrutohen më shumë gjyqtar, prokuror dhe ekspert ligjor në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor.

Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me zyrtarët serb të veriut dhe komuniteteve të tyre, duke i ftuar për vizitë në Prishtinë, organizimi i tryezave dhe aktiviteteve të tjera. Zyrtarët e lartë të qeverisë duhet të vizitojnë rregullisht veriun e Kosovës.

Të ofrohen mundësi të mësimit të gjuhës shqipe për serbët dhe shërbyesit civil, dhe kurse të gjuhës serbe për shërbyesit civil shqiptar.

Kuvendi i Kosovës:

Të amendamentoj ligjet për gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për t'i dhënë rol anëtarëve serb të KGJK-së në emërimin e gjyqtarëve serb sipas neneve kushtetuese. Të i amendamentoj ligjet të tjera për implementimin e Marrëveshjes së Brukselit, përfshirë këtu ligjet për vetëqeverisje lokale dhe bashkëpunim ndër-komunal.

Policia e Kosovës:

Në vendbanimet me numër të konsiderueshëm të banorëve serb por që gjenden jashtë komunave me shumicë serbe, të hapen nënstacione policore ose të rriten patrullat e policisë, dhe të rekrutohen zyrtarë shtesë policor nga komuniteti serb për të shërbyer në këto zona.

Qeveria e Serbisë:

Të mbyll menjëherë gjykatat paralele dhe institucionet e tjera të sigurisë; të kërkoj nga gjyqtarët dhe prokurorët që të kalojnë në gjykatat e Kosovës, dhe të udhëzoj anëtarët e mbrojtjes civile që menjëherë të integrohen në sistemin e Kosovës, duke përfituar nga pozitat e hapura nga Prishtina.

Të udhëzoj stafin komunal serb që të kalojnë te administrata e komunave të Kosovës; të shpall planet për mbylljen e këtyre zyrave që nga janari 2016.

Të gjitha financimet të bëhen transparente për thesarin e Kosovës, dhe të filloj me transferimin e fondeve për komunat e Kosovës, një pjesë e së cilave mund të lihet anash për projekte që do të operojnë përmes Asociacionit. Të ofroj vazhdimin e skemës pensionale serbe për punëtorët të cilët kalojnë në sistemin e Kosovës derisa ata marrin pjesë në skemën pensionale të Kosovës.

Të inkurajoj serbët që të integrohen në sistemin e Kosovës, dhe të përmbahet nga kontrolli ndaj tyre.

Kuvendi i Serbisë:

Kuvendi duhet të ratifikoj Marrëveshjen e Brukselit; të kaloj ligjet që mundësojnë institucionet qeveritare për të ndërvepruar me qeverinë e Prishtinës, si dhe me komunat në Kosovë dhe Asociacionin.

Liderët serb në Kosovë:

Të përmirësojnë bashkëpunimin me qeverinë e Kosovës; kryetarët duhet të bashkëpunojnë plotësisht me ministritë përkatëse dhe të respektojnë ligjet.

Të luajnë rol aktiv në politikat qeveritare: Serbët duhet të kërkojnë pozita të larta në ministritë e tjera të rëndësishme dhe jo të kufizojnë veten e tyre vetëm në ministritë që drejtpërdrejt kanë ndikim në komunitetin e tyre. Të bashkëpunojnë me shqiptarët, përfshirë përfaqësuesit e komunitetit dhe shoqërisë civile.

Parlamentarët serb duhet të përfitojnë nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe duhet të krijojë marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e minoriteteve të tjera. Donatorët duhet të mbështesin Komisionin me ekspert, trajnime dhe logjistikë.

Përfaqësuesit serb në Kuvendin e Kosovës duhet të kërkojnë ndihmë nga partitë që përfaqësojnë shumicën dhe të marrin një rol aktiv në të gjitha aspektet e procesit legjislativ.

Përfaqësuesit serb duhet të kërkojnë të luajnë rol në dialogun Prishtinë-Beograd dhe të marrin një rol udhëheqës në themelimin e Asociacionit.

Deputetët dhe të gjithë serbët e emëruar nëpër pozita të larta në institucionet qendrore duhet ta mësojnë gjuhën shqipe.

Komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët:

BE-ja duhet ta mbajë si prioritet dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shtetet anëtare të BE-së, SHBA-të dhe aktorë të tjerë duhet të mbështesin implementimin e saj dhe integrimin e serbëve në Kosovë, dhe duhet të inkurajojnë vazhdimin e dialogut në mes dy shteteve.

Brukseli duhet të inkurajoj të dy qeveritë që t'ia komunikojnë në mënyrë transparente komuniteteve që ato përfaqësojnë marrëveshjet e arritura në dialog.

Të ndihmoj integrimin e komunitetit serb duke promovuar mundësi punësimi për serbët që largohen nga listat e pagave të Serbisë.

Të ndihmohet komunikimi përmes programeve për dialog ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Serbisë, si policia dhe gjyqësori, dhe të mbështes projektet për bashkëpunim ndër-kufitar.

Të promovoj llogaridhënien dhe përfshirjen e shoqërisë në punën e komunave me shumicë serbe; duke mundësuar trajnime për MAPL-në, administratorët dhe zyrtarët e rinj lokal, të cilët duhet të kalojnë nga njëri sistem ligjor në tjetrin.

Të përmirësohet qasja e serbëve në tregun e punës, duke mbështetur hulumtime me qëllim të largimit të pengesave që shfaqen në rrugën e integrimit ekonomik, shoqëror dhe kulturës serbe në shoqërinë kosovare dhe duke mbështeturinvestimet që tërheqin punëtorë të komuniteteve minoritare.

Komuniteti i komunave serbe:

Statuti i Asociacionit duhet të bazohet në ligjet e Kosovës (përfshirë ligjet në vetëqeverisjen lokale dhe bashkëpunimin ndër-komunal), në Marrëveshjen e Brukselit dhe marrëveshjet e tjera të ratifikuara ndërmjet palëve, Planit të Ahtisarit dhe normave evropiane të vetëqeverisjes lokale.

Anëtarët e Asociacionit duhet të vazhdojnë të luajnë rol aktiv në Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK); katër komunat e veriut duhet t'i bashkohen AKK-së.

Asociacioni duhet të luaj rolin udhëheqës në administrimin e arsimit dhe shëndetësisë serbe për komunitetin serb në Kosovë, me theks për institucionet e interesit të përbashkët siç është Universiteti i Mitrovicës Veriore dhe Spitali. Asociacioni duhet të krijoj departamente për secilën fushë të ndërveprimit të saj; kryesuesit e departamenteve duhet të formojnë këshillin nën udhëzimet e përgjithshme të kuvendit dhe presidentit të tij.

Asociacioni duhet të koordinoj projektet për zhvillim; ofroj trajnime për punë dhe shërbime tjera që ndërlidhen me punësimin, mirëqenie sociale, dhe të asistoj në ndërveprimet me

institucionet serbe (ministritë, skemat e pensioneve, etj.). Duhet të mbështes projekte të zhvillimit ekonomik, përfshirë një panair apo garë vjetore, me mbështetje të donatorëve, për projektet që vinë nga autoritetet lokale dhe komunitetet.

Asociacioni duhet të ofroj ndihmë ligjore falas dhe ndihma të tjera kur kanë të bëjnë me institucionet qendrore, veçanërisht për serbët e enklavave.

Asociacioni duhet të themelojë institucionet kulturore serbe në gjithë Kosovën.

Komunat anëtare duhet të financojnë Asociacionin, me fondet e tyre, të qeverisë dhe fondeve që pranojnë nga Serbia.

Integrimi i Serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit

Hyrje

Kosova gjendet përballë ballafaqimit me një prej sfidave të saj më të mëdha, integrimi i komunitetit serbë , si në territorin në të cilin ata banojnë, ashtu edhe institucionet që ju shërbejnë. Dialogu me Serbinë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe me bekimin e OKB-së, ka prodhuar një sërë zhvillimesh që kulmuan me Marrëveshjen e Brukselit për "normalizimin e marrëdhënieve" më 19 prill 2013.[1] Edhe pse ka prodhuar ndryshime të pagabueshme në terren, zbatimi i saj ka qenë i ngadaltë dhe jo i njëtrajtshëm. Aspektet kryesore të integrimit serb – përfshirë themelimin e një organi ndër-komunal, gjykatave dhe shërbimeve hetimore; caktimi i serbëve në institucionet e qeverisjes qendrore; dhe shpërbërja e institucioneve serbe në territorin e Kosovës, të gjitha këto u vonuan si rezultat i zgjedhjeve në Serbi, raporteve BE-j - Kosovë si dhe nga turbullirat politike dhe etnike. Sidoqoftë, në 9 dhjetor 2014 në Prishtinë u instalua një qeveri e re gjashtë muaj pas zgjedhjeve, duke larguar atë që duhej të ishte pengesa e fundit për zbatimin e marrëveshjes. Dialogu rifilloi me sukses më 9 shkurt 2015 me një marrëveshje mbi gjykatat. Nëse Kosova mund të integrojë me sukses popullatën serbe, do të vihet në vend një prej pjesëve më të mëdha të munguara në mozaikun ballkanik.

Delikatesa e këtij operacioni u bë tmerrësisht e qartë kur deklaratat e pamatura të një ministri serb të porsa-caktuar në Qeverinë e Kosovës, çoi në protesta të dhunshme të cilat detyruan shkarkimin e tij më 3 shkurt 2015.[2] Si kundërpërgjigje, shumica e zyrtarëve të lartë serbë u drejtuan drejt Beogradit dhe filluan një bojkot të institucioneve të Prishtinës në të cilat ku ishin futur rishtas. Gjatë krizës u kristalizuan një sërë çështjesh të ngarkuara emocionalisht: ndër më të rëndësishmet janë kujtimet e krimeve të luftës dhe refuzimi i serbëve për t'i pranuar dhe kërkuar falje; erozioni i rendit ligjor të Kosovës; indinjomi ndaj aftësisë së vazhdueshme të Beogradit për të futur hundët; dhe zhgënjimi me performancën e qeverive të

[1] Raundet paraprake të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, nga bisedimet e sponsorizuara prej OKB-së për "statusin e ardhshëm" në 2005, në një "dialog teknik" të ndërmjetësuar nga BE-ja në 2011, filluan plot premtime, por u futën në telashe. Në Vjenë, Beogradi refuzoi të pranonte propozimin Gjithëpërfshirës që përfshinte pavarësinë e Kosovës, dhe dialogu teknik shpejt u fut më thellë në çështje të ndjeshme politike të cilat detyruan BE-në të që të niste dialogun politik në mars 2012. Për më shumë, shih raportet e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, "Asnjë alternative e mirë ndaj Planit Ahtisaari," 14 maj 2007 dhe "Kosova dhe Serbia: Me Pak Vullnet të Mirë Mund të Shkohet Larg," 2 shkurt 2012.

[2] Kriza filloi në Gjakovë (Djakovica; shih Shtojcën 3, "Shënim për Emrat"), një qytet në Kosovën perëndimore që vuajti krime masive gjatë luftës në 1999 (Shih GJNKJ IT-05-87/01 Prokurori v. Vlastimir Djordjević, Gjykimi, 23 shkurt 2011, pp.654-57). Më 6 janar 2015, një grup i aktivistëve të Vetëvendosjes dhe një OJQ vendore, ua ndaluan hyrjen në një Kishë Ortodokse, disa refugjatët serbë që po vizitonin për Krishtlindje. Gjatë protestës, një aktivist hodhi një topth akulli ndaj autobusit të serbëve, duke thërrmuar dritaren. Policia e Kosovës e arrestoi. Më 8 janar, ministri kosovar për Komunitete dhe Kthim, Aleksandar Jablanović, tha, "divljaci [egërsirat, barbarët, njerëzit e egër] të cilët ndaluan serbët që të ktheheshin tek shtëpitë e tyre të djegura, nuk po ndihmojnë askënd". Termi "divljaci", të cilin shumë shqiptarë e dëgjojnë si sharje etnike, menjëherë i eklipsoi ngjarjet në Gjakovë dhe nxiti demonstrime të përshkallëzuara, duke thirrur për përjashtimin e Jablanovićit. Në 23 janar, një deputet i kërkoi Kryeministrit Isa Mustafa të pushonte nga puna "ministrin fashist, i cili shau nënat e viktimave të luftës dhe i cilësoi ato si bisha" (komente të anëtarit të Vetëvendosjes Rexhep Selimi, në Kuvendin e Kosovës). Më shumë se 10 mijë vetë marshuan në Prishtinë më 24 janar. Tre ditë më vonë, një protestë më e vogël, por shumë më e dhunshme, i mbushi rrugët e Prishtinës me gaz lotsjellës, kokteje Molotov dhe topa uji.

cilat janë konsideruar kryesisht si jo-efektive dhe të korruptuara. Edhe më keq, u gërshetua me një mosmarrëveshje mbi privatizimin e minierave të Trepçës, të cilat shumë kosovarëbesojnë se janë pasuritë më të çmuara të vendit.[3] Të gjitha këto janë probleme të thella dhe afatgjata që do e bëjnë procesin e integrimit të serbëve më sfiduese.

Shumica e të rinjve të popullatës serbe të republikës e refuzuan deklaratën e shkurtit 2008 për pavarësinë e Kosovës prej Serbisë. Të udhëhequr dhe të ndihmuar prej Beogradit, kjo popullatë u mbështet në një sërë institucionesh paralele dhe shmangu kontaktet me Kosovën zyrtare. Ky sistem paralel ishte i paligjshëm, në kundërshtim me një rregull themelor të shtruar prej administratës së përkohshme të OKB-së (UNMIK) dhe e miratuar prej Këshillit të Sigurimit, e cila ndalonte administratën serbe dhe strukturat e sigurisë në territorin e Kosovës. Mirëmbajtja e institucioneve paralele u bë e papërballueshme kur Serbia filloi të kërkonte seriozisht anëtarësimin në BE. Beogradi ngadalë ka filluar të shpërbëjë sistemin e vet paralel, të largojë serbët prej tij dhe t'i detyrojë të integrohen në sistemin e Kosovës.

Operacioni rezultues – tranzicioni i ngadaltë por paqësor, deri tani, i një popullate dhe territorit të vet prej një juridiksioni në një tjetër, kundër vullnetit të vet dhe pa një periudhë të përkohshme të administratës paqeruajtëse ndërkombëtare – nuk ka precedentë kohëve të fundit. Në një farë mënyre, jeta për serbët e pjesës së Kosovës veriore, siç ata shqetësohen, mund të përkeqësohet në vitet e ardhshme, ndërsa humbasin shërbimet e shtetit serb dhe integrohen në një shtet që në shumë aspekte, mbetet pas atij prej të cilit ata ndjejnë se po largohen. Kushtet e integrimit po sqarohen gradualisht si në terren, ashtu edhe në bisedimet e vazhdueshme në Bruksel. Çështje të mëdha dhe kundërshtuese kanë mbetur të hapura, kryesisht konturi dhe roli i organit ndër-komunal të serbëve, "Asociacioni i komunave me shumicë serbe" (Community of Serb Municipalities /Zajednica srpskih opština, ZSO ose "Asociacioni").[4] Asociacioni është thelbi i Marrëveshjes së Brukselit dhe një pikë qendrore e këtij raporti. Ai duhet të ndihmojë integrimin e plotë të serbëve në Kosovë dhe heqjen e institucioneve paralele serbe, ndërsa ndihmon Beogradin që të bashkëpunojë në mënyrë transparente me serbët e Kosovës. Paralelisht, skena politike serbe në Kosovë është zhvendosur në mënyrë sizmike ku elitat e veta tashmë po kontrollohen gjithnjë e më shumë nga Beogradi.

Qeveria e Kosovës dëshiron që serbët e Kosovës të integrohen sipas kushteve të caktuara para pavarësisë nga ndërmjetësuesi i caktuar prej OKB-së, Martti Ahtisaari, dhe të ruajtura në kushtetutën e saj. Ajo vë në dyshim mirëbesimin e Serbisë në procesin e negociatave dypalëshe, duke besuar se Beogradi zbaton në mënyrë përzgjedhëse, duke përzgjedhur atë që është në avantazhin e saj dhe duke dashur të rinegociojë pjesën e mbetur. Kosovarët i tremben ngecjes në një rreth të pafund negociatash të cilat mund të dobësojnë funksionalizmin e shtetit dhe të vënë në pyetje pavarësinë e tij. Shumë individë në qeveri dhe në shoqërinë civile kanë frikë instinktivisht se çdo formë e autonomisë serbe përtej nivelit komunal është një rrugë e mundshme drejt fragmentimit të ngjashëm me atë në Bosnjë, dhe mund të jetë preludi i ndarjes.

---

[3] Lëvizja për Pavarësinë e Kosovës filloi me një grevë nga minatorët e Trepçës në 1989. Në kulmin e vet, minierat kishin më shumë se 20,000 punëtorë. Sot, janë dy kompani paralele, të drejtuara nga serbët dhe shqiptarët. E dyta është me paaftësi paguese, dhe falimentimi i saj nxiti një plan qeveritar për ta ristrukturuar dhe privatizuar. Ky plan ra viktimë e pretendimeve rivale nga Beogradi, dhe qeveria e tërhoqi gjatë protestave për sharjet e Jabllanoviqit, duke krijuar përshtypjen se po binte para presionit serb edhe në një front tjetër.

[4] Shih Shtojcën III, "Shënim për Emrat".

Ky raport diskuton sfidat e integrimit serb dhe se si mund të tejkalohen më së miri ato, në mënyrë që forcon institucionet e Kosovës dhe respekton interesat e komunitetit të vet serb. Ai mbikëqyr institucionet ekzistuese dhe ilegale serbe nëpër Kosovë, të cilat ndryshojnë në disa mënyra midis komunave veriore relativisht homogjene dhe enklavave të shpërndara jugore; shumica mbeten në vend ndërsa serbët vazhdojnë të mbështeten në to. Në një efekt të paqëllimshëm të pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet komunale në Kosovë në nëntor 2013, shumë zyrtarë serbë tani mbajnë pozita si në administratën serbe, ashtu edhe në atë të Kosovës.

Çështja e integrimit është edhe për Kosovën si shtet, dhe për aftësinë e saj për të ofruar qeveri të mirë për të gjithë. Prishtina nuk e konsideron si prioritet të lartë integrimin, pjesërisht sepse do të jetë i shtrenjtë.[5] Shumë individë në qeveri janë të kënaqur që Kosova tashmë kontrollon kufijtë e saj në të gjithë territorin e vet; plotësimi i nevojave të minoriteteve të pashtruara është më pak joshës. Përpjekjet e komunave me shumicë serbe kundër qendrës, bëjnë jehonë në mbarë vendin. Nëse qeveria zbaton ligje në mënyrë përzgjedhëse ose ua tërheq të drejtat që u janë dhënë nën trysninë ndërkombëtare, dëmi nuk do të kufizohet vetëm tek minoritetet. Shumica mund të mos i konsiderojë këto hapa si të dëmshme, mund edhe t'i brohorasë nxitur nga pasioni nacionalist, por ata do të forconin një ekzekutiv të papërgjegjshëm dhe do të dobësonin institucionet e Kosovës dhe të gjitha komunitetet e veta, përfshirë shumicën shqiptare si dhe nevojën për prosperitet dhe siguri.[6]

Integrimi serb është vetëm pjesë e një procesi më të gjerë plotësia e të cilit është normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Kosovarët duan që kjo gjë të përmbyllet me njohjen e përbashkët diplomatike brenda disa vjetësh. Beogradi duket se e kupton se i duhet të njohë Kosovën para se t'i bashkëngjitet BE-së, dhe kërkon të vonojë momentin e dhimbshëm sa më shumë që të jetë e mundur. Për shumë vjet, problemi i Kosovës i ka shpërqendruar qeveritë serbe prej reformave të rëndësishme dhe qeveria e tanishme e kupton se nuk e ka luksin për të humbur kohë. Sidoqoftë, figura të larta në Serbi e konsiderojnë normalizimin të përshtatshëm me ndarjen, dhe shpresojnë se në afat të gjatë, marrëdhëniet normale dypalëshe do ta bëjnë më të lehtë që të ngrenë "çështjen e statusit" ose të paktën të fitojnë autonomi më të gjerë për serbët.[7] Qasja e Beogradit për ngritjen e çështjes ndaj Kosovës, mbetet improvizuese, e prirur për të rrëshqitur shpejt. Prishtina shqetësohet se në një moment të caktuar, Serbia do të risjellë përpjekjet për të bllokuar zhvillimin e Kosovës dhe të gërryejë sovranitetin e saj. Ajo do që Beogradi të bëjë të mundur që serbët vendorë të luajnë një rol konstruktiv dhe jo një rol prishës në jetën politike, pritshmëri kjo që duket të jetë e paqëndrueshme për shpresën që Beogradi të mos ndërhyjë.[8]

Shumë gjëra kanë ndryshuar që kur BE-ja filloi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Në 2013, dialogu ishte prioritet i lartë për Brukselin, me çështjet e brendshme brenda BE-së, Ukrainën dhe konfliktet e vazhdueshme në Lindjen e Mesme të cilat përfshijnë mijëra qytetarë të BE-së, dialogu Kosovë-Serbi mund të shkasë mbrapsht në

[5] Intervista me zyrtarë qeveritarë dhe të MAPL, Prishtinë, maj 2014.

[6] Shih Grupi i Krizave, "Çlirimi i Kosovës: Sfidat e mbetura," 10 shtator 2012.

[7] Ky paragraf bazohet në bisedimet e prillit 2014 me zyrtarë të lartë legjislativë dhe ekzekutivë serbë në Beograd, dhe Intervista me një Serb [zyrtar qeveritar, Budva, dhjetor 2014.

[8] Intervistë, anëtar i qeverisë së Kosovës, Prishtinë, maj 2014.

agjendën e BE-së. Si shtete të tjera në Ballkanin Perëndimor, Kosova dhe Serbia e shohin me dyshim ristrukturimin e Drejtorisë për Zgjerim në Drejtorinë NEAR (Politikat për Fqinjësi Evropiane dhe Negociata për Zgjerim). "Është e vështirë të gjesh disa orë të lira të [shefes së politikave të jashtme të BE-së, Mogherini] dhe t'ia dedikosh Kosovës" tha një zyrtar i BE-së.[9] Me fokusin diku tjetër, BE-ja mund të ngurrojë të imponojë agjendën dhe afatin kohor, sikundër ka bërë dhe në të shkuarën, e megjithatë, "është e rrezikshme që të lihet anash që të bihet dakord".[10]

Nën drejtimin e Catherine Ashton dhe komisionerit për Zgjerim, Füle, roli i BE-së në terren u dëmtua nga keq-komunikimi midis zyrtarëve të BE-së në Bruksel dhe atyre në Prishtinë dhe Beograd. Zyrtarët e Kosovës shpesh e kanë anashkaluar zyrën ndërlidhëse të BE-së në Prishtinë, e cila ndonjëherë dukej se vepronte pa udhëzime të qarta nga Brukseli. Udhëheqja e re e BE-së duhet të rregullojë një gjë të tillë dhe të fuqizojë ekipet e veta në terren, të cilat janë jetike për monitorimin e zbatimit. Në Beograd, disa shtete anëtare të BE-së e kanë përforcuar mesazhin; një zyrtar serb theksoi "Njerëzit më shumë interesohen për atë që kanë për të thënë ambasadori gjerman dhe britanik [sesa] shefi i delegacionit të BE-së". Në Kosovë, shefi i zyrës së BE-së, është edhe përfaqësuesi special i BE-së (EUSR), dhe fjalët e tij mbajnë më shumë peshë, e megjithatë shtetet anëtare ende mund të ndihmojnë që të përforcojnë një gjë të tillë.

Roli i BE-së në Prishtinë po ashtu dëmtohet nga marrëdhënia e saj e paplotë me Kosovën. Pavarësisht premtimeve, BE-ja nuk ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me Kosovën. Politikanët dhe partitë e tyre ndjejnë se janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me vendet e tjera në rajon.[11] Kjo ndjesi padrejtësie, e të qenit të injoruar dhe të bllokuar, është e ngulitur. Kosova ka përmbyllur negociatat për Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) me BE-në, dhe ka bërë përparim në bisedimet për liberalizimin e vizave. Megjithatë, paaftësia e BE-së për të lëvizur shpejt, kryesisht për shkak të shteteve që s'e njohin pavarësinë, janë kundër MSA-së dhe që kanë probleme të brendshme politike për regjimin e vizave, e bëjnë BE-në edhe më të dobët kur kanë të bëjnë me autoritetet.

Serbët në pjesën veriore të Kosovës

Nuk ka shifra të besueshme zyrtare të serbëve të cilët jetojnë në pjesën Veriore të Kosovës, sepse shumica e kanë bojkotuar regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.[12] Shifrat luhaten prej atyre zyrtare duke filluar prej 25,532 në ato të OSBE-së prej 143,574.[13] Hamendësimi nga zgjedhjet lokale dhe parlamentare të 2013-2014 ofron një mënyrë alternative për të përllogaritur popullsinë. Nëse ata kanë votuar sipas mesatares së përgjithshme të Kosovës, janë diku 145,820 serbë. Kjo është shumë e përafërt me përllogaritjen e OSBE-së, por

[9] Intervistë, zyrtar i BE-së, Prishtinë, janar 2015.

[10] Intervista, Prishtinë, janar 2015. Përmbledhje e Zhvillimi për Demokraci (D4D) dhe Instituti Evropiano - Qendror për Politika, "Mundësia e Mogherinit për Afrim të Vërtetë Mes Serbisë dhe Kosovës," 21 tetor 2014.

[11] "Na u premtua njohja nga vendet e BE-së që s'na njehin, të paktën tre, nëse do të nënshkruanim marrëveshjen me Serbinë. Përveç kësaj, na u premtuan marrëdhënie kontraktuale dhe MSA-ja." Intervistë, ministër i qeverisë, Prishtinë, maj 2014.

[12] Shih Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave, "Komunitetet Pakicë në rezultatet e regjistrimit të popullsisë së Kosovës në vitin 2011: Analiza dhe Rekomandime" (18 dhjetor 2012).

[13] Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) pranon se numri i serbëve është më i lartë se sa ai i raportuar; shih "Përllogaritja e Popullsisë së Kosovës 2011" (shkurt 2013) për analizë bazuar në madhësinë mesatare familjare.

bazohet në një metodologji tjetër.[14] Në mungesë të një numërimi të besueshëm, të gjitha përllogaritjet duhet të trajtohen me kujdes, por krahasimi i shifrave duke përdorur metoda të ndryshme mund të prodhojë informacion të dobishëm rreth madhësisë dhe vendndodhjes së komunitetit serb.

Pjesa Veriore e Kosovës ka përqendrimin më të madh të serbëve, rreth 63,293 banorë sipas përllogaritjes sonë, e cila është paksa më e ulët se sa shifra e OSBE-së dhe shumë më e lartë se sa ajo e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 37,625.[15] Kjo shifër është rreth 43 për qind e totalit të popullsisë serbe të Kosovës. Një tjetër shifër, rreth 53,900 (37 për qind) e komunitetit serb jetojnë në gjashtë komunat me shumicë serbe në jug të Ibrit. Rreth 28,628 (20 për qind) mund të jetojnë në zonat me shumicë shqiptare, por ky numër mbase është i fryrë nga votimi në mungesë. Graçanica duket të ketë kaluar Mitrovicën e Veriut si komuna më e madhe serbe.

Analiza statistikore nuk mund të zëvendësojë regjistrimin e popullsisë. Pa informacione të besueshme mbi strukturën demografike të komunitetit serb, (gjinia, mosha, gjendja martesore, arsimi, punësimi, etj.), politikat integruese të qeverisë do të veprojnë në errësirë dhe me gjasa do të shmangin kategoritë më nevojtare. Edhe më keq ende, numërimi i ulët zyrtar tashmë është duke dëmtuar buxhetet e komunave me shumicë serbe, duke zbehur joshjen e integrimit. Si hap i parë, Prishtina duhet të fuqizojë ASK-në që të rishikojë numërimin e popullsisë për 10 komunat me shumicë serbe, bazuar në të gjitha të dhënat e disponuara, përfshirë analizën zgjedhore nga Grupi për Ballkan. Kjo duhet bërë në kohë, që të rishikohen buxhetet komunale në qershor 2015. Më pas, ASK duhet të përsërisë regjistrimin e popullsisë në këto dhjetë komuna, dhe Beogradi duhet t'u bëjë thirrje serbëve që të marrin pjesë.

Në regjistrimin e popullsisë në vitin 1991 (i cili u bojkotua nga shqiptarët), autoritetet jugosllave numëruan 194,190 serbë në Kosovë. Autoritetet dhe shkrimtarët serbë shpesh pretendojnë se më shumë se 200,000 serbë u përzunë nga Kosova pas bombardimeve të NATO-s në 1999 dhe protestave anit-serbe në mars të 2004. Numri i saktë mbetet i panjohur, pjesërisht për shkak të ardhjes së refugjatëve serbë nga Bosnja dhe Kroacia në fund të viteve 90'. Por nëse në vitin 1991 ka pasur rreth 200,000 serbë dhe tani janë rreth 145,000, numri aktual i refugjatëve duhet të jetë shumë më i ulët. Autoritetet e Kosovës nuk kanë bërë thuajse asgjë për të mundësuar kthimet, dhe të kthyerit shpesh hasin në në pritje të ashpër dhe të dhunshme. Numri i serbëve që duan të shkojnë në shtëpi pas vitesh mërgimi ka gjasa të mbetet i ulët, por Prishtina dhe Beogradi duhet që të mundësojnë kthimin.

Qoftë serbët që jetojnë në veri, në enklavat e jugut apo në fshatra të komunave me shumicë shqiptare, të gjithë serbët ndajnë interesa të përbashkëta, sidomos sigurinë fizike, qasjen e papenguar në institucionet arsimore dhe shëndetësore serbe, dhe mënyrat e të fituarit të jetesës (shih më poshtë). Banorët e secilës pjesë po ashtu kanë perspektiva dhe interesa të veçanta. Pjesa tjetër e këtij kapitulli mbikëqyr politika të ndryshme të nevojshme për të ndihmuar integrimin e tyre.

[14] Për përllogaritjet komunale dhe përshkrim të detajuar të metodës së përllogaritjes, shih shtojcën A më poshtë.

[15] ASK, "Përllogaritje", op. cit, p. 20. Ekzistojnë një sërë problemesh me këtë përllogaritje, të cilat duket se nën-numërojnë shqiptarët (për shembull, duke dhënë se janë 867 në Mitrovicën e Veriut, më pak se sa 1,724 të cilët votuan shumicën e partive shqiptare në vitin 2014).

Pjesa Veriore e Kosovës

Pjesa Veriore e Kosovës ka një komunitet të vogël, i vetëpërmbajtur dhe që ka jetuar në izolim prej pjesës tjetër të Kosovës, të paktën që prej vitit 1999.[16] Disa prej njerëzve të vet nuk kanë pasur kurrë takim të rëndësishëm me shqiptarët. Shumë banorë rrallë, për të mos thënë kurrë, kalojnë "kufirin etnik" joformal dhe të pashënuar, i cili kalon përgjatë Lumit Ibër. Zona duket e lënë pas dore. Firma që nuk ekzistojnë askund tjetër, mbushin rrugët e Mitrovicës së Veriut, përkujtues të pluhurosur të një Jugosllavie që ka vdekur kohë më parë. "Mitrovica është duke u kalbur prej kohësh", psherëtin një profesor në universitetin që ende vetëquhet "Universiteti i Prishtinës, përkohësisht i vendosur në Mitrovicë".[17]

Paçka degradimit të vet, Mitrovica e Veriut mbetet e rëndësishme, si qendra e vetme urbane që i ka mbetur komunitetit serb në Kosovë. Integrimi serb nuk mund të ndodhë pa një qendër ekonomike, arsimore dhe politike që lidhet si me Prishtinën, ashtu edhe me vendbanimet e shpërndara të serbëve në Kosovë. Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe qendra mjekësore, janë mbase më të mirat në vend, dhe përdoren nga Serbët që vijnë prej gjithë Kosovës. Një pjesë e madhe në Veri është shtëpia e Gazivodës, liqeni më i madh i Kosovës (që ndahet me Serbinë), i cili është një burim jetik me ujë të freskët për të gjithë vendin. Në komunën e Leposaviqit, ku ende vazhdon nxjerrja e mineraleve, kodrat e pafundme të pikëzuara me shtëpi modeste, shndërrohen në male në kufirin me Serbinë.

Ky komunitet tani po përjeton një tranzicion të dyfishtë, jo vetëm prej administratës serbe në atë të Kosovës, por edhe prej ekonomisë së vet të fosilizuar të epokës socialiste, në atë të shekullit të 21-të. Tranzicioni politik është i dhimbshëm emocionalisht. Pothuajse secili prej serbëve që jetojnë në veri e refuzon ndarjen e Kosovës nga Serbia dhe e konsiderojnë si të paligjshme të drejtën e Prishtinës për t'i qeverisur. Rrëshqitja ekonomike rrezikon t'i dëmtojë thellë financat familjare dhe e bën shumë të vështirë planifikimin. Rajoni ka tre punëdhënës të vërtetë: qendrën mjekësore, universitetin dhe administratën e shtetit. Të gjitha këto pjesërisht funksionojnë si programe të punëve publike, duke i siguruar punësim një popullate që përndryshe do të emigronte. Ideale nuk është "t'i bësh gjërat sipas mënyrës moderne, por t'i bësh gjërat siç bëheshin para 15 vjetësh", para luftës.[18] Shumë vende pune në Mitrovicën e Veriut kanë shumë pak justifikim ekonomik dhe ekzistojnë sepse Serbia ka qenë duke i financuar për të parandaluar emigracionin dhe për të ruajtur një masë kontrolli. Dy tranzicionet kanë nevojë të menaxhohen me kujdes, pasi secili mund të jetë motiv për emigrim në Serbi.

Pjesa Veriore e Kosovës ka qenë strehë e liderëve politikë të respektuar dhe të aftë të komunitetit serb. Kryetarët e komunave të Zubin Potokut dhe Zveçanit kanë shërbyer gjatë dhe kanë qenë popullorë. Partia e tyre Demokratike e Serbisë (Demokratska stranka Srbije, DSS) ka qenë e fuqishme në nivelin lokal, por pa pushtet në Serbi dhe nuk ka ushtruar shumë ndikim mbi ta. Zyra e kryetarit të Komunës në Leposaviq dhe Mitrovicën e Veriut ka ndryshuar drejtues disa herë në dhjetëvjeçarin e shkuar, por të dyja komunat kanë pasur politikanë dhe administratorë profesionistë. Si grup, kryetarët e komunave nuk ishin vetëm

[16] Shih Grupin e Krizave, "Kosova e Veriut: Sovraniteti i Dyfishtë në Praktikë," 14 mars 2011 për historikun e këtij rajoni. "Sovraniteti i dyfishtë" është një përshkrim i një sistemi që ishte në efekt atëherë, dhe jo rekomandim apo politikë.

[17] Intervistë, Anëtar i fakultetit, Universiteti i Mitrovicës së Veriut, shkurt 2014.

[18] Intervistë, Anëtar i fakultetit, Universiteti i Mitrovicës së Veriut, shkurt 2014.

krerë administrativë, por edhe udhëheqës të strukturave joformale të organizimit të komunitetit të cilat mbushnin hapësirat e zbrazëta që mbetën prej mungesës së zbatimit efektiv të ligjit në atë zonë.[19]

Në masë të madhe, për më shumë se një dekadë, rajoni ka qenë mbikëqyrur nga struktura vetjake policore dhe pa zbatim formal të ligjit. Ndërsa zyrtarët serbë të policisë së Kosovës patrullojnë në uniforma, popullata lokale ju referohet sipas emrit të para-pavarësisë, dhe i konsideron si një lloj xhandarmërie vendore të paaftë.[20] E vetmja gjykatë funksionale ishte ajo serbe, e cila vepronte në një pallat në Zveçan, dhe të cilës i ishte ndaluar që të merrej me rastet penale, si dhe ajo e Kosovës në Mitrovicën e Veriut. Kjo e fundit nuk ka asnjë gjykatës apo prokuror shqiptar apo serb, por vetëm ndërkombëtarë që punojnë për EULEX-in, misionin e sundimit të ligjit të BE-së, dhe është shumë e kufizuar për shkak të gjuhës. Vetëm shkelësit më të rëndë dhe të pafat përfundojnë në gjyq, të tjerët sipas rregullit të pashkruar, mbeten të pandëshkuar. Kjo thuajse-anarki nuk është shndërruar në një valë krimi. Krimi i rëndë nuk është shumë i lartë në veri, në krahasim me pjesën tjetër të vendit, edhe pse presioni shoqëror është i vetmi ndëshkim që hasin shumica e kryerësve të krimeve.

Kontrolli social joformal ka pasur kufij. Mungesa e gjykatave në gjendje që të nxjerrin dhe të zbatojnë vendime në kohë të caktuar, ka krijuar hapësirë për akte të këqija. Një zyrtar i caktuar rishtas tregoi për një grua e cila mori kujdestarinë për fëmijët e vet pas një divorci në një gjykatë serbe, vetëm që burri i saj i larguar të fitonte kujdestarinë në një gjykatë të Kosovës.[21] Dëshmi jo zyrtare tregojnë se Mitrovica e Veriut ka një problem shumë të madh me drogat, me epiqendër tek universiteti, gjë që nxit krime të vogla në nivele relativisht të larta. Ata që hasin në njerëzit e gabuar ose marrin pozicione të papëlqyeshme, ekspozohen ndaj kërcënimeve, vandalizmit dhe sulmit, dhe kanë pak mbështetje efektive.

Ky sistem po shpërbëhet, meqenëse ishte mbështetur kryesisht në rezistencën masive kundër Prishtinës dhe në një numër udhëheqësish që lidheshin me të. Kryetarët e komunave morën nismën të organizonin rezistencën ndaj përpjekjeve të Prishtinës për të vendosur autoritetin, duke ndihmuar vendosjen e barrikadave dhe duke negociuar me misionin e KFOR-it të NATO-s për paqe-ruajtje si dhe me EULEX-in. Ata qetësuan temperamentet kur u kërcënua se dhuna do të përshkallëzohej në luftime ndër-komunale.[22] Pas bojkotimit të zgjedhjeve të vitit 2013, tashmë ata janë mënjanuar dhe pasardhësit e tyre nuk kanë marrë plotësisht këtë rol stabilizues. Është një moment i rrezikshëm: një shkëndijë mund t'i kthejë lagjet serbe dhe shqiptare kundër njëra-tjetrës, ndërsa institucionet e Kosovës nuk janë në gjendje të përballen me këtë amulli. Teorikisht, policia është e para që duhet të përgjigjet në një krizë, por në këtë rajon, ata nuk kanë kapacitetin që të shuajnë trazirat publike. Gjykata e Mitrovicës është ende

[19] Ndërsa kryetarët e komunave kanë një lloj ndikimi mbi aktivitetet ekonomike formale, figura të tjera zakonisht mendohet të kenë qenë më të rëndësishme në këtë aspekt. Katër kryetarët së bashku me shefin e distriktit të Mitrovicës veriore, Radenko Nedeljković, ishin udhëheqja de facto e Kosovës veriore mes 2008 dhe 2012.

[20] UNMIK-u themeloi Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK); pas pavarësisë, qeveria e Kosovës e riemëroi në Policia e Kosovës (PK).

[21] Intervistë, kryetari i komunës, Kosova veriore, nëntor 2013.

[22] Stafi i Grupit për Ballkanin i pa kryetarët e komunave duke ndërhyrë disa herë për të parandaluar ose zbutur trazirat në Leposaviq (një sulm ndaj PK), Zubin Potok (tensionet për barrikadat) dhe Mitrovica e Veriut (tensione pas goditjes fatale të një serbi të ri).

në mungesë stafi. EULEX-i supozohet të jetë i dyti në kundërpërgjigje, por edhe atij i mungon kapaciteti në Veri, duke e lënë KFOR-in si të vetmen pritë për rendin publik.

Serbët e pjesës Veriore po paguajnë çmimin për vite të tëra papajtueshmërie, kur refuzuan që të flisnin me shqiptarët dhe nuk u interesonte për serbët në jug të Ibrit. Serbët e veriut refuzuan të bashkëpunonin me Prishtinën edhe përpara pavarësisë. Nën administrimin e UNMIK-ut, pjesëtarët e të cilit i kanë sulmuar ndonjëherë, serbët i mobilizuan komunitetet e tyre përreth institucioneve të financuara nga Beogradi, krijuan rregullin e tyre bazuar në mosbindjen ndaj Prishtinës dhe kontrabandën e përhapur nga të gjitha anët. Ajo botë tashmë po kolapson dalëngadalë. Ndjenja e tradhtisë është rrënjosur thellë. Një ish kryetar komune pranon:

> Ne u gabuam kur besonim thellë tek Beogradi [dhe] duke dashur të negocionim [me Prishtinën] në vendin tonë, pasi nuk fituam asgjë në fund. Ata na gënjyen, na thanë se do të fitonim policinë tonë, gjykatën tonë, dhe se "asnjë çizme shqiptari" nuk do të shkelte këmbë në veri, e në të vërtetë, ajo që morëm ishte një qeveri kosovare e centralizuar, dhe tani ne na duhet ta shesim këtë tek njerëzit që kishin besim tek ne.[23]

Shumë zyrtarë të tjerë komunalë aktualë dhe të mëhershëm, qofshin pjesëmarrës në sistemin e Kosovës apo jo, ndajnë pikëpamjen se të besonin tek Beogradi ishte gabim, dhe se më mirë do të kishin bërë po të negocionin drejtpërdrejt me Prishtinën.[24] Midis popullit, ka ende një "masë kritike e cila refuzon çdo gjë" prej Prishtinës. Paçka se e ulët, pjesëmarrja në zgjedhjet e nëntorit 2013 në Kosovë nuk "ishte e vërtetë" pasi njerëzit kryesisht nuk donin të votonin dhe votuan nën trysni.[25]

Qeveria e Kosovës kishte prani të vogël në veri edhe gjatë viteve të ndarjes së pjesës veriore nga Prishtina. Në Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, "Zyrat e Komunitetit Lokal" (ZKL-të) morën përsipër disa funksione të qeverisë komunale, duke u shërbyer nevojave të popullsisë shqiptare, e cila ishte përqendruar në disa fshatra. Ata bashkëpunuan shumë mirë me kryetarët e komunave serbe në një sërë çështjesh praktike. Në Mitrovicën e Veriut, Zyra Administrative (ZAMV) i ka shërbyer të gjithë komunës, por nuk ishte një administratë e plotë komunale.

Komunat e Kosovës Jugore

Izolimi i serbëve të pjesës veriore prej shoqërisë shqiptare, është fortifikuar prej historisë dhe gjeografisë. Në jug të Ibrit, serbët jetojnë në afërsi të shqiptarëve por kryesisht kërkojnë jetë të ndarë. Strategjitë veriore atje janë të pambrojtshme. Separatizmi i dhunshëm, përdorimi i barrikadave dhe dhuna në nivel të ulët, janë të pamundura. Rezistenca e butë, si për shembull kundërshtimi për të përdorur dokumentet apo targat e Kosovës, është po ashtu jopraktike. Ndërsa shumica e serbëve të veriut bojkotojnë zgjedhjet e Kosovës, pjesëmarrja në zonat e jugut është paksa e ndryshme nga mesatarja. Barrierat midis shqiptarëve dhe serbëve janë më të buta, dhe përforcohen nga dallimet gjuhësore dhe në tradita, por tejkalohen lehtësisht nga tregtia.

[23] Intervistë, ish kryetar komune, Kosova veriore, prill 2014.

[24] Intervista, udhëheqës aktualë dhe të mëparshëm, Kosova veriore, Prill 2014.

[25] Intervistë, politikan serb, Prishtinë, prill 2014.

Në jug janë 6 komuna me shumicë serbe.[26] Graçanica, që është më e madhja, është rrethinë e Prishtinës, është vendi jo vetëm i shumë serbëve që punojnë në qeverinë qendrore, por edhe i një numri gjithnjë e në rritje shqiptarësh që kërkojnë një vend më të qetë. Dikur kënetë, ajo ka përfituar prej investimit dhe qeverisjes vendore progresive, dhe është qendër graviteti rreth të cilës rrotullohet komuniteti serb i Jugut. Shtërpca, e rrethuar nga malet e Kosovës Jugore, ka potencial zhvillimi prej turizmit malor, por është prekur nga ndërtimi pa leje.[27] Katër komunat e mbetura, janë më të vogla. Kllokoti, Parteshi dhe Ranillugu janë krijuar prej komunave me shumicë shqiptare sipas Planit të Ahtisaarit, dhe janë pak më shumë se thjesht fshatra. E katërta, Novobërda, u zgjerua prej shtimit të territorit të banuar nga serbët, me një komunë ngjitur, për të formuar një shumicë serbe. Asnjë nga këto komuna nuk kanë kushedi se çfarë ekonomie vendore. Marrëdhëniet midis komuniteteve serbe dhe shqiptare janë qetësuar shumë që prej protestave kundër-serbe të marsit 2004. Me përjashtim të komunave të vogla të Parteshit dhe Ranillugut, komunat jugore serbe janë multietnike. Administrata komunale në Novobërdë funksionon qetësisht, me një kryetar komune serb i cili udhëzon një fuqi punëtore kryesisht shqiptare të punësuar gjatë viteve të bojkotit serb.[28] Shqiptarët vijnë dhe shkojnë lirisht nëpër Koretishtë, një fshat serb që përflitet të ketë shumë radikalë serbë, në kufi mes Novobërdës me shumicë serbe dhe Gjilanit me shumicë shqiptare. Serbët e Koretishtës shpesh vizitojnë Gjilanin fqinjë për të blerë dhe për shërbime; ata duan të mbeten pjesë e komunës së Novobërdës për mbrojtjen që u ofron ndaj diskriminimit etnik, por nuk u pëlqen të bëjnë udhëtim të gjatë deri në qendrën e komunës për të bërë biznes të zakonshëm.[29]

Tensionet në Shtërpcë mbeten të ulëta; njerëzit thonë se ata janë ngopur me konfliktin etnik dhe duan të vazhdojnë me jetën e tyre dhe të bëjnë një jetesë të mirë.[30] Edhe nacionalistët radikalë të cilët e konsiderojnë Marrëveshjen e Brukselit si tradhti, vënë re se marrëdhëniet-shqiptaro-serbe mund të jenë "korrekte" dhe kujtojnë rastet kur kryetarët shqiptarë të komunave janë sjellë mirë ndaj popullsisë serbe.[31] Po ashtu, marrëdhëniet politike janë kryesisht konstruktive. Udhëheqësit serbë të pjesës jugore kryesisht kanë marrëdhënie të mira me kryetarët shqiptarë të komunave fqinje. Kryetari i Graçanicës ka projekte të përbashkëta me kolegun e tij shqiptar nga Lipjani.[32] Ranillugu dhe Kamenica kanë marrëdhënie "të shkëlqyera", bashkëpunojnë në shumë gjëra, dhe dorëzojnë aplikacione të përbashkëta si dhe punojnë së bashku në projekte prej Agjencisë Rajonale të Zhvillimit - Lindje.[33] Kryetarët e

[26] Dy më të mëdhatë janë Graçanica, afër Prishtinës, dhe Shtërpce në jugun e thellë; katër komunat më të vogla (Kllokoti, Novobërda, Parteshi dhe Ranillugu) janë të shpërndara në lindje. Për më shumë historik, shih Grupi i Krizave, "Çlirimi i Kosovës, Sfidat e Mbetura," 10 shtator 2012, pp.13ff.

[27] Shih Grupi i Krizave, "Kosova: Shtërpca, modeli i enklavës serbe?," 15 tetor 2009.

[28] Intervistë, zyrtar komunal, Novobërdë, prill 2014. Mes 70 dhe 80 për qind e stafit të shërbimit civil janë shqiptarë. Kryetari dhe partia qeverisëse janë serbë.

[29] Intervistë, zyrtar komunal, Novobërdë, prill 2014. Mungesa e leverdisë mund të jetë e madhe: pranë zyrës komunale të Novobërdës nuk ka banka apo degë bankare, dhe pagesat duhet bërë shumë larg prej aty. Intervistë, banor i Koretishtës, prill 2014.

[30] Intervistë, anëtar i këshillit të përkohshëm serb, prill 2014.

[31] Intervistë, anëtar i SRS, Shtërpce, Prill 2014.

[32] Intervistë, zyrtar serb, Graçanicë, prill 2014.

[33] Agjencia Rajonale për Zhvillim – Lindja është një projekt ndër-komunal i themeluar nga komunat anëtare. Shih faqen elektronike, www.rdaeast.org.

Komunave kanë marrëdhënie të mira personale.[34] Sidoqoftë, politikat në koalicion janë një shqetësim potencial. Për shembull, partia më e madhe shqiptare në Novobërdë, pritet të ftohet në koalicionin qeverisës, megjithatë, udhëheqësit serbë zgjodhën një parti shqiptare më të vogël. Tensionet mund të zmadhohen nëse udhëheqësit shqiptarë besojnë se serbët po përpiqen të shmangin përfaqësuesit e tyre në shkëmbim të alternativave më të favorshme.[35]

Enklavat në zonat me shumicë shqiptare

Mijëra serbë jetojnë anembanë Kosovës në fshatrat jashtë këtyre komunave, shpesh të izoluara prej të afërmve të tyre. Këto enklava janë të shpërndara në pjesën jugore të Kosovës në tre grupime të mëdha: Kosova lindore (komunat e Gjilanit dhe Kamenicës), Kosova qendrore (rrethinat e Obiliqit, Vushtrrisë, Skënderajt dhe Prishtinës) dhe Kosova perëndimore (Istog, Klinë, Pejë dhe Rahovec).[36] Enklavat serbe kanë nevojë për punë, siguri dhe lidhje me shërbimet – në radhë të parë, shkollimi dhe kujdesi shëndetësor serb, por edhe spektri i shërbimeve komunale të ofruara ndaj të afërmve të tyre në zonat me shumicë serbe, përmes rrjeteve të kombinuara të institucioneve serbe dhe kosovare. Një zyrtar serb i institucioneve paralele në Kosovën lindore, tha për Grupin për Ballkan "ne do të integrohemi, por duam punë".[37] Qeveria duhet të punojë me donatorët për të hapur vende pune për aplikantët e kualifikuar serbë dhe t'i ndihmojë ata për të konkurruar në tregun kosovar. Me mbylljen e institucioneve serbe, komunat e Kosovës do të duhet të shtrijnë veprimtarinë e tyre tek popullatat minoritare serbe për të dalë nga amullia. Komunat me shumicë serbe mund të ofrojnë disa shërbime për enklavat fqinje, ato më të izoluarat mund shërbehen më mirë përmes Asociacionit.

Shkollat dhe kujdesi shëndetësor janë jetike për to dhe ata do të largohen në rast se këto sisteme do të shpërbëhen. Ata e pranojnë autoritetin e Prishtinës dhe kërkojnë shërbime prej tij.[38] Ata përfitojnë shumë njëkohësisht prej shërbimeve serbe. Në disa pjesë, shumë punojnë në të dy sistemet e administratës dhe marrin dy rroga. Administratat serbe janë burim krenarie, lëshojnë dokumente, dhe në disa fusha, organizojnë asistencë për më të vjetrit, por punësojnë pak njerëz. Shkollat dhe shërbimet mjekësore sigurojnë pjesën më të madhe të vendeve të punës dhe marrin ndihmë prej Prishtinës, donatorëve dhe Beogradit po ashtu.[39] Gjasat për punë të tjera, përveç atyre në shtet, janë të pakta, kështu që shumica e popullsisë jetojnë prej punimit të tokës, të cilën e subvencionon Beogradi, përfshirë edhe blerjen e produkteve.[40]

---

[34] Intervistë, kryetari i komunës së Ranillugut, Prishtinë, prill 2014.

[35] Intervista, anëtar shqiptar i kuvendit komunal, dhe zyrtar komunal serb, Novobërdë, Prill 2014.

[36] Shih Shtojcën I për përllogaritjet e popullatës. Degët në shërbimin postar serb ofrojnë një udhëzues të përafërt të përqendrimeve më të mëdha të serbëve. Jashtë komunave me shumicë serbe, ata janë të vendosur në Shillovë (Gjilan), Kamenicë, Plemetin (Obiliq), Prelluzhë (Vushtrri), Fushë Kosovë, Osojane (Istog), Gorazhdec (Pejë), Rahovec, Donja Gušterica dhe Lepinë (Lipjan), Dragash dhe Verbovac (Viti).

[37] Intervistë, zyrtar komunal serb i vendosur në Ranillug, janar 2015.

[38] Besimi po shtohet dhe serbët kërkojnë kujdes mjekësor në spitalet e drejtuara nga shqiptarët. Intervistë, Gorazhdec (Pejë), nëntor 2014.

[39] Komunat shqiptare mirëmbajnë shkollat e tyre, duke paguar shërbimet komunale dhe shumë paga. Donatorët ndërtojnë dhe rinovojnë shkollat, dhe Beogradi siguron plan-programe dhe paga. Intervista, Gorazhdec (Pejë), Kamenicë, Ranillug, shtator 2014 – janar 2015.

[40] Subvencionet janë jetike për ata që ende punojnë tokën. Sidoqoftë, një përfaqësues serb në Kamenicë (intervistë, janar 2015) tha se shumë fermerë kishin shitur tokën e tyre tek fqinjët shqiptarë dhe e kishin regjistruar shitjen vetëm në gjykatën

Njerëzit në këto enklava jetojnë në qetësi të rrethuar prej popullsisë shumicë. Qëndrueshmëria e tyre ka tre sfida kryesore. Së pari, ata janë të ndjeshëm ndaj krimit të vogël, të cilin, shpesh Policia e Kosovës është e paaftë për ta ndalur . Në shumë zona, kjo është e kufizuar prej prerjes së paligjshme të drunjve dhe uzurpimit të fushave (shqiptarët që punojnë tokat e serbëve pa leje, ndonjëherë duke përdorur frikësimin ose dhunën për të mbajtur larg pronarët). Pikëpamja e përgjithshme është që policia përgjigjet ndaj telefonatave dhe bën ndonjë përpjekje, por me shumë pak efekt. Në ato zona, policia duhet të angazhojë më shumë policë dhe të punësojë anëtarë që i përkasin komunitetit.

Punësimi është problemi i dytë. Grupi për Ballkan nuk gjeti thuajse asnjë serb në enklava, që të raportonte se punonte për institucionet e Kosovës, përveç policisë dhe zyrave të komunitetit lokal.[41] Shumica e punëve publike praktikisht janë mbyllur ndaj serbëve të cilët nuk kanë lidhje (personale apo partiake) të cilat nevojiten për të gjetur punë. Një banor raportoi "U ktheva në 2006-ën për të gjetur një punë në sistemin e Kosovës. Nuk munda, [ndaj] m'u desh të kthehesha në punën time të vjetër në administratën serbe, e cila nuk paguan mirë."[42] Disa individë në biznesin privat, arrijnë të shesin tek klientët shqiptarë, por shumë të tjerë nuk kanë treg për shkak të identitetit të tyre. Popullata e madhe e fermerëve është veçanërisht e prekshme pasi mund të jetë e vështirë për ta që të shesin personalisht në tregjet e fshatrave.[43] Graçanica dhe Mitrovica e Veriut mbeten tregjet e tyre jetike. Aftësitë gjuhësore mund të jenë problem, edhe pse shumë enklava serbe flasin shqip me një lloj rrjedhshmërie. Diskriminimi etnik i vazhdueshëm mbetet faktor. Donatorët ndërkombëtarë duhet të mbështesin programet për të identifikuar pengesat për punësim, dhe Prishtina duhet të zbatojë politika për t'i thyer ato.

Së treti, ata varen shumë nga disa institucionet serbe të cilat nuk kanë vend të parashikuar në procesin e integrimit. Më të rëndësishmet nga këto, janë zyrat postare dhe administratat komunale rudimentare. Shumë zyra postare janë mbyllur pas pavarësisë në vitin 2008, por që prej asaj kohe, Beogradi i ka rihapur ato në mënyrë të qëndrueshme, duke irrituar shumë Prishtinën.[44] Këto dy shërbime nuk bashkëpunojnë, dhe mbetet e pamundur që të dërgohen letra midis Kosovës dhe Serbisë pa përdorur njërën prej zyrave serbe. Serbët e enklavave marrin rroga, pensione dhe transferime të tjera financiare përmes bankës së zyrave postare, duke e bërë një litar shpëtimi jetik.[45] Posta e Prishtinës dhe Beogradit duhet të bien dakord që të bashkëpunojnë, dhe punonjësit serbë duhet të integrohen në zyrën postare kosovare. Qeverisja komunale serbe është e ngjashme me atë në komunat jugore me shumicë serbe, në atë që stafi i tyre, pozicionohet edhe në qeverisjen vendore të Kosovës.[46] Në enklava, këto

e Kosovës, megjithatë vazhdonin të aplikonin për subvencione nga Serbia dhe t'i merrnin ato. Të tjerë marrin subvencione për tokën që ua kanë dhënë me qira fermerëve shqiptarë.

[41] Në Klinë, në institucionet e Kosovës punojnë vetëm tre serbë.

[42] Intervistë, zyrtar komunal serb, Klinë, janar 2015. Banori ka deklaruar se familja e tij ka marrë shërbim mjekësor më të mirë (dhe pa pagesë) në spitalin e Pejës, vitet e para kur është kthyer. Tani anëtarët e familjes së tij shpesh duhet të paguajnë ryshfet.

[43] Intervistë, zyrtar komunal serb, Klinë, janar 2015.

[44] Intervistë, zyrtar qeveritar shqiptar, Prishtinë, janar 2015.

[45] Intervista, Osojane (Istog) dhe Klinë, janar 2015.

[46] Ushtruesi i detyrës së kryetarit (serb) të Komunës së Kosovska Kamenica është po ashtu anëtar i kuvendit komunal (të Kosovës); intervistë, Kamenicë, janar 2015.

"qeverisje" janë shkarkuar nga shumica e funksioneve të tyre, por ende kanë disa qindra njerëz në listë të pagave, dhe sigurojnë një lidhje me shërbimet serbe, kryesisht vetëm përsa i përket dokumentacionit.[47]

Enklavat e pjesës perëndimore të Kosovës janë më të ekspozuarat. Ky rajon ishte vendndodhje e sulmeve brutale dhe krimeve të rënda nga forcat serbe gjatë luftës së 1998-1999 dhe tensionet etnike mbeten të larta. Serbët këtu janë të ndjeshëm ndaj sulmeve të shpeshta ndaj individit dhe pronës.[48] Kjo mund të përkeqësohet nga mungesa e oficerëve serbë, ku vetëm në stacionin e Pejës ka prani domethënëse serbe (pesë oficerë) me vetëm një në Istog, dhe asnjë në Klinë.[49]

Ndërsa popullata vendase këtu ka besim në PK, pavarësisht etnisë së tyre, enklavat mund të përfitojnë nga një zonë ndikimi më e madhe e policisë. Policia e Kosovës duhet të hapë nënstacione në fshatrat më të mëdha, me personel shqiptar dhe serb, dhe të krijojnë patrulla të rregullta në zonat më të vogla në rrethina.

Disa enklava kanë pak fëmijë. Klina, e cila dikur ka qenë shtëpi e rreth gjashtëmijë serbëve, tani ka vetëm disa qindra, dhe shkolla serbe ka vetëm shtatëmbëdhjetë nxënës.[50] Projektet ndërkombëtare për mbështetjen e kthimit, kanë sponsorizuar ndërtimin e 457 shtëpive të projektuara për rreth 1,500 persona, por vetëm pak prej tyre janë kthyer plotësisht; shumë prej tyre e morën pronësinë e shtëpisë por nuk u kthyen, dhe mund të ketë vetëm 380 serbë në komunë, shumica e tyre pensionistë. Fshati Osojane (Istog) ka një shkollë ku 30 mësues japin mësim për afro 45 - 50 nxënës, ndërkaq disa klasa kanë vetëm nga 2 nxënës. Shumë prej mësuesve punojnë me orar të pjesshëm. Shkolla nuk ka paguar faturat për shërbime publike që prej vitit 2006 dhe ka një borxh prej mbi 17,000 € vetëm në energji elektrike.[51] Këto enklava mund të zhduken me plakjen e popullsisë së tyre.

Marrëdhëniet ndër-komunale janë shumë më të shëndetshme në pjesën e Kosovës lindore. Për shembull, në Kamenicë, serbët vendorë mbështetën një prej kandidatëve shqiptarë për kryetar komune, mirëpritën përpjekjen e tij për të bërë fushatë në fshatrat e tyre, dhe votat e tyre siguruan margjinën për fitore. Kryetari i komunës iu është mirënjohës për mbështetjen dhe ka premtuar të punojë për të mirën e tyre.[52] Autoritetet komunale janë duke u përpjekur të gjejnë hapësirën për një klinikë shëndetësore të drejtuar nga Serbia, e cila përballet me dëbim.[53] Fëmijët shqiptarë dhe serbë ndjekin shkolla të ndara që gjenden në një oborr, dhe ka edhe përleshje të rastësishme, dhe kjo ndodh kryesisht gjatë ngjarjeve sportive. Serbët këtu gravitojnë rreth qyteteve në jug të Serbisë (Vranjë) më shumë se sa ndaj Mitrovicës së Veriut,

[47] Komuna serbe ka rreth 200 njerëz në listë të pagave, përfshirë kopshtin lokal, kompanitë publike dhe institucionet; intervistë, Kamenicë, janar 2015.

[48] Intervistë, shefi i zyrës për komunitetet, komuna e Klinës, janar 2015.

[49] Profilet komunale të OSBE-së, mars 2014.

[50] Intervistë, zyrtar komunal serb, Klinë, janar 2015, Profili komunal i OSBE-së, Klinë, mars 2014.

[51] Serbia nuk paguan për të gjitha shpenzimet e bëra nga shkollat serbe; komunat e Kosovës shpesh paguajnë për disa ose të gjitha prej shërbimeve komunale, edhe pse praktika ndryshon nga vendi në vend. Intervista, punonjës shkolle, Osojane, janar 2015. Në Istog, shkollat, përfshirë mësuesit, ishin integruar në buxhetin komunal deri në vitin 2006 kur Beogradi i udhëzoi t'i hiqnin nga sistemi i Kosovës. Që atëherë, shkollat serb nuk marrin përfitime nga komuna.

[52] Intervistë, zëvendës presidenti i kuvendit komunal, Kamenicë, janar 2015, dhe majori Begzad Sinani, Prishtinë, shkurt 2015

[53] Klinikën e përdorin edhe shqiptarët vendas për të përfituar referime për kujdes të specializuar në Serbi. Intervistë, Kamenicë, janar 2015.

dhe priren t'i shohin banorët e asaj pjese me dyshim dhe pakënaqësi.[54] Shumë posedojnë makina të regjistruara në sistemin serb dhe nuk mund t'i regjistrojnë në vend për shkak se Kosova i konsideron si import për të cilat duhet të paguhet doganë. Ky problem rrjedh prej skadimit të afatit përfundimtar të regjistrimit, dhe së bashku me koston e lartë të sigurimit, pengon edhe lëvizjen e lirë. Prishtina duhet të zgjasë periudhën grace për regjistrimin e automjeteve, si pjesë e procesit të integrimit.

Disa enklava në Kosovë, lulëzojnë përkundër të gjitha gjasave e vështirësive. Serbët jetojnë të patrazuar në dy fshatra të izoluar në Skënderaj, një vatër e nxehtë e nacionalizmit shqiptar, ku në vitin 2004, vandalët shkatërruan një manastir mesjetar serb. Po ashtu, ka disa shkolla serbe me 100 nxënës në total, që sugjeron një popullatë shumë më të madhe se sa tregojnë shifrat zyrtare.[55] Banorët nuk u larguan gjatë luftës dhe kanë vetëm kontakte të kufizuara me komunën.[56] Në Gorazhdevc, një fshat ku sulmues të paidentifikuar qëlluan gjashtë serbë në vitin 2003, sot mbizotëron qetësia. Institucionet kosovare dhe serbe janë grumbulluar karshi njëra-tjetrës në një shesh të vogël, dhe shkolla drejtohet nga sistemi serb, por me shërbime komunale dhe dru zjarri të siguruara nga komuna e Pejës. Problemi kryesor për këtë enklavë është mungesa e punëve të mira; në mungesë të mjeteve për të filluar familje, si rrjedhojë të rinjtë e shtyjnë martesën ose largohen.[57]

Ligji i detyron komunat me popullsi pakicë prej 10 për qind ose më shumë, që të krijojnë postin e zëvendës kryesuesit të asamblesë komunale për komunitete. Ky zyrtar është përgjegjës për "promovimin e dialogut ndër-komunitar", dhe mund t'i kërkojë asamblesë që të rishqyrtojë aktin që ajo ose ai e konsideron si të dëmshëm. Zëvendës-kryetari mund edhe t'i çojë mosmarrëveshjet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese.[58] Kryetarët e komunave në këto komuna, kërkohen të caktojnë një zëvendës për komunitete, i cili i këshillon ata.[59]

Institucionet e Shtetit

Plani i Ahtisaarit ka propozuar për serbët një set mjetesh të balancuara për të kërkuar dhe mbrojtur interesat e tyre në Kosovë – përfshirë shtimin e kompetencave komunale dhe një rol të shpërpjesëtuar në qeverisjen qendrore, të mbështetur nga një fuqi e kufizuar vetoje. Beogradi i ka negociuar këto kushte, por refuzoi planin për shkak se ai përfshinte dispozitat për pavarësinë e Kosovës. Sidoqoftë, në atë kohë plani nuk vuri shumë theks mbi bashkëpunimin ndër-komunitar. Disa në Beograd i shohin përfaqësuesit serbë në Kuvendin e Kosovës, si më të rëndësishëm se sa në Asociacion, në lidhje me mbrojtjen e interesave dhe lehtësimin e koordinimin me Serbinë në nivelet lokale dhe qendrore.[60] Ky kapitull

[54] Ministria e Transportit e Kosovës, subvencionon një linjë autobusi në Mitrovicën e Veriut për studentët, tre ditë në javë, ndërsa për në Vranjë ka autobusë disa herë në ditë.

[55] OSBE-ja përllogarit 350 serbë, edhe pse Asociacioni i Agjencive Rajonale të Zhvillimit (arda-kosovo.org) ka dhënë shifrën prej 1,000 banorësh në një aplikim për financim.

[56] Intervista, banorë të fshatrave Banjë dhe Suvo Grlo, Skenderaj, janar 2015. Në Suvo Grlo ka një nënstacion të PK-së, edhe pse komuna si e tërë, ka vetëm një polic serb. Profili komunal i OSBE-së, mars 2014.

[57] Intervistë, zyrtarë të shkollës, komunës dhe shëndetësisë, Gorazhdec, shtator 2014.

[58] Ligji për VQL, neni 54 dhe 55.

[59] Ibid., art. 61.

[60] Intervistë, zyrtar i lartë serb, Beograd, prill 2014.

ekzaminon pjesëmarrjen serbe në qeverisjen qendrore dhe lokale, dhe çfarë nevojitet për të përparuar integrimin në këto fusha kryesore.

Beogradi në Kosovë

Sipas një ish kryetari komune në veri, ironia kryesore e Marrëveshjes së Brukselit është ajo se "çdokush mendonte se ne ishim të kontrolluar nga Beogradi, por nuk ishim. Njerëzit e rinj [ata] të zgjedhurit në sistemin e Kosovës, janë realisht nën kontrollin e Beogradit".[61] Procesi i hartuar për të lehtësuar daljen e Serbisë nga Kosova, në fakt, ose si fillim, ka çimentuar ndikimin e vet në politikat në Kosovë. Prishtina e ka pranuar këtë tani për tani. "Serbët janë besnikë ndaj Beogradit, dhe ne presim prej tij që të na i dorëzojë neve", tha një zyrtar i lartë.[62] Edhe pse e pranojnë faktin se në të ardhmen e afërt, serbët vendas do të jenë më besnikë ndaj Beogradit sesa ndaj Kosovës, zyrtarët duan që ata të integrohen më shpejt, dhe që Serbia të veprojë në territorin e Kosovës në një mënyrë që nuk e kërcënon zbatimin e shtetit.

Pas pavarësisë, në Kosovë u zhvilluan dy elita serbe të dalluara. Në veri, udhëheqësit që formalisht i përkisnin partive serbe nuk ishin shumë besnikë ndaj shefave të partive të tyre në Beograd. Lidhjet lokale dhe respekti popullor ishin më të rëndësishmet. Diku tjetër, politikanët me bazë në Serbi, ishin të parëndësishëm, ndërsa përmes strukturave të Kosovës, dolën udhëheqës të rinj të trajnuar në arenën ndërkombëtare, kryesisht Partia Liberale e Pavarur (Samostalna Liberalna Stranka, SLS). Qeveria serbe kishte pak kontroll mbi të dy llojet e liderëve. Kur politikat e Beogradit u rreshtuan me preferencat e serbëve në veri, u lehtësua bashkëpunimi, por nga ana tjetër, u shtuan tensionet kur Serbia, nën trysninë ndërkombëtare, ra dakord t'i integronte ata në sistemin e Kosovës.

U shpërfillën disa përpjekje ndërkombëtare për të ushqyer serbët e pjesës veriore të rritur në Kosovë, që të tregoheshin të hapur për bashkëpunimin me Prishtinën, sipas modelit të SLS.[63] Duke humbur durimin, komuniteti ndërkombëtar në vitin 2013 ndryshoi kursin, dhe e bëri Beogradin plotësisht përgjegjës për arritjen e pajtueshmërisë nga ana e veriut.[64] Serbia e arriti këtë duke pastruar të gjithë udhëheqjen dhe duke i zëvendësuar ata me të tjerë të gatshëm për të bashkëpunuar me institucionet e Kosovës, dhe që të hynin në zgjedhje me ligjet e Kosovës. Megjithatë, operacioni që synonte thyerjen e arrës së fortë të veriut, theu edhe SLS-në e jugut. Si pasojë, Beogradi futi një kuadër të ri të disiplinuar dhe plotësisht të kontrolluar.

Autoritetet e sapozgjedhura në veri, janë më të lidhura ngushtë me Beogradin, i cili i ka zgjedhur me dorë dhe ka organizuar zgjedhjen e tyre, sesa me Prishtinën.[65] Alexander Vulin, deri rishtas Ministër i Serbisë për Çështjet e Kosovës, ishte i përfshirë thellë në menaxhimin e udhëheqësve të pjesës veriore dhe marrëdhënien e tyre me qeverinë e Kosovës.[66] Beogradi i

[61] Intervistë, ish kryetar komune, Kosova veriore, prill 2014.

[62] Intervistë, Prishtinë, shtator 2014.

[63] "Strategjia për veriun" e janarit 2010, është një shembull. Shih "Kosova: Strategjia për Veriun e Kosovës, një Hap i Rëndësishëm në Drejtimin e Duhur", kabllo i Ambasadës së SHBA, 29 janar 2010, publikuar nga Wikileaks.

[64] Intervistë, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, prill 2014.

[65] Shih "Diçka Tërësisht e Ndryshme në Kosovën Veriore", raport i Grupit për Ballkanin, 23 tetor 2013, dhe "Të zaptuar dhe të Padrejtë në Kosovën Veriore", postimi në blog nga Grupi për Ballkanin, 7 shkurt 2014 për historikun e rolit të Beogradit në zgjedhjet në Kosovë.

[66] Sipas dokumenteve të dhëna Grupit për Ballkanin, Ministri Vulin i informoi zyrtarët e jashtëm për ecurinë e bisedimeve mes kryetarëve të komunave të Kosovës dhe ministrave.

detyroi edhe serbët në jug që të votonin për kandidatët që mbështeste vetë, aty ku pjesëmarrja në zgjedhje kishte qenë e lartë në të kaluarën. Në komunat si Novobërda, zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme kërcënonin me humbje pune apo pensioni nëse qytetarët nuk dilnin në votime.[67]

Në zgjedhjet lokale të nëntorit 2013, kandidatët e SLS-së humbën kudo ndaj Listës serbe të mbështetur nga Beogradi, përveç se në Shtërpcë, me rezultat të ngushtë. Mësimi nuk shkoi huq për politikanët serbë: Mbështetja e Beogradit është gjëja më e rëndësishme.[68] SLS-ja pranoi ofertën e Beogradit dhe iu bashkëngjit Listës Serbe për zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2014. Disa politikanë të vjetër nuk e pëlqejnë rolin e Beogradit, duke u ankuar se mesazhi që ju shkon ndaj votuesve është "Ju mund të zgjidhni cilindo të doni, për aq kohë sa është ai që kemi zgjedhur ne", dhe zyrtarët serbë në detyrë refuzojnë të bashkëpunojnë me zyrtarë që nuk janë në Listën Serbe.[69]

Serbia ka përdorur kontrollin e ri të plotë të sapofituar mbi politikanët serbë në Kosovë, për të përmbushur detyrimet e veta ndaj BE-së dhe për të nxitur integrimin. Një zyrtar serb në Prishtinë pret që kjo të vazhdojë, me Beogradin që kërkon të bëjë pazare me koncesionet rreth çështjeve të Kosovës, për përfitime që s'kanë të bëjnë me të diku tjetër, si për shembull financimi i BE-së dhe negociatat për hyrje në BE.[70] Një anëtar serb i Kuvendit të Kosovës paralajmëron se kjo mund të ndryshojë brenda natës. Grupi parlamentar i Listës Serbe në Kuvend "është një bombë me telekomandim" me gishtin e Beogradit mbi buton, në gjendje të bllokojë vendime të rëndësishme, dhe mundësisht edhe të rrëzojë qeverinë.[71] I njëjti zyrtar paralajmëron se përfaqësuesit aktualë serbë do të integrohen deri në atë masë sa të mund të largohen në çdo moment që do të duan, ose kur t'i udhëzojë Beogradi.[72] Bojkoti i janarit 2015 e mbështet këtë deklaratë.

Elita e re politike serbe nuk bën përpjekje për të fshehur besnikërinë e vet. Një serb me ndikim i cili u zgjodh ne një pozitë të lartë në Kosovë, tha se kishte shumë pak frikë se mos shtyhej tutje nga shumica, pasi "shqiptarët që kanë punë me ne, e dinë se kanë punë me Serbinë," dhe "kur ne themi jo, është Serbia ajo që thotë jo."[73] Qeveria e Kosovës është e shqetësuar për lidershipin e ri serb dhe për nderimin që ata i bëjnë Beogradit. Ata e nënvlerësuan dëshirën për lidhje të forta me Serbinë dhe tashmë janë të pasigurt për mënyrën se si duhet t'i trajtojnë.[74] Rreziku mbetet se politikanët shqiptarë, duke i konsideruar serbët lokalë si zgjatime të Beogradit, do të ushtrojnë trysni ndaj tyre duke u përpjekur të ushtrojnë ndikim mbi Serbinë.

---

[67] Intervistë, zyrtar komunal dhe anëtar i kuvendit komunal, Novobërdë, prill 2014. Në Shtërpce, policia arrestoi një oficer të MUP ndërsa ai po u bënte presion qytetarëve për të votuar për një kandidat.

[68] Intervistë, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, prill 2014.

[69] Intervistë, ish anëtar i kuvendit komunal serb, prill 2014.

[70] Intervistë, ministër serb, Prishtinë, prill 2014. Një vëzhgues ndërkombëtar i kërkoi një anëtari serb të Kuvendit të Kosovës për një takim, dhe kujton t'i jetë thënë "thirr [njeriun e Beogradit] dhe kërkoji të më urdhërojë që të takohem me ty". Intervistë, Mitrovicë e Veriut, shtator 2014.

[71] Intervistë, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, prill 2014.

[72] Ibid.

[73] Intervistë, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Kosovë veriore, shtator 2014.

[74] Intervistë, ministër serb, Prishtinë, prill 2014.

Kjo gjendje rezulton nga lidhja e serbëve me Serbinë zyrtare dhe frika për t'u marrë drejtpërdrejtë me Prishtinën dhe prej synimit të Beogradit për të penguar autoritetin e Kosovës. Udhëheqësit e vjetër dhe të rinj bien dakord dëshpërimisht se mund të kishin arritur rezultat më të mirë po të kishin negociuar vetë me qeverinë e Kosovës.[75] Komuniteti serb ka nevojë për një zë të pafiltruar nga interesat momentale të Serbisë për anëtarësim në BE. Beogradi, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të bashkëpunojnë në forcimin e zhvillimit të udhëheqësve serbë të rrënjosur në vend.

Administrata qendrore

Sipas kushtetutës, Serbët kanë të drejtën për të caktuar 10 delegatë në Kuvendin e Kosovës.[76] Këta 20 (sipas eufemizmave zyrtare "jo-shumica") mund të veprojnë së bashku për të bllokuar disa kategori të legjislacionit që janë të dëmshme për interesat e komuniteteve të tyre. Kushtetuta mund të ndryshohet vetëm me një shumicë bashkëvepruese, përfshirë dy të tretat e delegatëve jo shumicë. Meqenëse nevojiten katërmbëdhjetë vota pohuese jo-shumicë, në të vërtetë shtatë delegatë serbë mund të vendosin veto për një amendament. Në praktikë, shqiptarët do të përpiqen të krijojnë një konsensus përpara propozimit të ndryshimeve kushtetuese. Ligje të tjera me "interes jetik" ndaj komuniteteve kërkojnë një shumicë të thjeshtë bashkëvepruese për të kaluar.[77] Këto dispozita janë përdorur pak, pjesërisht për shkak se ligjet me interes jetik kanë kaluar nën mbikëqyrjen e Zyrës Ndërkombëtare Civile (ICO), organi i ngarkuar me zbatimin e planit të Ahtisaarit, por një sërë iniciativash në horizont – kryesisht një propozim për të ndryshuar kushtetutën dhe për të transformuar Forcën e Sigurisë së Kosovës në ushtri – do t'i sillte në lojë. Përveç kësaj, dy prej nëntë gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese mund të caktohen vetëm nga një shumicë delegatësh jo-shqiptarë. Serbët po ashtu mbajnë vetëm një ulëse në Komision Qendror Zgjedhor, një prej zëvendës-kryetarëve të Kuvendit dhe dy ulëse në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Në legjislaturë, serbët kanë katër ulëse në Komitetin e Kuvendit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve; minoritetet e tjera kanë katër të tjerë, dhe partitë shqiptare kanë katër ulëset e mbetura.[78] Kjo mund të jetë mjeti më i fuqishëm i serbëve për shkak se në parim, i gjithë legjislacioni duhet të kalojë përmes këtij komiteti përpara se të shndërrohet në ligj. Që të përdoret me efektivitet, ata do të kenë nevojë për mbështetjen e tre delegatëve të tjerë minoritarë, ndaj duhet të bëjnë si prioritet marrëdhënien e mirë të punës me partitë e tyre. Në të kaluarën, delegatët serbë kanë pasur sukses të madh në këtë komitet.[79] Konteksti i të qenit në një komitet është më i qetë për marrëdhëniet legjislative të cilat delegatët e rinj duhet t'i shfrytëzojnë plotësisht.

[75] Intervista, Kosova veriore, nëntor 2013 dhe prill 2014.

[76] Komuniteti boshnjak merr tre vende, ai turk dy, roma, ashkali dhe egjiptian ("RAE") nga një secili; një ulëse shtesë i shkon partisë RAE me numrin më të madh të votave; goranët marrin një ulëse vetëm nëse të gjithë të tjerët nuk e kanë tejkaluar kuotën e tyre të garantuar. Kushtetuta, neni 64.

[77] Shih Kushtetutën, neni 81, për një listë ligjesh "interesash jetike" (ndryshimet në kufijtë komunalë, kompetencat komunale, përdorimin e gjuhës, etj.) shumica konkurruese e nevojitur për kalimin e tyre, është prej të gjithë delegatëve jo0shumicë që janë të pranishëm dhe votojnë, kështu që serbët nuk mund të japin veto duke abstenuar, ose pa mbështetjen minimale të delegatëve të tjerë nga pakicat.

[78] Përfaqësuesi i zgjedhur egjiptian, është regjistruar në grupin parlamentar të LDK-së.

[79] Për shembull, ata kanë fituar futjen e ndryshimeve të ligje në Velika Hoča dhe në qendrën historike të Prizrenit, dhe kanë vonuar një ligj problematik në shitjen e apartamenteve. Komunikimi përmes E-mail, ish anëtar i komitetit, 21 nëntor 2014.

Meqenëse asnjë grup i vetëm nuk mban më shumë se një të tretën e ulëseve të komitetit, kjo nuk përbën një veto etnike. Megjithatë, fuqitë e tij më të mëdha janë shkruar në rregullat e procedurës së Kuvendit, një akt nënligjor që mund të ndryshohet me shumicë të thjeshtë; do të ishte më mirë që ato të përmirësoheshin në Kushtetutë, ose në një ligj me interes jetik. [80] Të drejtat e tyre formale janë një skelet mbi të cilin udhëheqësit serbë mund të ndërtojnë muskujt duke kalitur marrëdhënie efektive me ligjvënësit e tjerë, duke përfshirë ata nga shumica shqiptare. Pjesëmarrja e rregullt në debatet e Kuvendit është një vend i mirë për të filluar.[81] Delegatët (dhe të gjithë serbët e emëruar në postet e larta në institucionet qendrore) duhet të mësojnë gjuhën shqipe, dhe qeveria duhet të ofrojë trajnime falas dhe të leverdisshme për gjuhën. Gjuha serbe është gjuhë zyrtare dhe gjuhë të cilën ata duhet të ndjehen të lirë ta flasin në Kuvend, por realiteti është se çdokush që nuk ka ndonjë aftësi të gjuhës shqipe, do të margjinalizohet. Ata duhet të rrisin rolin e tyre të përcaktimit të politikave dhe duhet të kërkojnë punë në ministritë e financave, punëve të jashtme, në zyrën e kryeministrit, dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Sa më aktivë të bëhen në qeveri, aq më dukshëm kontribuojnë ata në të mirën e përbashkët, dhe aq më shumë respekt do të fitojnë.

Serbët kanë të drejtën për një post ministror dhe dy zëvendës-ministra.[82] Në negociatat e tensionuara për formimin e një koalicioni qeverisës, ata fituan një pjesë shumë më të madhe: dy poste ministrore dhe gjashtë poste zëvendës-ministrash, plus një zëvendës-kryeministër.[83] Ata kërkuan ministritë e vetëqeverisjes lokale dhe kthimeve; zëvendës-kryeministri është pa portofol dhe me një rol që duhet të përcaktohet. Ndërsa dy ministritë janë të rëndësishme për interesat serbe, do të ishte gabim të injorohen pothuajse të gjitha çështjet e tjera ekzekutive. Gjashtë vendet e caktuara të zëvendësve u lejojnë udhëheqësve serbë një zë në shumë fusha të rëndësishme dhe për të ndërtuar marrëdhënie konstruktive pune me bashkëpunëtorët shqiptarë. Serbët tregojnë pak interes në ministritë si ato të shëndetësisë dhe arsimit (sepse ata mbështeten në sistemin serb në ato fusha), dhe e kanë të vështirë të kontribuojnë në punët e jashtme pasi ata e refuzojnë pavarësinë e Kosovës.[84] Sidoqoftë, do të ishte gabim që të shmangeshin prej portofoleve si bujqësia, zhvillimi ekonomik, financat, infrastruktura, punët e brendshme dhe drejtësia.[85]

Këto të drejta janë mbresëlënëse për një minoritet që përbën rreth 8.5 për qind të popullatës së përgjithshme– sipas përllogaritjeve tona – por ata janë të ndjeshëm ndaj anashkalimit dhe shfuqizimit. Më këtë rast, shumica e ka anashkaluar pakicën për të miratuar ligjet.[86] Ministrat

[80] Vetë komiteti është i vetmi organ i Kuvendit i kërkuar me Kushtetutë (neni 78), i cili i jep disa kompetenca këshilluese themelore. Rregullat e procedurës shkojnë më tej, duke fuqizuar Komitetin të "vendosë për kalimin e projektligjeve me shumicë votash nga anëtarët e vet" dhe të kërkojë informacione dhe dëshmi nga ministrat (Shtojca II, neni 2).

[81] Delegatët serbë kanë marrë pjesë sporadikisht; disa nuk janë shfaqur për votat. Grupi i Krizave, "Lirimi i Kosovës," op. cit., p. 5.

[82] Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, atëherë duhet të ketë një ministër shtesë nga jo-shumica (i cili mund të jetë serb) dhe një zëvendësministër serb shtesë. Kushtetuta, Neni 96.

[83] Shih marrëveshjen e koalicionit në Alban Muhaxheri, Ekskluzive: Marrëveshja PDK-LDK- Lista "Srpska" (Dokument)" (Ekskluzive: Marrëveshja PDK-LDK – Lista "Srpska" (Dokumenti)), Zëri, 9 dhjetor 2014 (online).

[84] "Për ne, [punët e jashtme] nuk ekziston"; intervistë, anëtar i Kuvendit të Kosovës, pjesa veriore e Kosovës, shtator 2014.

[85] Saša Rašić, për shembull, ishte një prani e fortë si zëvendës ministër i punëve të brendshme në qeverinë e mëparshme.

[86] Korrespondencë me Email me një ish-anëtar të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, 21 nëntor 2014.

serbë kanë qenë të ndrojtur në qeveri dhe nuk i kontrollojnë plotësisht ministritë e tyre – një problem i përbashkët në sistemin politik kosovar të dominuar nga partitë.[87] Ato pak ligje të hartuara për të mbrojtur interesat e minoritetit, janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme, disa madje, "me zor" se janë respektuar.[88]

Serbët (dhe minoritetet e tjera në përgjithësi) mbeten ende shumë pak të përfaqësuara poshtë nivelit të posteve që iu janë garantuar me kushtetutë. Sipas ligjit, minoritetet do të mbushin dhjetë për qind të posteve në institucionet qendrore.[89] Ky është një cak i mirë që duhet arritur për sa i përket kontekstit të integrimit. Një studim i sponsorizuar nga qeveria në vitin 2013, zbuloi se serbët kishin vetëm rreth 5.5 për qind të pozicioneve qeveritare.[90] Madje dhe kjo mbetet shumë optimiste, pasi shumë agjenci qeveritare janë thuajse pa asnjë staf minoritar.

Vetëm katër prej 22 institucioneve kryesore (zyrat e presidentit dhe kryeministrit, ministritë, etj.) plotësojnë një 10 për qindësh modest për serbët dhe përfaqësuesit e tjerë jo-shqiptarë. Disa ministri, puna e të cilave është e rëndësishme për minoritetet, ishin shumë më poshtë se kjo: ministria e punëve të brendshme kishte 4.8 për qind (sidoqoftë, Policia e Kosovës e ka tejkaluar synimin); zhvillimi ekonomik, 2.1 për qind; financat, 1.9 për qind; dhe drejtësia, 0.9 për qind. Ministria për Integrime Evropiane nuk ka staf minoritar. Situata është po aq e keqe në agjencitë ekzekutive. Administrata tatimore ka 3.2 për qind; pylltaria (e rëndësishme për shumë zona serbe), 3 për qind; thesari, 1.5 për qind; dhe doganat, 1.4 për qind. Agjencitë e pavarura po ashtu kanë ngecje. Rregullatori i Prokurimit Publik, 3.7 për qind; Agjencia Kundër Korrupsionit, 2.9 për qind; Banka Qendrore, 2.7 për qind; dhe Rregullatorët e Energjisë dhe Telekomunikacionit, 0 për qind, ku të gjithë janë shumë të rëndësishëm për interesat e minoriteteve. Kompanitë më të mëdha publike janë përmbushësit më të dobët: serbët mbajnë më pak se 1 për qind të punëve në korporatat shtetërore të Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) dhe korporatat energjetike (KEK dhe KOSTT).[91].

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) përbën një përjashtim, ku stafi minoritar është 10% afër cakut të synuar, por, pavarësisht një ministri serb me profil të lartë (i cili ishte dhe zëvendës kryeministër), ajo është përpjekur me gjendjen morale dhe me efektivitetin. Stafi është ankuar se ministri në dalje nuk ka ofruar udhëheqje, dhe se i vetmi udhëzim që ata kanë marrë, ishte që t'i mbanin serbët dhe veriun larg prej lajmeve.[92] Shumë prej tyre ndjejnë se ministria ka arritur më shumë kur kishte një ministër shqiptar të fortë, dhe atë që është arritur deri tani, ia dedikojnë një shërbyesi civil të lartë shqiptar dhe të përkushtuar.[93] Portofoli i ka shkuar Ljubomir Mariqit, ish kryesues i "Ekipit Menaxhues" për Asociacionin e

[87] Intervistë, ministër serb, Prishtinë, prill 2014. Nëpunësit civilë shpesh ndjekin urdhrat e eprorëve të tyre partiakë, në vend të ministrave të tyre.

[88] Korrespondencë me Email me ish-anëtarin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, 21 nëntor 2014.

[89] Ligji Nr.03 / L-149 për shërbyesit civilë, Republika e Kosovës, Neni 11.3. Ligji gjithashtu rregullon përfaqësimin e minoriteteve në nivel vendor, i cili korrespondon me përbërjen e popullsisë në territorin e komunës.

[90] Novus Consulting, "Vlerësimi mbi punësimin e anëtarëve të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike", korrik 2013. Të dhënat në paragrafin tjetër janë nga ky raport.

[91] Qeveria ka ofruar poste në KEK dhe KOSTT për pjesëtarët e Trupave të Mbrojtjes Civile

[92] Intervistë, zyrtar i MAPL, Prishtinë, maj 2014.

[93] Intervistë, zyrtar i lartë serb në qeverinë e Kosovës, Prishtinë, prill 2014.

Komunave Serbe, dhe një ekzekutivi në kompaninë e minierave të Trepçës. Integrimi serb varet shumë nga kjo ministri, dhe atij do t'i duhet të tregojë kurajë dhe lidership, si dhe të ketë mbështetje.

Është shqetësuese se shumë agjenci raportojnë pajtueshmëri të lartë me masat aktive të hartuara për të rekrutuar staf minoritar, por shumë pak dëshmojnë për përpjekjet e tyre.[94] Zyra e kryeministrit, zyra për çështje të komunitetit e të cilit është pikë fokusi për përfaqësimin minoritar, ka bërë disa hapa mbrapa.[95] Dikur e ndiqte punësimin e minoriteteve nëpër qeveri shumë detajisht, qoftë cilin komunitet minoritar, nivelin e pozitës, apo dhe shërbimin politik dhe civil, menaxherial apo administrativ.[96] Herën e fundit që është bërë një gjë e tillë, në vitin 2010, zbuloi se ndërsa zyra e presidentit kishte përmbushur 10% të synimit të vet, ajo kishte vetëm minoritete jo-serbe. Në shumë ministri, shumica e serbëve apo të gjithë, ishin staf mbështetës administrativ.[97] Vetëm 0.3 për qind e mbi 8,000 punëtorëve të KEK-ut ishin serbë – të gjithë nivel administrativ.

Beogradi i shkurajoi serbët që të pranonin punë në qeverinë e Kosovës, dhe kërcënoi se do t'i etiketonte si tradhtarë të gjithë ata që nënshkruanin kontrata me Prishtinën. Përballë këtij presioni, SLS-ja solli aq serbë të rinj sa mundën, por profesionistët serbë ende mbajnë pozita në administratën paralele serbe. Politika po ndryshon gradualisht, të paktën në nivel lokal; zyrtarë të rinj serbë po bëjnë plane që të mbushin të gjitha pozitat e hapura sipas ligjit.[98] Ndërsa mbyllen vendet e punës të financuara nga Beogradi, Kosova ka nevojë për një fushatë sistematike dhe efektive për të nxitur punësimin serb dhe të minoriteteve të tjera në të gjitha nivelet e institucioneve qendrore, përfshirë dhe kompanitë kombëtare publike. Serbët në nivel lokal janë të vetëdijshëm për këtë dhe e shohin Policinë e Kosovës, si institucionin e vetëm përfaqësues të nivelit qendror.[99] Serbët në pozita të larta vendimmarrëse, poshtë nivelit ministror, mund të japin një shembull jetik për komunitetin e tyre.[100] Për të qenë efektiv, programit të rekrutimit do t'i nevojitet kontribut nga udhëheqësit e komunitetit në të gjitha nivelet lokale dhe qendrore, dhe nga shoqëria civile, si dhe mbështetje të fortë diplomatike dhe nga donatorët.

Këmbëngulja e paralelizmit në qeverisjen lokale

Në aspektin lokal, serbët janë shumicë në dhjetë prej 38 komunave të Kosovës, secila me kompetenca disi më të mëdha se sa fqinjët e tyre me shumicë shqiptare.[101] Qeveria e

[94] Novus Consulting, op. cit., p.25.

[95] Përveç rënies së cilësisë së të dhënave, faqja elektronike e Zyrës për Çështje të Komunitetit për komunitetin serb me sa duket nuk është përditësuar që në vitin 2009, kur u krijuan komunat me shumicë serbe.

[96] Të dhënat për përfaqësimin e komuniteteve në institucionet e Kosovës (2010), të vëna në dispozicion ndaj Grupit të Ballkanit.

[97] Për shembull, të gjithë 38 serbët në ministrinë e bujqësisë ishin punonjës administrativë, siç ishin 11 nga 12 në (atëherë), ministrinë e ekonomisë dhe financave, 24 nga 26 në ministrinë e drejtësisë dhe 16 nga 17 në ministrinë e administratës publike.

[98] "Të gjesh një punë të Kosovës nuk është më një polemikë". Intervistë, zyrtar i qeverisë, Graçanicë, shkurt 2015

[99] Intervistë, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Novobërdë, prill 2014.

[100] Intervistë, banor i Koretishtes, Novobërdë, maj 2014.

[101] Të gjitha komunat me shumicë serbe kanë autoritet mbi çështjet kulturore, duke përfshirë "mbrojtjen, promovimin ... [dhe] mbështetjen" për trashëgiminë fetare dhe komunitetet; gjithashtu të gjithë kanë një rol në përzgjedhjen e komandantëve

Kosovës tani ka përfaqësues të zgjedhur në të gjithë territorin e vet, por qeveria serbe vazhdon të drejtojë institucionet e veta. Në disa vende, ato janë të vogla, thuajse të padukshme, por në të tjera – sidomos në pjesën Veriore të vendit – ato drejtojnë shumë shërbime qeveritare dhe janë shpenzuesi kryesor publik. Për serbët, qeveria është shuma e këtyre shtresave paralele, njëra i përgjigjet Beogradit, dhe tjetra Prishtinës. Krijimi i një sistemi efektiv dhe të qëndrueshëm në zonat me shumicë serbe në Kosovë varet nga shkrirja e tyre, dhe ka gjasa reale se do te jetë i vështirë. Nuk ekziston një plan i qartë, dhe asnjë nga dy kryeqytetet, dhe as komuniteti ndërkombëtar nuk tregon shumë urgjencë.

Serbia i ka rezistuar presionit ndërkombëtar për të sqaruar shtrirjen e listës së pagave në Kosovë.[102] Zyrtarët e BE-së përllogarisin rreth (përfshirë pagat, përfitimet, shpenzimet kapitale dhe gjithë shpenzimet e tjera) 350 milionë euro në vit.[103] Një zyrtar i lartë serb thotë se për administratat komunale të drejtuara nga serbët punojnë 5,860 persona.[104] Pothuajse të gjithë në veri kanë punë.[105] Në jug shumica janë të punësuar vetëm në letër. Disa marrin rrogë të plotë, të tjerët vetëm minimumin e lejuar me ligj.[106] Një zyrtar lokal vlerëson se rreth 22,000 njerëz marrin rrogë minimale, edhe pse thuajse gjysma e tyre mund të jetojnë në Serbi dhe nuk bëjnë asnjë lloj pune në Kosovë.[107] Përveç pesëmbëdhjetë administratave komunale të cilat Beogradi nuk i ka mbyllur ende, ka vende pune në kompani publike dhe institucione lokale.[108] Zyrtarët komunalë drejtojnë disa prej tyre, por gjithnjë e më tepër, ministrat serbë janë duke i administruar vetë drejtpërdrejtë, ose i lënë të veprojnë me mbikëqyrje minimale.[109]

Paratë kanalizohen prej ministrisë së financave përmes degëve të thesarit, dhe më pas, në bankat serbe, sidomos, banka postare dhe Komercijalna Bank. Udhëheqësit lokalë serbë i përshkruajnë si "institucionet kryesore" dhe theksojnë se qeveria e Kosovës nuk është përpjekur kurrë t'i mbyllë ato.[110] Banka Kombëtare e Serbisë "Grupi për Kosovën dhe

---

të policisë lokale. Tre komuna (Mitrovica e Veriut, Graçanica dhe Shtërpca) kanë përgjegjësinë për kujdesin shëndetësor sekondar; Mitrovica e Veriut ka autoritet për arsimin universitar. LSG, Nenet 19-23.

[102] Intervistë, këshilltar i anëtarit të qeverisë së Kosovës, Prishtinë, tetor 2014.

[103] Intervistë, zyrtarët e BE-së, Prishtinë, shtator 2014. Një hetim parlamentar serb gjeti se Serbia ka shpenzuar 2.83 miliardë euro në territorin e Kosovës prej 2000-2012, dhe shpenzimet e vlerësuara arritën kulmin në rreth 350 milion euro në 2008, duke rënë në rreth 250 milion euro 2009-2012, edhe pse një pjesë e rënies është për shkak të rënies së dinarit serb kundrejt Euros. "Izveštaj o utvrđivanju činjenica o načinu trošenja sredstava budžeta Republike Srbije na teritoriju autonomne pokrajine Kosova i Metohija" [Raport i komisionit hetimor për shpenzimet e buxhetit të Republikës së Serbisë në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë], prill 14 2014, f.7. Shumë bashkëbisedues sugjerojnë se një pjesë prej të hollave serbe kthehen në duart e burokratëve të korruptuar. Intervista, Mitrovica e Veriut, mars-prill 2015; Raporti i Grupit të Krizave "Integrimi serb në Kosovë: Në drejtim të rënies," 12. maj 2009.

[104] Intervistë, Budva, Mali i Zi, dhjetor 2014..

[105] Në Mitrovicën e Veriut, prej rreth 20.000 banorëve, është vlerësuar se më shumë se 7000 serbë fitojnë një rrogë shtetërore. Intervistë, Mitrovica e Veriut, nëntor 2014.

[106] Ka dy lloje të pagesës minimale, të dy të quajtura "minimalac" në gjuhën serbe. E para është paga minimale mujore për punëtorët e punësuar në mbarë Serbinë; kjo ndryshon sipas muajit, nga 19.360 RSD neto (□158) për muajin shkurt, në 22.264 RSD ((□181) në korrik. Punëtorët në Kosovë, të cilët janë të punësuar në letër por nuk bëjnë asnjë punë të vërtetë, e marrin këtë pagesë,së bashku me kontributet pensionale dhe shëndetësore. E dyta është "minimumi i Kosovës" prej gati 11.000 RSD që i paguhet serbëve të papunë prej Kosovës apo në Kosovë.

[107] Intervistë, zyrtar serb, Graçanicë, prill 2014.

[108] Intervistë, zyrtar komunal serb, Graçanicë, shtator 2014.

[109] Intervista Kamenicë, Ranillug, janar 2015

[110] Intervistë, zyrtar komunal serb, Graçanicë, qershor 2014.

Metohinë" dhe një degë e thesarit, kanë zyra në një ndërtesë banesore në Mitrovicën e Veriut.[111]

Origjinat e institucioneve komunale serbe

Autoriteti serb në territorin e Kosovës, gjoja mori fund në 25 korrik 1999, me marrjen përsipër nga UNMIK-u "të të gjitha kompetencave ligjore dhe ekzekutive".[112] Shumë zyrtarë serbë tashmë i kishin lënë pozitat e tyre, edhe pse mbetën në veri të Ibrit. Megjithatë, ndërsa UNMIK-u e konsolidoi autoritetin e vet dhe filloi të ndërtonte administratën e vet, shumë institucione serbe vazhduan të punonin, ose u ringjallën shpejt e shpejt. Shkollat dhe qendrat mjekësore mbetën të hapura, të financuara dhe të mbikëqyrura nga ministritë e arsimit dhe shëndetësisë së Serbisë. Po ashtu, mbetën edhe shumë kompani publike, edhe pse disa ndaluan punën dhe në fakt, u bënë sigurues të mirëqenies sociale. Gjatë viteve që çuan në deklaratën e pavarësisë së Kosovës, Serbia i përdori institucionet e veta në Kosovë "për të përforcuar besnikërinë dhe bindjen në këmbim të burimeve shtetërore." Në maj 2006, Beogradi "i urdhëroi mësuesit dhe stafin mjekësor që të përfundonte marrëdhënien e tyre kontraktuale" me administratën e UNMIK-ut.[113]

Pas pavarësisë, Serbia organizoi zgjedhje në 23 komuna, pra në aq shumë hapësira sa mundi të arrinte të shtrinte ndikimin. Ajo rivendosi administratat komunale, të cilat morën nën kontroll kompanitë publike dhe institucionet e tjera lokale prej qeverisë së Beogradit. Në disa zona, (p.sh. tre komunat veriore) administrata e UNMIK-ut kaloi në sistemin serb. Në Shtërpcë, administrata aktuale u nda, ku njëra pjesë i kaloi Serbisë, ndërsa e dyta, (po ashtu kryesisht me serbë) mbeti me UNMIK-un dhe Kosovën. Në Mitrovicën e Veriut, lindi një komunë e veçantë de facto, shumica e stafit të së cilës ishin të punësuar edhe nga UNMIK-u.[114]

Në pjesën më të madhe të Kosovës, zgjedhjet serbe prodhuan komuna fantazmë të grupuara në enklava. Graçanica nuk ishte komunë sipas sistemit serb, por në të u vendosën komuna e "Prishtinës" dhe disa të tjera.[115] Serbia i mbylli shumicën e komunave fantazmë gjatë vitit 2012. Në pasojat e Marrëveshjes së Brukselit, ajo largoi nga puna kryetarët e mbetur të komunave dhe kuvendet komunale, dhe caktoi "këshille të përkohshëm", si dhe administrata të përkohshme ku punësoi kandidatët të cilët inkurajoi që të qëndronin për zgjedhje në

[111] Vëzhgim, 23 shtator 2014. Një njeri duke pretenduar të jetë drejtor i zyrave, ndalon stafin e Grupit të Ballkanit, duke kërkuar të dijë se kush ishim dhe çfarë ishim duke bërë. Kur ne i shpjeguam se ishim duke lënë një shënim në mënyrë që të kërkonim një takim në orët e punës, ai bërtiti: "Ju nuk jeni të lejuar të shkoni vërdallë duke shkruar atë që është shkruar në institucionet e Republikës së Serbisë".

[112] Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1.

[113] Grupi i Krizave, "Muaji i parë i Kosovës" 18, mars 2008, f. 6, 8.

[114] UNMIK ngriti një Administratë të Mitrovicës (UAM) në nëntor 2002 si administrate de facto e komunës së Mitrovicës veriore. Plani i Ahtisaarit e ndau Mitrovicën në dy komuna të pavarura, me një bord të përbashkët të qytetit për të trajtuar çështje të përbashkëta, por edhe administrata e Kosovës në jug, edhe ajo serbe në veri, pretenduan se përfaqësojnë të qytetin e pandarë. Shih "Raportin Final të Auditimit: Auditimi i menaxhimit të Administratës së Mitrovicës së UNMIK-ut", Zyra e OKB-së e Shërbimeve të Brendshme të Mbikëqyrjes, 2010, dhe "Administrata e UNMIK-ut për Mitrovicën", Republika e Kosovës, Zyra për Koordinimin e Zbatimit të Strategjisë për veriun e Kosovës, 2010.

[115] Graçanica gjithashtu mban brenda edhe administratat komunale serbe të Lipjanit, Fushë Kosovës dhe Ferizajit. Secila ka dhjetëra ish-administratorë. Komuna e Prishtinës punëson, të paktën në letër, rreth 850 persona. Intervista, zyrtarë serbë, 2014.

sistemin e Kosovës. Dukej sikur ideja ishte që zyrtarët e caktuar nga Beogradi do të kalonin padyshim në atë sistem, dhe prej tij, në Asociacionin e Komunave Serbe. Rezultati ishte pak më i rrëmujshëm, pasi disa të caktuar refuzuan të qëndronin për zgjedhje, ndërsa të tjerë humbën.

Serbia nuk i kishte mbyllur institucionet e veta, dhe shumë prej tyre janë ende në një vend, në disa zona, me një buxhet pak më të madh sesa institucionet e Kosovës që duhet t'i zëvendësojnë ato.[116] Beogradi ende parandalon tranzicionin apo integrimin e personelit serb në sistemin e Kosovës.[117] Në veri, administrata komunale kryesisht përmes këshilleve të përkohshme serbe, ndërsa zyrat e vogla ndërlidhëse të Kosovës, u shërbejnë atyre pak fshatrave shqiptare; në jug të Ibrit, në praktikë qeverisin organet komunale të Kosovës, edhe pse shumica e rrogave vijnë nga buxheti serb. Paralelizmi ka rrënjë të thella në këtë truall. Disa politikanë serbë shpesh mbajnë pozita në të dy sistemet. Për shembull, në Novobërdë, një person i cili në vitin 2009 ishte zgjedhur në administratën komunale (të Kosovës), në vitin 2010 iu bashkua bojkotit të zgjedhjeve parlamentare të sponsorizuara nga Beogradi, dhe më pas pranoi caktimin si kryetar i këshillit ekzekutiv të përkohshëm (serb).[118]

Hutim në pjesën veriore të Kosovës

Qeveria në Mitrovicën e Veriut është më e fragmentuar se kurrë. Para zgjedhjeve, administrata komunale serbe ushtronte shumicën e funksioneve të administrimit lokal, edhe pse shumë nga stafi ishin të punësuar njëkohësisht në administratën e përkohshme të UNMIK-ut në Mitrovicë (UAM). Në shtator 2013, Beogradi zëvendësoi kryetarin e komunës dhe kuvendin me një këshill të përkohshëm. Aspekti "i përkohshëm" – mandati i këshillit do zgjaste gjashtë muaj – është injoruar në mënyrë të qetë dhe vazhdon të mbetet në fuqi. Kosova mbajti një "Zyrë Administrative të Mitrovicës së Veriut" (ZAMV), ku shumë funksione ushtroheshin në mënyrë normale nga administrata komunale. Ishte synuar që të shkrihej me administratën komunale, por Beogradi kishte udhëzuar autoritetet e reja të "ecnin ngadalë" me këtë.[119] Qeveria e Kosovës nuk ka marrë asnjë hap për të transferuar ZAMV-në në administratën e re komunale, edhe pse nuk ka më buxhet të vetin.[120] Të dy organet vazhdojnë të veprojnë dhe iu është bashkangjitur edhe një e tretë, Komuna embrionale e Kosovës.[121]

Administrata e re komunale e sapozgjedhur e Kosovës, është ende një guaskë: nuk ka ndërtesë; zyra e kryetarit të komunës është në Zyrën (serbe) për Ndërtimet e Kosovska Mitrovica, kryesuesja e kuvendit ulet në zyrën e partisë së saj. Nuk ka shërbyes të tjerë civilë dhe nuk ka as staf. Zëvendës kryetari i komunës, Aleksandar Spiric, po ashtu kryeson këshillin e përkohshëm, punon jashtë zyrës së tij në administratën e vjetër komunale serbe

[116] Intervistë, Mitrovica e Veriut, prill 2014.

[117] Këshilli për Qeverisje Përfshirëse, tryezë e rrumbullakët, Beograd, prill 2014. Intervistë, zyrtar serb, Graçanicë, tetor 2014.

[118] "I predsednik i odbornik?" [Edhe president, edhe këshilltar?], Glas Javnosti, 23 janari 2010 (online).

[119] Intervista, Mitrovica e Veriut, prill 2014.

[120] Intervistë, zyrtarët e BE, Prishtinë, shtator 2014.

[121] Intervista, ish zyrtar serb i administratës paralele, Mitrovicë e Veriut, prill 2014.

dhe refuzon të marrë rrogën e Kosovës.[122] Administrata serbe ka ende një buxhet dhe po planifikon për vitin 2015-2016, pa tregues për ndryshime nga ana e Beogradit. Spiric argumenton se dy administratat komunale nuk mund dhe nuk duhet të shkrihen, pjesërisht, sepse ajo serbe mbulon si Mitrovicën e Veriut, ashtu edhe atë të jugut, por edhe sepse njerëzit nuk duan të transferohen.[123]

Në secilën prej tre komunave të pjesës veriore , ende ekziston administrata serbe, e drejtuar nga një këshill i përkohshëm si ai në pjesën Veriore të Mitrovicës , po bën shumicën e punëve të përditshme. Gjurmët e Kosovës vijnë prej Zyrës Ndërlidhëse për Komunitete, e cila kujdeset për nevojat e disa fshatrave shqiptare. Buxheti i Kosovës për vitin 2014 u fokusua goxha shumë drejt atyre fshatrave. Shumë prej anëtarëve të këshillit të përkohshëm serb fituan pozita në kuvende, dhe poste kryetarësh komunash në zgjedhjet e Kosovës. Po ashtu, kryetarët e Leposaviqit dhe Zubin Potokut kanë drejtuar këshillin e përkohshëm dhe janë kandiduar të dy prej të njëjtës pozitë.[124] Marrëdhënia në Zveçan është e çuditshme: kreu i këshillit të përkohshëm është i fuqishëm politikisht dhe ka përvojë. Ai drejton nga paradhoma, dhe ua bllokon hyrjen në zyrën kryesore kryetarit shumë më të ri dhe me më pak përvojë se ai.

Pozitat e dyfishta në pjesën jugore të Kosovës

Për serbët në jug të Ibrit, administrata komunale e vërtetë e Kosovës daton në zgjedhjet lokale të viteve 2009-2010. Pjesëmarrja në votime ishte e respektueshme, pa ndonjë dallim nga ajo në pjesën tjetër të Kosovës në zgjedhjet e tetorit 2013. Serbia financon një rrjet në zvogëlim e sipër të administratave virtuale komunale, të cilat nuk kanë administruar me efektivitet për shumë vjet. Në sipërfaqe, zgjedhjet e vitit 2013 kanë ndryshuar pak; kryetarët komunalë të Kosovës vazhdojnë të udhëheqin, partnerët serbë rrufisin kafen dhe shpërndajnë rroga dhe përfitime. Megjithatë, zgjedhjet prodhuan një rrëmujë. Në të gjitha komunat, përveç njërës, votuesit zëvendësuan personat në karrige me sfiduesit e shqyrtuar nga Beogradi, shpesh, të nxjerrë nga sistemi paralel serb. Tani, të njëjtët njerëz shpesh ulen edhe në këshillat e përkohshme serbe, edhe në kuvendet komunale të Kosovës, edhe në zyrën e kryetarit të Komunës.[125] Kryetari në detyrë që ishte në Shtërpce, në mënyrë të diskutueshme u bë nga Beogradi kryetar i këshillit të përkohshëm të komunës.

Kryetarët e komunave ndjehen rehat teksa mbajnë dy karrige. Në qytete si Novobërda, ku i njëjti njeri drejton të dyja administratat, marrëdhëniet janë të shkëlqyera. Marrëdhëniet janë të mira edhe pa dualizëm. Në Ranillug, kryetari i komunës i Kosovës dhe ai i këshillit të

[122] Intervista, anëtarët kryesorë të administratës së Kosovës dhe Serbisë, Mitrovicë e Veriut, prill dhe maj 2014; Zyrtar serb i administratës paralele, Mitrovica e Veriut prill 2014.

[123] Intervistë, zyrtar serb i administratës paralele, Mitrovicë, prill 2014.

[124] Në ndërtesën tre katshe të komunës së Zubin Potokut, kryetarët e komunave i kursejnë kohën e tij në mes të katit të parë (në administratën e Kosovës) dhe katit të dytë, ku si zakonisht funksionon komuna serbe. Në katin e fundit ulet përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut, një strukturë që UNMIK-u e mban aty

[125] Në Novobërdë, në gusht 2013, Beogradi emëroi Svetislav Ivanoviqin si kreun e këshillit të përkohshëm; votuesit e zgjodhën atë si kryetar komune në nëntor. Në Graçanicë, ata zgjodhën Branimir Stojanoviqin si kreun e Zyrës lokale të degës së KeM. Në Ranillug, kryetari në detyrë, Gradimir Mikiq, ndërroi parti dhe u rizgjodh te Lista "Srpska" e sponsorizuar nga Beogradi. Në Partesh, u bë kryetar komune shefi i "Qarkut Kosovë-Anamoravë" (serb), Dragan Nikoliq. Në Kllokot, Serbia emëroi Sreçko Spasiq, ish-kryetarin e saj në letër për komunën me shumicë shqiptare të Vitisë, në këshillin e përkohshëm në maj 2013, dhe ai fitoi zgjedhjet si kryetar komune.

përkohshëm serb, bashkëpunojnë shumë lehtë "bazuar në nevojat e përditshme dhe në realitetin lokal."[126] Procesi pati edhe kthime mbrapsht, kur Beogradi futi disa zyrtarë të rinj të Kosovës për pozita në sistemin e vet. Srdjan Petkovic, zëvendës kryetari i komunës së Graçanicës i Kosovës, ishte emëruar kryetar i distriktit të Kosovës dhe Metohisë në maj 2014, për të zëvendësuar Vladeta Kostic, i cili ishte zgjedhur në parlament në Serbi. Më pas, Kostic u përpoq të kandidonte për në Parlamentin e Kosovës, por Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës e ndaloi. Kur kryetari i ri i komunës së Graçanicës, Branislav Stojanovic u emërua zëvendës Kryeministër i Kosovës, Kostic i fitoi me lehtësi zgjedhjet plotësuese për ta zëvendësuar atë.

Sidoqoftë, në Shtërpce, personi në detyrë, Bratislav Nikolic, u thye në sfidë nga i vajosuri i Beogradit, Ivan Redžić-shefi i organit të përkohshëm. Marrëdhëniet e tyre ishin të këqija. Në dhjetor 2014, disa javë para se Kryeministri serb Vucic të vizitonte Shtërpcën, Beogradi bëri një kthesë 180 gradë, dhe caktoi Nikoliqin që të drejtonte organin e përkohshëm.[127] Këshilli i përkohshëm i Shtërpcës ilustron praninë e vazhdueshme të Serbisë në Kosovë, e cila është e ndryshme nga ndikimi i saj mbi zyrtarët e sapo-zgjedhur të Kosovës. Këshilli ka tre përgjegjësi kryesore; të paguajë pagat e të gjithëve që kanë punë serbe, përfshirë stafin komunal dhe punonjësit e shërbimeve komunale publike; të bëjë pagesat e sigurimit social; dhe të merret me shkollat serbe.[128]

Pozitat e dyfishta konsiderohen si zgjidhje pragmatike në një periudhë kalimtare, por eventualisht, Serbia do të duhet të mbyllë rrjetin virtual komunal në territorin e Kosovës, dhe funksionet e dy sistemeve do të duhet të shkrihen nën juridiksionin ekskluziv të Kosovës.[129]

Sektori publik serb

Shërbimet komunale, kompanitë e tjera publike dhe institucionet kulturore – mbeturina të kohëve socialiste – sigurojnë një pjesë të madhe të punëve në sektorin publik në sistemin serb. Sektori publik në Serbi, është i fryrë në mënyrë të paqëndrueshme, dhe do t'i duhet të tkurret së bashku me shtesat e hapura në territorin e Kosovës. Shumë vende pune janë "strofulla të ngrohta" të paguara shumë dobët. Këto duhen ndarë ndërsa sektori publik integrohet në sistemin e Kosovës dhe përshtatet ndaj realitetit ekonomik, por, gradualisht, për të minimizuar shkëputjen me komunitetin. Kjo duhet bërë sa më shumë të jetë e mundur përmes tretjes graduale dhe pensionimit të hershëm, dhe ku humbjet e punëve shtesë do të balancohen me hapje të vendeve të punës diku tjetër në sistemin e Kosovës. Donatorët do të

[126] Intervistë, kryetari i komunës së Ranillugut, Prishtinë, prill 2014.

[127] Kryetari i komunës nga partia SLS, Nikoliq, fitoi zgjedhjet kundër Lista Srpska me mbështetjen e votave të shqiptarëve. Pasi Beogradi e emëroi atë të kryesojnë këshillin e përkohshëm, institucionet e Serbisë dhe Kosovës bashkëjetojnë në të gjitha dhjetë komunat serbe. Prishtina reagoi ashpër dhe i bëri thirrje BE që të detyrojë Serbinë të tërheqë emërimin ose do të ndërmerrte veprime ligjore kundër Nikoliqit. Kryetarët e komunave duhet të "ndërpresin çdo kontratë apo lidhje që mund ta vërë në dyshim aftësinë e tij / saj për të përmbushur përgjegjësitë e tij / saj në mënyrë të drejtë dhe të paanshme" (Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, akt. 59,1) kryetarët dhe anëtarët e kuvendeve komunale "nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë organi tjetër të zgjedhur "(Ligji për Zgjedhjet Lokale, arti. 3,2). Ndërsa këto dispozita janë të paqarta, edhe nëse është e aplikueshme për pozitën serbe të Nikoliqit, dhe që mund të vënë në rrezik edhe kryetarët e tjerë serbë, qeveria ka liri veprimi për të hequr atë nga pozita, pas miratimit nga Gjykata Kushtetuese.

[128] Intervistë, anëtar i këshillit të përkohshëm serb, Shtërpce, prill 2014.

[129] Ikonografia e komunave jugore është e paqartë. Ndërtesa e re komunale e Graçanicës përmban shenja ose simbole. Një flamur i madh serb valëvitet në një park të vogël përballë. Në Shtërpcë, këshilli i përkohshëm ulet në një zyrë të vjetër përballë komunës kryesore, e cila nuk ka simbole të Kosovës dhe prej ku valëvitet një flamur i madh serb.

jenë aktorë kyç në sigurimin se integrimi i sektorit publik nuk do të provokojë vështirësi të panevojshme dhe emigracion.

Kompanitë publike serbe punojnë në Kosovë me relativisht pak dallime mes veriut dhe jugut. Pozitat virtuale dhe vendet e punës që ekzistojnë vetëm në letër janë më të zakonshme në komunat jugore serbe, për arsye se kompanitë publike të Kosovës e kryejnë shumicën e punëve atje. Disa kompani veriore serbe ishin të organizuara nën UNMIK-un dhe kanë qenë të njohur sipas ligjit të Kosovës, por asnjë nuk është regjistruar realisht tek autoritetet përkatëse.[130] Numri i punonjësve është aq i panjohur sa ç'është në të gjithë sistemin serb.[131] Graçanica ka rreth 15 kompani publike dhe institucione të trashëguara nga Prishtina dhe komunat e tjera fqinje. Zyrtarët vendorë përllogarisin se ka rreth 850 vetë në listën e pagave, prej të cilëve 250-300 jetojnë në Serbi, nuk punojnë dhe marrin pagën minimale, plus përfitimet. Rreth 400 prej tyre jetojnë në Kosovë dhe punojnë e marrin rrogë të rregullt. Pjesa tjetër janë jo-aktivë dhe marrin pagë minimale dhe përfitimet.[132] Disa drejtorë përpiqen të qarkullojnë stafin duke i marrë dhe nxjerrë nga puna, por thonë se disa punëtorë refuzojnë të kthehen në punë pas një periudhe pushimi në shtëpi. Deri qershorin e vitit 2014, zyrtarët serbë punësuan njerëz për të mbushur vendet e lira ndërsa u hapën, dhe deri sa u gjetën fondet.[133]

Disa kompani në Graçanicë – situata është e ngjashme në të gjithë jugun – nuk bëjnë asgjë. Kompania e ngrohjes është e panevojshme, pasi ngrohjen e siguron Prishtina, njësoj edhe Vodovod - kompania e ujit, pasi tubacionet kontrollohen nga shërbimet komunale të Prishtinës. Kompanitë e tjera janë minimalisht aktive. Kinemaja dhe teatri (institucione publike) vënë në skenë shfaqje sipas rastit, gjatë pushimeve, edhe pse nuk ka një shtëpi të vërtetë kinemaje.[134] Të tjerët ende punojnë me gjysmë kapaciteti: kompania e pastrimit, e cila merret edhe me varrimet, mirëmbajtjen e varrezave, ndriçimin publik dhe parqet, mbledh mbeturinat në qytet, dhe ua dorëzon kompanisë "Pastrimi", pala e Kosovës e cila operon mbetjet rajonale.[135] Vetëm pak kompani punojnë me kapacitet të plotë. Saobraçaj, kompania e transportit, ofron autobus për fëmijët e shkollave. Qendra kulturore (një tjetër institucion publik) organizon drama ose ngjarje të tjera.

Ekziston një histori e bashkëpunimit praktik midis kompanive publike në të dy sistemet. Pastrimi dhe Komunalno, përkatësisht kompanitë e pastrimit kosovare dhe serbe, bëjnë koordinim mes njëra-tjetrës.[136] Disa drejtorë serbë kanë iniciuar procesin e regjistrimit të një

[130] Intervistë, kreu i njësisë për kompanitë publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Prishtinë, tetor 2014.

[131] Një zyrtar serb në Beograd pretendoi se nuk ishin më shumë se 50 të punësuar me kohë të plotë në komunën serbe të Prishtinës (që gjendet në Graçanicë), duke përfshirë të gjitha kompanitë publike, me 2 deri 4 vetë për secilën nga komunat më të vogla me seli atje. Këto shifra janë në kundërshtim me të dhënat e ofruara nga zyrtarët vendorë dhe ndoshta janë shumë të ulëta, por ato tregojnë se çështja është e diskutueshme edhe brenda komunitetit serb. Intervistë, Graçanicë, nëntor 2014.

[132] Një tjetër zyrtar serb dha shifra të ndryshme: 890 (duke përfshirë komunën, kompanitë dhe institucionet publike) në listën e pagave të komunës së Prishtinës të Serbisë. Rreth 450 jetojnë në Serbi dhe 440 në Graçanicë, plus 300-400 nga dy komunat e tjera "virtuale" serbe. Intervistë, Graçanicë, prill 2014.

[133] Intervista, zyrtarë të kompanisë komunale dhe publike serbe, Graçanicë, qershor 2014.

[134] Autoritetet komunale të Kosovës planifikojnë të ndërtojnë një të tillë.

[135] Intervista, drejtori dhe punonjës të kompanisë publike Komunalno, Graçanicë, shtator 2014.

[136] Për shembull, Pastrimi mbledh plehra nga rrugët kryesore, ndërsa Komunalno trajton kontejnerët në rrugë anësore. Intervista, drejtor dhe punonjës të kompanisë publike Komunalno, Graçanicë, shtator 2014.

kompanie publike. Kjo përfshin një aplikim për të cilin duket se administrata komunale ka ndarë mënjanë tokë dhe objekte, si dhe ka premtuar subvencione për tre vitet e para, si dhe ka premtuar se kompania publike do të jetë e suksesshme.[137] Në mënyrë alternative, disa shërbime komunale serbe, mund të shkrihen në duart e kompanive rajonale të Kosovës. Kjo bën kuptim për komunat më të vogla. Kështu, Kllokoti e ka krijuar kompaninë e vet publike sipas sistemit të Kosovës dhe e ka parë se ishte e paqëndrueshme, ndaj dhe e shkriu me një firmë rajonale më të madhe. Një zyrtar i MAPL tha se kompanitë rajonale të Kosovës paguajnë paga më të mëdha se kompanitë komunale serbe.[138]

Si regjistrimi, ashtu edhe shkrirja, përbëjnë sfidë. Nuk ka vend brenda sistemit të Kosovës apo asnjë sistemi rajonal, për numrin e fryrë të punëtorëve në listën e pagave serbe. Vetëm një pakicë do të jenë në gjendje të mbajnë vendin e punës. Sektori publik i Kosovës është gjithashtu i prekur nga paaftësia dhe nepotizmi. Shumë kompani publike në fillim ishin të destinuara të futeshin në juridiksionin komunal.[139] Komunat në përgjithësi nuk i administrojnë kompanitë e tyre si duhet: mbledhja e dobët e të hyrave e ka prekur thellë fitimin vjetor, dhe zyrtarët i përdorin këto kompani si burim patronazhi për të afërmit dhe mbështetësit politikë.[140]

Prishtina dhe Beogradi mund të lehtësojnë tranzicionin përmes bërjes së mundur që punëtorët të mbeten në skemën pensionale serbe, qoftë nëse ata futen në një kompani të Kosovës, apo gjejnë punë tjetër, apo dalin në pension. Pensionet janë një nga dallimet kryesore midis dy sistemeve: Serbia ofron një skemë të mbështetur nga shteti, me përfitime të përcaktuara, ndërsa Kosova ka nxjerrë një plan me kontribut të përcaktuar, pagesa e të cilit si fillim, është shumë më i ulët se sa ai serb.[141] Çështja bëhet edhe më me rëndësi për ata punëtorë të cilët i janë afruar pensionit. Duke u përballur me zgjedhjen e gjetjes së një pune të re në Kosovë pa pasur pensionin serb, ose të zhvendosen në Serbi, shumë prej tyre do të zgjedhin opsionin e fundit.[142] Autoritetet e Prishtinës nuk kanë kundërshtim që Serbia të paguajë pensionet, dhe deklarojnë se edhe shumë kosovarë i tërheqin pensionet e tyre prej jashtë.[143] Zgjedhja ideale do të ishte të bëhej një marrëveshje mes dy qeverive, ku punëtorët që kalonin në sistemin e Kosovës të vazhdonin të akumulonin vite pune për pensionin serb, me opsionin që të merrnin pjesë edhe në skemën e Kosovës.

Pjesë të tjera të sektorit publik kanë nevojë për zgjidhje të tjera. Ndërmarrjet sociale (NS) punësojnë shumë prej dhjetëra mijërave që marrin rrogë minimale në Kosovë.[144] Këto janë

[137] Aplikimi shkon në MAPL dhe ministrinë e zhvillimit ekonomik, më pas për miratim në një komision ndërministror (financave, mjedisit, infrastrukturës dhe tregtisë). Intervistë, kreu i njësisë për kompanitë publike, Ministria e zhvillimit ekonomik, Prishtinë, tetor 2014.

[138] Intervistë, shtator 2014.

[139] "Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal ... [në] ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale ", Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), Neni 17. Cf. Ligji për Ndërmarrjet Publike (2008) dhe amendamenti (2012).

[140] Intervistë, kreu i njësisë për kompanitë publike, Ministria e zhvillimit ekonomik, Prishtinë, tetor 2014.

[141] Disa serbë nuk e besonin planin pensional të Kosovës sepse pagimi i tij varet pjesërisht nga mënyra si i kanë investuar fondet menaxherët e saj. Intervistë, zyrtar komunal serb, Graçanicë, shtator 2014.

[142] Intervista, drejtori dhe punonjës të kompanisë publike Komunalno, Graçanicë, shtator 2014.

[143] Intervistë, këshilltar i një anëtari të qeverisë, Prishtinë, tetor 2014.

[144] Intervistë, zyrtar serb, Graçanicë, prill 2014.

mbeturina të një socializmi vetë-menaxhues dhe vetëm pak prej tyre bëjnë ndonjë punë të vërtetë. Ata ende ekzistojnë në Serbi, ku qeveria u paguan rroga dhe mundohet t'i 'shesin'.[145] Gjysma, ose më shumë e këtyre njerëzve, janë larguar nga Kosova dhe jetojnë në Serbi, por pagat e tyre (minimale) janë ende pjesë e buxhetit të Beogradit për Kosovën.

Në një komunë tjetër në pjesën jugore të vendit, Novobërdë, 60-70 për qind e popullatës serbe janë në buxhetin serb, në një mënyrë apo një tjetër, dhe janë të frikësuar se mund ta humbasin këtë gjë. "Minimumi i Kosovës" (që u paguhet të papunëve), mund të bëjnë dallimin për ata që jetojnë të skaje të varfërisë, si fermerët e vegjël, midis një jete të mirë dhe telasheve të vërteta.[146] Komuna paralele serbe në Novobërdë ka punësuar vetëm rreth 20 vetë. Pjesa tjetër janë në buxhetin e ministrive të ndryshme, kryesisht arsimit dhe shëndetësisë.[147] Edhe komunat e tjera dhe enklavat, përballen me një situatë të ngjashme. Shumica e serbëve në Kamenicë punojnë ose marrin përfitime nga Serbia dhe nga Kosova; zyrtarët në komunën e vjetër serbe punojnë edhe nëpër shkolla për të marrë pagën e Kosovës. Kreu i organit të përkohshëm është edhe anëtar i kuvendit të Kamenicës.[148]

Integrimi i administratës lokale

Asgjë nuk i ilustron sfidat që ka integrimi serb në nivelin lokal, më qartë se sa buxhetet komunale. Kështu, një komunë në madhësinë e Mitrovicës së Veriut, do të kishte një buxhet prej 5 milion eurosh.[149] Në prill 2014, qeveria u dërgoi komunave kornizën buxhetore për vitin vijues; Për Mitrovicën e Veriut u parashikuan rreth 4.5 milion euro, bazuar në shpenzimet paraprake, popullsinë dhe territorin.[150] Udhëzimi i nxjerrë në qershor nga MAPL-ja, se komunat veriore duhet të përgatisin buxhetet duke shkrirë administratat e mëdha serbe me ato të Kosovës që janë më të vogla, krijoi konfuzion.[151] Projekt-buxheti i Mitrovicës së Veriut u fry në thuajse 35 milion euro.[152] Dy linja buxhetore – arsimi 15 milion euro) dhe shëndetësia (12.4 milion euro) – bëjnë dallimin më të madh nga buxheti paraprak.[153] Këto shifra mbase ishin përafrime të nxjerra nga shtimi i listave të stafit dhe shumëzimit me rrogat mesatare në këto sektorë, sipas sistemit të Kosovës.[154] Pas debatit mes qeverisë dhe kryetarëve të komunave, Beogradi i udhëzoi këta të fundit që të hiqnin arsimin dhe

[145] Intervistë telefonike, zyrtar i OKB-së, janar 2015.

[146] Intervistë, zyrtar komunal, Novobërdë, prill 2014.

[147] Intervistë, kryetari i komunës së Novobërdës, prill 2014.

[148] Intervista, Kamenicë, 15 janar 2015.

[149] Obiliqi, më i përafërt me popullsinë në Mitrovicën e Veriut, ka një buxhet prej 2.015 5,046,183 eurosh. Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2015.

[150] Intervistë, zyrtar, Mitrovica e Veriut, shtator 2014.

[151] Intervistë, zyrtarët ndërkombëtarë të organizatës jo-qeveritare (OJQ), Mitrovica e Veriut, shtator 2014. Në pjesën veriore të Mitrovicës, për shembull, komuna serbe kishte 129 staf, në krahasim me 55 në ZAMV. Intervistë, zyrtar, Mitrovica e Veriut, shtator 2014.

[152] Një version prej 25.000.000 € në shtator ishte i bazuar në atë që u përgatit me ndihmën e Agjencisë Amerikane për Zhvillimin Ndërkombëtar të Iniciativave për Komunat Demokratike (DEMI). Intervistë, anëtar i kuvendit komunal, Mitrovica e Veriut, shtator 2014. Drafti pasues më i lartë u vu në dispozicion të Grupit të Ballkanit, në fund të shtator 2014.

[153] Projekt-buxheti rendit 2080 të punësuar në arsim (1400 në universitet) dhe 1481 në kujdesin shëndetësor. Nuk janë përfshirë kompanitë publike si Standard (kompani sanitare), që punësojnë qindra vetë.

[154] Intervistë, anëtar i kuvendit komunal të Mitrovicës së Veriut, Mitrovicë e Veriut, shtator 2014.

shëndetësinë nga buxheti. Në 30 tetor 2014, Mitrovica e Veriut miratoi një buxhet prej 2.7 milion eurosh; buxheti i shtetit ishte pak më i lartë, me 4.1 milion euro.[155] Pa shpenzime në arsim dhe shëndetësi, këto buxhete janë të papranueshme.[156] Komunat nuk arritën të plotësonin afatin e dytë përfundimtar më 1 mars 2015, dhe rrezikojnë ngrirjen e xhirollogarive. Ligji mbi financat publike e ndalon qeverinë të ndajë fonde për komunat, në rast se kuvendet komunale nuk arrijnë të aprovojnë buxhetet në përputhje me kriteret ligjore.[157] Ende ekziston një boshllëk mes asaj që nevojitet të paguhet për punonjësit e të dy sistemeve, dhe asaj që Prishtina ofroi të paguajë.

Një çrregullim i ngjashëm njollosi edhe përpjekjet e tre komunave të tjera për të prodhuar një buxhet të integruar të Kosovës.[158] Ndryshe është logjika në pjesën jugore të Kosovës, por problemi thelbësor mbetet i njëjtë: qeveria nuk do të lejojë shkrirjen e komunave paralele me ato të Kosovës, pasi kjo mund të shpërthejë buxhetet.[159] Beogradi dhe Prishtina nuk janë kacafytur me problemin e numrit të vërtetë të punonjësve serbë, çfarë të bëjnë me ta ose si do të paguajnë për ta. Deri sa kjo të ndodhë, integrimi serb në nivelin lokal është i pamundur.

Ekziston një nevojë urgjente për një inventar të saktë të atyre që janë në listën e pagave serbe. Beogradi duhet t'i udhëzojë këshillat e vet të përkohshëm, ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse, që të përgatisin listat në një format të përbashkët, i cili lehtëson kontrollin, dhe këtë informacion duhet t'ia transmetojë Prishtinës. MAPL-ja duhet të kërkojë të njëjtin informacion, në të njëjtin format, nga komunat me shumicë serbe. Shkrirja e këtyre listave do të nxirrte në pah dyfishimin e njerëzve (pra, njerëz që marrin dy paga) dhe tepricën e panevojshme, si dhe do të identifikonte ata që marrin paga minimale, por jetojnë në Serbi.[160] Të pajisur me këto të dhëna, do të ishte e mundur të hartohej një strategji për të pakësuar listën e pagave të stafit të domosdoshëm, i cili prapëseprapë mbetet shumë i lartë në numër. Njerëzit në listën e pagave të Kosovës, të cilët jetojnë në Serbi, duhet të vendosen në buxhetin e rregullt serb; atyre që janë afër pensionit duhet t'u ofrohet pension i hershëm; emrat e dyfishuar duhet të largohen. Zyrtarët ndërkombëtarë që kanë përvojë në tranzicionin komunal, sugjerojnë se mbase është e nevojshme që të fillohet me një administratë të integruar, edhe nëse ajo është e mbingarkuar me staf apo është e paaftë, dhe të bëhet racionalizimi i saj më vonë.[161]

---

[155] Buxheti komunal (30 tetor 2014) dhe buxheti i shtetit (31 tetor 2014).

[156] Letër nga ministrja për dialog, Edita Tahiri drejtuar BE-së, 19 shkurt 2015.

[157] Ligji Nr 03 / L-048, Neni 62,5. Buxheti i Kosovës u miratua më 24 dhjetor 2014. Qeveria do të ndryshojë ligjin për të përfshirë buxhetet e katër komunave veriore, nëse ata i miratojnë shpenzimet e reja para negociatave të 1 mars 2015. Kryesuesja nga Kosova, Edita Tahiri, premtoi se do të marrë në konsideratë nevojat e tyre, dhe ministria e financave u ka dhënë kryetarëve të komunave më shumë kohë. "Qeveria e Kosovës ofron 30 milion euro për të katër komunat, duke përfshirë një fond prej 10 milion eurosh paparashikuara dhe 16 milion eurosh për investime, që i nënshtrohet miratimit të buxheteve komunale. Intervistë, zyrtar i qeverisë, Prishtinë, 13 janar 2015.

[158] Zveçan, një komunë e vogël me asnjë universitet apo qendër shëndetësore, filloi nga një (para-integrimit) bazë prej 2 milion eurosh në 2014, duke shkuar tek një ngritje e arsyeshme (nivelet e stafit) prej 8.5 milion eurosh në mesin e verës. Zyrtarët komunalë e kishin fryrë këtë buxhet në 21 milion euro në fund të vjeshtës, dhe më pas miratuan një buxhet më pak se një e dhjeta e tij (1.6 milion euro). Intervistë, zyrtarët ndërkombëtarë e OJQ-ve, Mitrovica e Veriut, shtator 2014.

[159] Intervistë, kryetari i komunës së Graçanicës, Graçanicë, shtator 2014. Zyrtarët e tjerë serbë thonë se aktualisht bashkimi është ligjërisht i pamundur. Mund të rezultojnë padi ndaj punonjësve serbë nëse i lëvizin këto zyra në Serbi.

[160] Një pikë e rrallë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe zyrtarëve serbë, është se pagat e dyfishta duhet të përfundojnë; Intervista, zyrtar i MAPL, Prishtinë; Zyrtar lokal serb, Graçanicë, shtator 2014.

[161] Intervistë, zyrtarët ndërkombëtarë e OJQ-ve, Mitrovica e Veriut, shtator 2014.

Integrimi serb në nivelin lokal ka nevojë për përpjekje të koordinuara nga shumë agjenci. Qeveria e Kosovës nuk duhet t'ia delegojë këtë detyrë vetëm MAPL-së. Në këtë proces duhet të përfshihen edhe ministritë e financave, zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës.[162] Beogradi duhet ta mbështesë procesin duke ofruar të dhëna të detajuara dhe duke u koordinuar me ministritë e veta, sipas nevojës. Kjo duhet të shndërrohet në një përpjekje mbarë-qeveritare, e koordinuar nga MAPL, me ndihmën e Zyrës së Serbisë për KeM.

Gjykatat, drejtësia dhe policia

Në takimin e parë të tyre, në 9 shkurt 2015, kryeministrat e Kosovës dhe të Serbisë përmbyllën një marrëveshje për sistemin gjyqësor. Pas ligjit të Kosovës për gjykatat, u krijua një gjykatë themelore në Mitrovicën e Veriut, e cila do ketë juridiksion mbi të katër komunat e veriut, madje edhe për Mitrovicën e Jugut, Skënderaj dhe Vushtrrinë, të cilat kanë një numër më të madh banorësh. Marrëveshja merr shtysë minimalisht nga ligji i Kosovës, duke ndarë vendndodhjen fizike të gjykatës së Mitrovicës në dy ndërtesa, njëra në veri, dhe tjera në jug të lumit. Departamentet e krimeve të rënda dhe krimeve të përgjithshme, do të vendosen në ndërtesën në veri, e cila do të ketë brenda edhe Gjykatën e Apelit (e cila normalisht gjendet në Prishtinë). Ndërtesa jugore do të mbajë edhe dy departamente të tjera civile, kundërvajtjet dhe gjykatën për të mitur. Departamenti për krimet e përgjithshme mbulon vetëm Zveçanin, Mitrovicën e Veriut dhe të Jugut. Komunat e tjera kanë degë të gjykatës për këto raste. Dhomat e tjera kanë juridiksion mbi të gjitha 7 komunat.[163]

Kjo marrëveshje po ashtu përfshin kuota etnike për personelin kyç.[164] Kuotat përjashtojnë të gjitha minoritetet jo-serbe, dhe mund të cenojnë kushtetutën.[165] Kryetari i Gjykatës duhet të jetë serb, ndërsa kryeprokurori duhet të jetë shqiptar. Pesë anëtarë të panelit të apelit duhet të jenë gjykatës serbë, dhe dy shqiptarë. Në departamentin e krimeve të rënda, do të punojnë bashkë 4 gjykatës shqiptarë dhe 4 gjykatës serbë. Zëvendës kryetari i gjykatës së apelit duhet të jetë Serb nga Kosova, i cili e ka zyrën në Prishtinë. Zyrtarët e BE-së që ishin të përfshirë në këtë proces, thanë se themelimi i gjykatës në ndërtesën e vet historike në Mitrovicën e Veriut, dhe mbyllja në të njëjtën kohë e gjykatës së fundit serbe, do të qetësojë tensionet në mënyra që nuk kufizohen prej çështjeve gjyqësore të ngushta. Kjo do të qetësojë situatën, dhe duke larguar një ankesë që ka ekzistuar për një kohë të gjatë ndaj Prishtinës, do t'i bëjë më të pranueshme reformat që janë në interes të komunitetit serb.[166]

Reforma e gjykatave e vitit 2010, e dobësoi paksa mbrojtjen ndaj pakicave. Kushtetuta deklaron:

---

[162] Intervistë, zyrtar i MAPL, Prishtinë, shtator 2014.

[163] Intervistë, gjyqtar serb i njohur me bisedimet, shkurt 2014. Marrëveshja e botuar.

[164] Gjykata themelore do të ketë 10 shqiptarë dhe 14 gjyqtarë serbë në ndërtimin e gjykatës së Mitrovicës së Veriut, dhe 14 shqiptarë dhe 11 gjyqtarë serbe në ndërtesën e Mitrovicës së Jugut. Personeli mbështetës do të ndahet në mënyrë të barabartë, me 79 shqiptarë dhe 79 serbë; degët në Leposaviq dhe Zubin Potok do të kenë vetëm staf serb, nga shtatë secila. Zyra e prokurorisë do të ketë 18 anëtarë, 9 të çdo komuniteti, dhe do të punësojë 24 shqiptarë dhe 24 staf mbështetës serbë.

[165] Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë, "Neglizhenca nda Komuniteteve të pakicave jo-serbe në Marrëveshjet Teknike Kosovë-Serbi ", 10 mars 2015.

[166] Intervistë, zyrtar i BE-së, Bruksel, tetor 2014.

> Kandidatët për pozita gjyqësore brenda gjykatave themelore, juridiksioni i të cilave përfshin ekskluzivisht territorin e një ose më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i përket komunitetit serb të Kosovës, mund të rekomandohen vetëm për emërim nga dy anëtarët e Këshillit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë ulëse të rezervuar ose të garantuar për Komunitetin serb ... duke vepruar bashkërisht dhe unanimisht.[167]

Edhe pse secila komunë kishte të drejtën për të bërë peticion tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës për një gjykatë themelore në territorin e vet, sidoqoftë, përpara reformës kishte vetëm disa gjykata të tilla, pasi avokatët serbë (me udhëzim të Beogradit) refuzuan të merrnin pjesë në gjyqësorin e Kosovës[168] Ligji i vitit 2010 prezantoi një sistem pa gjykata që kufizoheshin për zonat me shumicë serbe, dhe pa dispozita për të krijuar të tilla. Në vend të saj, ai parashikoi që të gjitha zonat serbe duhet të shërbehen nga degët e gjykatave themelore që përfshijnë një zonë më të madhe të banuar nga shumica shqiptare.[169] Kjo e la dispozitën kushtetuese të cituar më lart, të paprekur, por pa diskutime. Në praktikë, KGJK përzgjedh vetëm gjykatës serbë me rekomandim nga anëtarët e vet serbë. E megjithatë, ligjet për gjykatat dhe KGJK, duhet të ndryshohen për të fuqizuar anëtarët serbë të KGJK-së për të emëruar gjykatës që do të shërbejnë në zona me shumicë serbe.

Marrëveshja e re për gjykatat, po ashtu shkel rregullat e KGJK-së, grupet punuese po përcaktojnë procedurat për punësimin e gjykatësve serbë. Beogradi këmbëngul të emërojë gjykatës dhe prokurorë, duke anashkaluar rregullat e KGJK-së. Kjo e fundit kishte planifikuar të emëronte një komision të përbashkët me EULEX-in për emërimin e gjykatësve serbë, dhe ka kundërshtuar pranimin e çdo punësimi që anashkalon rregullat e tyre.[170]

Serbët në pjesën veriore të Kosovës nuk kundërshtojnë ligjet e Kosovës si të tillë, të cilët kanë pak ndryshim nga kodet serbe me të cilët janë të familjarizuar. Shumë prej tyre janë të gatshëm të bashkëpunojnë me autoritetet e Kosovës të bazuara në pjesën Veriore, por i shohin me dyshim ato në jug të Ibrit. Deri tani vonë, serbët rrallë e kalonin lumin, duke pasur frikë që të udhëtonin në zonat shqiptare. Këto frikëra janë zmadhuar nga stresi që vjen si pasojë e sistemit të gjykatave penale. Aktorë të paskrupuj mundohen të përfitojnë duke kërcënuar serbët e pjesës veriore me përndjekje në gjykatat jugore në rast se ata nuk arrijnë të kthejnë pronat apo i rezistojnë zhvatjes.[171] Në fillim të vitit 2014, një valë arrestimesh serbe krijoi "një lloj histerie ku gjithkush mendonte se ishin në një listë të fshehtë" për përndjekje.[172]

---

[167] Kushtetuta, neni 108 (10).

[168] Plani i Ahtisaarit, Shtojca IV, Neni 1.3. KGJK-ja ishte e detyruar për të dhënë kërkesa të tilla, përveç nëse ngarkesa me raste e komunës ishte shumë e vogël. Vetëm dy komunat me shumicë serbe (Leposaviq dhe Zubin Potok) kishin gjykata themelore në 2011; dy të tjerat (Graçanica dhe Shtërpca) kishin degët e një gjykate fqinjë më të madhe. Gjykata e Zubin Potokut ishte copë-copë pa gjyqtarë që të punonin. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Vjetor 2011, fq. 23.

[169] Ligji i vitit 2010 (që hyri në fuqi në 2013) i quajti gjykatat e qarkut si gjykata themelore, dhe i shndërroi gjykatat e vjetra komunale në degë të gjykatave të reja themelore. Kryetari i trupit gjykues i çdo gjykate themelore emëron dhe mbikëqyr gjyqtarët e degëve të gjykatave. Përveç kësaj, degët e gjykatave nuk kanë juridiksion mbi krimet e rënda.

[170] Intervistë, anëtar i KGJK-së, mars 2015

[171] Grupi i Ballkanit ka parë një menaxher serb fabrike duke kërkuar ndihmë nga një autoritet komunal i Kosovës, duke u ankuar se një serb ishte duke pretenduar që të ketë blerë fabrikën e saj në një gjykatë jugore, dhe do ta arrestonte në qoftë se ajo nuk e kthejnë atë mbi të. Leposaviq, mars 2014.

[172] Intervistë, ish-kryetari i komunës, Kosova veriore, prill 2014.

Gjyqësori gjendet në një gjendje të mjeruar, dhe vuan nga mungesa e mosbesimit midis shqiptarëve dhe serbëve.[173] Përveç një futjeje të gjykatësve të rinj, ende ka mungesa shumë të mëdha në personel. Në vitin 2009, Kosova kishte rreth 10 gjykatës aktivë për 100,000 persona, shumë më ulët se sa mesatarja rajonale dhe evropiane.[174] Norma tani është 18.3, ende e ulët për fqinjët.[175] Në sistem ka ende vend për një numër të madh profesionistësh ligjorë (gjykatës, prokurorë dhe staf për mbështetje ligjore). Marrja në punë e juristëve serbë do të kontribuojë në integrimin dhe ndërtimin e besimit. Prishtina duhet të ofrojë vende për gjykatësit serbë, prokurorë dhe zyrtarë ligjorë në të gjitha strukturat gjyqësore.

Policia e Kosovës përbën dallim me një nivel të lartë integrimi dhe me profesionalizëm relativisht të lartë. 285 zyrtarë serbë janë të integruar në pjesën veriore sipas Marrëveshjes së Brukselit. Beogradi dëshironte që ata të mbanin gradat e tyre të vjetra, ndërsa Prishtina donte që të fillonin në nivelin më të ulët sepse shërbimet kanë hierarki të ndryshme, dhe kishte frikë se rritja në detyrë kishte reflektuar shpërblimet politike për rezistencë ndaj saj, dhe jo për shkak të detyrës policore. U pranua kompromisi i BE-së, sipas të cilit zyrtarët serbë u transferuan në gradë dy nivele më të ulët se më parë.[176]

Serbia deklaron se ka 600 punonjës të ministrisë së punëve të brendshme të saj në pjesën veriore të Kosovës. Beogradi dhe BE-ja e nxitën Kosovën që t'i merrte në punë, por Prishtina refuzoi duke thënë se Marrëveshja e Brukselit ka të bëjë vetëm me integrimin e Policisë në Veri.[177] Ajo thotë se policia (e paligjshme) serbe duhet të shpërbëhet, dhe oficerët do t'i nënshtrohen persekutimit nëse ata punojnë për Serbinë në territorin e saj. Ndërsa PK-ja në tërësi ka një dosje të admirueshme për punësimin e serbëve në të gjitha nivelet, ajo ende ka mungesë stafi në disa rajone.[178]

Policia duhet të punojë në rindërtimin e besueshmërisë në pjesën veriore të vendit , e cila është dëmtuar nga vite të tëra plogështie nga ana e oficerëve të saj në të dy sistemet, korrupsioni dhe mungesa e rendit, si dhe nga një valë e madhe arrestimesh të cilat shumë vendorë i shohin të motivuara politikisht. Një ish kryetar komune ankohet se ai dhe kolegët e

---

[173] Pothuajse 70% e serbëve janë "të pakënaqur" ose "shumë të pakënaqur" me gjykatat e Kosovës, sipas një sondazhi të fundit të kryer nga Programi për Zhvillim i OKB-së (UNDP) dhe vënë në dispozicion të Grupit të Ballkanit; Përgjigjet e shqiptarëve ishin të ngjashme. Vetëm 11 % e serbëve dhe 16 % e të anketuarve shqiptarë ishin dakord se "dega e gjyqësorit i merr vendimet pa paragjykime." Është shqetësues fakti se të anketuarit shqiptarë - me sa duket më shumë të njohur me punimet e gjykatave të Kosovës – raportojnë besim më të lartë në ekzistencën e korrupsionit gjyqësor sesa serbët; më pak se një në 100 raportuan se s'ka korrupsion; shumica raportuan korrupsion në shkallë të mesme ose të lartë.

[174] Grupi Ndërkombëtar i Krizave, "Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur," .19 maj 2010, f.13. Gjyqtarët "aktivë" janë ata që kanë dëgjuar raste gjatë vitit në fjalë. Bosnja dhe Hercegovina ka pasur 22,1 gjyqtarë për 100,000 njerëz, dhe shtetet e tjera fqinje (Kroacia me 40,1, Mali i Zi me 51) kishin edhe më shumë.

[175] 335 gjyqtarët i përfunduan rastet në gjysmën e parë të 2014; Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "gjysma e parë e vitit 2014 Statistikat e Gjykatave", f.3..

[176] Intervistë, këshilltar në ministrinë e punëve të brendshme, Prishtinë, shtator 2014. Rreth 76 punonjës civilë të ministrisë së punëve të brendshme të Serbisë mbeten për t'u integruar, sepse ata ishin përgjegjës për lëshimin e dokumenteve serbe; Zyrtarët e BE-së presin që ata që do të punësohen për të lëshuar dokumente të Kosovës. Intervistë, Bruksel, tetor 2014. Më 23 shkurt disa prej këtyre punonjësve civilë protestuan në veri, duke kërkuar vende pune në PK.

[177] Beogradi më parë mohoi se kishte polici të vetën në Kosovë, por gjatë dialogut, iu desh të pranojë të gjithë pjesëtarët e PK-serb në listat e pagave të saj.

[178] Një zyrtar lokal në Ranillug, për shembull, u ankua se policia ishte gati për gjysmë me shqiptarë, edhe pse komuna ka qenë pothuajse tërësisht serbe; intervistë, prill 2014. Një zyrtar serb në Graçanicë tha se policia kishte mungesa në përgjithësi; intervistë, prill 2014.

tij janë denoncuar si kriminelë dhe ekstremistë për organizimin e barrikadave dhe qëndresë ndaj integrimit në Kosovë, ndërsa ka të dhëna të dyshuara që prej kohësh, për krim të organizuar, dhe tashmë ato janë pranuar se ata kanë qenë mbështetësit kryesorë të qeverisë serbe dhe zbatuesit e saj gjatë zgjedhjeve në Kosovë.[179] Banorët vendas ankohen "e vetmja gjë që ka ndryshuar me policinë [në Mitrovicën e Veriut] është uniforma". Ish zyrtarët policorë serbë janë më të dukshëm, por vazhdojnë të rrotullohen në të njëjtat vende që frekuentonin më parë.[180] Sidoqoftë, ndryshimi është i dukshëm. PK-ja patrullon rregullisht dhe tani oficerët e integruar serbë nëse duan, kanë mjete për të zbatuar rendin.[181]

Çuditërisht, Prishtina dhe Beogradi kanë bërë shumë progres në Mbrojtjen Civile (Civilna Zaštita), e cila në teori është një mbrojtje e paarmatosur kundër fatkeqësive natyrore, të cilat Prishtina i sheh si organizatë paraushtarake. Mbrojtja civile u fry në numër dhe shfaqje gjatë dialogut të Brukselit.[182] Në fillim, Prishtina nuk donte të bisedonte për integrimin e saj, dhe i bëri presion Serbisë që ta çarmatoste Mbrojtjen, pasi numrat e saj shkuan nga 400 në 760. Një auditor zbuloi se 150 anëtarë ishin afër pensionimit, dhe 100 prej tyre nuk ishin qytetarë të Kosovës.[183] Prishtina ofroi vende për 450 dhe planifikon t'i shpërndajë ata në më shumë se 15 institucione dhe agjenci civile, duke lënë jashtë vetëm 100 anëtarë që nuk kanë pozita në sistemin e Kosovës. Beogradi nuk i ka urdhëruar të shpërbëhen dhe të integrohen. Një zyrtar ndërkombëtar fajësoi BE-në sepse nuk ka ushtruar presion të mjaftueshëm, duke thënë se "palët ishin të gatshme të binin dakord me detajet për integrim," dhe se "pak inkurajim dhe shtyrje [janë] gjithmonë të nevojshme."[184] Me synimin për të përshpejtuar procesin e integrimit, Prishtina ka premtuar se do të punësojë dhe 100 anëtarët e tjerë që të punojnë në 4 komunat e pjesës veriore.

Asociacioni i Komunave Serbe

Krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe, është thelbi i Marrëveshjes së Brukselit.[185] Pothuajse dy vjet prej saj, shumë pak dihet rreth Asociacionit, edhe emri i tij vazhdon të diskutohet.[186] Zyrtarët e Beogradit dhe kryetarët e rinj të komunave serbe në Kosovë, priren që t'i veshin një rol përtej përmasave të veta, si përgjigje ndaj çdo pyetje për integrimin serb.

[179] Intervistë, ish-kryetari i komunës, Kosova veriore, prill 2014.

[180] Intervistat, banorët serbë, zyrtarët komunalë të Kosovës, Mitrovica e Veriut, prill 2014. Qindra serbë të rinj të veriut kanë aplikuar për punë në polici në qershor 2014. Oficerët serbë me shërbim të gjatë në PK, thanë se MUP, i cili deri kohët e fundit e refuzoi PK-në, janë integruar po bëjnë gjithçka për të rekrutuar anëtarët e familjes. Intervistë, Jarinje, shtator 2014.

[181] Qytetarët përshkruajnë se si PK-ja e re i zbaton urdhrat, duke mbyllur baret në mesnatë - një rregull që nuk zbatohej më parë - dhe ndërhyjnë në sherret e rrugës. Intervistë, ish-zyrtar komunal serb, Mitrovica e Veriut, qershor 2014

[182] Kosova e konsideron Shërbimin e Mbrojtjes Civile si një grup thjesht paraushtarak; Serbia e konsideron atë një organ lokal përgjegjës për raste urgjente. Njësitë u mobilizuan në 2011, futen nën ligjin serb të mbrojtjes, dhe administrohen nga ministria e punëve të brendshme. Fillimisht, u rekrutuan rreth 400 anëtarë, ku komuna e Mitrovicës së Veriut do të paguante për 120; intervistë, anëtar i kuvendit komunal, prill 2014.

[183] SHBA hodhi poshtë planet për t'i integruar në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Intervistë, Prishtinë, 2013.

[184] Intervistë, Prishtinë, 21 janar 2015.

[185] gjashtë i parë i Marrëveshjes Bruksel 15 pikë marrëveshje me Komunitetin.

[186] Zyrtarët e Kosovës preferojnë "Asociacioni", me konotacione të një klubi të lirshëm ndër-komunal; Serbët përdorin "Komunitetin" për të nënkuptuar një trup rajonal. BE-ja, me dykuptimësi karakteristike, i përdor të dy termat në projekt-tekstin, duke iu alternuar radhitjen. Në këtë raport, ne përdorim "Asociacioni" për të shkurtuar tekstin që përfaqëson Asociacionin / Komunitetin e komunave me shumicë serbe, por edhe për ta dalluar në shkrim, nga Asociacioni ekzistues i Komunave të Kosovës. Shih blogun e Grupit të Krizave, "Marrëveshja Kosovë-Serbi: Pse pak është më shumë", 7 maj 2013.

Gjatë fushatës zgjedhore lokale në vitin 2013, Asociacioni u portretizua si një ilaç për të gjitha të këqijat, i modeluar sipas Republika Srpska në Bosnjë, me sloganin "sot ne votojmë për [listën] 'Srpska', nesër ndërtojmë [Republika] Srpska". Megjithatë, zhgënjimi është duke marrë dhenë ndërsa në të vërtetë ndërtimi i Asociacionit nuk është asgjëkund.[187] Prishtina e konsideron si gjë shumë të parëndësishme, i ngjashëm me Asociacionin ekzistues të Komunave të Kosovës, dhe shqetësohet se çdo gjë më shumë se kaq, do të mund të rrezikonte sistemin e vetëqeverisjes lokale.[188] Disa serbë, të përjashtuar nga procesi i integrimit aksidentalisht apo sepse kanë zgjedhur vetë, e pranojnë se Asociacioni nuk pritet të jetë më shumë se sa një "asociacion bletarësh", apo një "klub peshkimi, pra një vend ku të mund të mblidhen për të kaluar kohën.[189]

Autoriteti ekzekutiv dhe legjislativ në Kosovë,është i ndarë mes niveleve qendrore dhe komunale, ndërsa çështjet gjyqësore dhe të brendshme, formojnë një nivel të tretë rajonal.[190] Qeveria e Kosovës shqetësohet se krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe mund të prishë harmoninë, të pengojë shtetin, dhe të rrisë tensionet mes serbëve dhe shqiptarëve. Po ashtu, ajo i frikësohet futjes së një niveli administrues të tretë, të përcaktuar etnikisht, i cili do të rriste rrezikun e ndarjes në të ardhmen. Serbët kërkojnë vetëm një entitet të ndërmjetëm që do t'i izolojë nga Prishtina, dhe do të ruajë lidhjet e tyre me Beogradin.

Afati kohor i integrimit është i paqartë. Serbia parapëlqen të lëshojë pe për aq hapa të vështirë sa të jetë e mundur, derisa Asociacioni të formohet, dhe më pas ta përdorë si një shtëpi në mes të rrugës drejt integrimit; Kosova dëshiron që më së pari të formojë komuna plotësisht të integruara.[191] Qeveria e re këmbëngul se duhet të zbatohen shumë marrëveshje të reja, përpara se të bëhen bisedime të tjera rreth Asociacionit. Këto përfshijnë integrimin e gjykatave dhe mbrojtjen civile, heqjen e "parkut të paqes" në Mitrovicën e Veriut, zbatimin e kodit telefonik ndërkombëtar, si dhe miratimin për buxhetet komunale.[192] Partitë shqiptare dhe serbe në koalicionin qeverisës të Kosovës, kanë nënshkruar një marrëveshje ku premtojnë se Asociacioni do të ndërtohet brenda pesë muajsh (fillimi i Majit 2015).[193] Por, të

[187] Intervistë, zyrtar serb, Gjilan, prill 2014.

[188] Asociacioni i Komunave të Kosovës është një trup koordinues i formuar në 2001 dhe që përfshin të gjitha komunat e Kosovës.

[189] Intervista, ish zyrtar serb, Zveçan, prill 2014.

[190] PK-ja ka 8 drejtori rajonale (Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Mitrovica Veriore, Pejë, Prizren), dhe janë 7 gjykata themelore (Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë , Pejë, Prizren); juridiksionet e tyre nuk përputhen. Secila komunë ka një stacion policie, dhe shumica e komunave kanë degët e gjykatës themelore.

[191] Shumë liderë serbë vendorë ndajnë preferencën e Beogradit; Intervistë, zyrtar komunal i Kosovës, Graçanicë, shtator 2014.

[192] Autoritetet e Mitrovicës së Veriut ngritën një "park paqeje" mbi urën kryesore mes Veriut dhe Jugut të Mitrovicës, menjëherë pas heqjes së një barrikade që kishte qëndruar gjatë atje; "parku" pengon trafikun e automjeteve. Intervistat me Zyrtarët e qeverisë dhe Kryeministrin Isa Mustafa, Prishtinë, janar 2015. Qeveria e Kosovës ka ngritur çështjen disa herë dhe është shumë e ndjeshme për simbolizmin e "parkut". Ata duan që ajo të hiqet para vazhdimit të dialogut, që ai të mos ruajë imazhin e ndarjes.

[193] Zyrtarë të lartë të qeverisë së Kosovës besonin se ky afat kohor ishte i arsyeshëm edhe para marrëveshjes së koalicionit; intervistë, Prishtinë, shtator 2014. Prishtina këmbëngul se para se të fillojnë bisedimet për Komunitetin, duhet të jenë shpërbërë të gjitha institucionet paralele serbe të sigurisë, si dhe të jetë themeluar gjykata e Mitrovicës së Veriut.

dyja palët janë shumë larg një-tjetrës në disa çështje që bartin ngarkesa emocionale. Vëzhguesit lokalë besojnë se diskutimet mund të shtyhen deri nga fundi i vitit 2015.[194]

Asociacioni është i rëndësishëm sepse Beogradi dhe Prishtina e zgjodhën si kornizë për zbatimin e pjesëve të Planit të Ahtisaarit. Nëse çdo gjë shkon mirë, ai do të jetë pjesë e tre proceseve të lidhur me njëri-tjetrin: largimi i serbëve nga Beogradi dhe integrimi i tyre në sistemin e Kosovës, pasi Serbia të mbyllë rrjetin e institucioneve të veta në territorin e Kosovës; sfidomi i qeverisë për të zbatuar pjesë të neglizhuara dhe të papëlqyera të Planit të Ahtisaarit për decentralizimin, të drejtat e minoriteteve dhe lidhjet me Serbinë; dhe ndihmesa për përmirësimin e marrëdhënieve Beograd–Prishtinë. Është fëmija që asnjë nga qeveritë nuk e do. Në mënyrë që ai të mbijetojë dhe të rritet, prindërit e vet duhet të shkojnë mirë mes njëri-tjetrit.

Një pjesë e pashkruar e Marrëveshjes së Brukselit – "shpirti" i saj – ishte se asnjë nuk do humbiste vendin e punës për shkak të integrimit.[195] Prishtina e ka pranuar në parim se zyrtarët në administratat komunale serbe do të mbanin pozitat e tyre (për aq kohë sa merreshin me kompetencat e tyre lokale) dhe thjesht të zhvendoseshin në sistemin e Kosovës. Po ashtu, ata ranë dakord të gjenin zgjidhje për pozitat e serbëve që nuk kishin ekuivalente në sistemin e Kosovës, siç është mbrojtja civile.[196] Zyrtarët e Kosovës debatojnë se ky shpirt mbulon vetëm një periudhë kalimtare, dhe vlen vetëm për ata që jetojnë dhe bëjnë punë të vërtetë në Kosovë.[197]

Statuti i Asociacionit duhet të ishte hartuar në verën e vitit 2013 dhe të miratohej menjëherë pas zgjedhjeve lokale në Nëntor, por nuk ndodhi asnjë nga këto.[198] Beogradi e margjinalizoi "ekipin menaxhues" prej 4 përfaqësuesish lokalë serbë, të cilët ishin të ngarkuar për ta hartuar atë, dhe të dyja qeveritë punuan drafte të papajtueshme, pa asnjë koordinim mes tyre. Prishtina e konsideron draftin e vet, bazuar edhe në Asociacionin ekzistues të Komunave të Kosovës (pak më shumë se një OJQ), si përafërsisht përfundimtar. Zyrtarët në Zyrën e Kryeministrit të Serbisë kanë përgatitur një draft në fshehtësi, dhe thonë se draftin e tyre për statutin e Asociacionit, ua kanë dorëzuar zyrtarëve të BE-së në Bruksel, në shkurt 2015, me synimin që të negociojnë kushtet e tij me ta, dhe jo me Prishtinën. Zyrtarët e BE-së mohojnë marrjen e një drafti të tillë.[199] Kjo mospërfillje ndaj Prishtinës është e kundërta e "normalizimit". Beogradi duhet të negociojë statutin e Asociacionit drejtpërdrejtë me qeverinë e Kosovës, dhe me një rol të fuqishëm për kryetarët e komunave.

Ndërsa disa vetë në Beograd e shohin Asociacionin si shumë autonom, të tjerë, me po atë pozitë të mirë, e përshkruajnë si një "embrion imagjinar të autonomisë", synimi i vërtetë i të cilit ishte të bindë serbët që të pranojnë institucionet e Kosovës. Një pjesë e hutimit mes serbëve, rrjedh nga mënyra se si Beogradi i është qasur bisedimeve, dhe si ka reaguar ndaj

[194] Intervistë, personeli ndërkombëtar i OJQ, Mitrovica e Veriut, Shtator 2014.

[195] Intervista, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, shtator 2014

[196] Intervistë, personeli ndërkombëtar i OJQ, Mitrovica e Veriut, Shtator 2014.

[197] Intervistë, zyrtar i lartë i qeverisë së Kosovës, Prishtinë, shtator 2014. Periudha tranzitore është koha e nevojshme për të zgjedhur dhe racionalizuar borderotë komunale.

[198] "Plani i Zbatimit" për Marrëveshjen e Brukselit, përfundoi më 23 maj 2013, nga qeveritë e Kosovës dhe Serbisë.

[199] Intervista, zyrtarë serbë, Graçanicë, nëntor 2014 dhe shkurt 2015; Intervistë telefonike, zyrtar i BE-së, Mars 2015; Vërejtjet nga zyrtari serb, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse tryezë të rrumbullakët, Stamboll, shkurt 2015.

presionit të dendur të BE-së. Në vend që të formulojnë një strategji të qartë dhe të bëjnë zgjedhje të vështira, udhëheqësit serbë përpiqen t'i shtyjnë çështjet e Kosovës për aq kohë sa të munden, por kur u thirrën në Bruksel, u përpoqën të gjenin opsionin "më pak të keq".[200] I shtrënguar nga vonesat në integrim të komunave dhe heqjen e strukturave paralele, Beogradi tregon shenja të mungesës së vullnetit për të çuar përpara normalizimin. Qëllimi i tij është të vonojë zbatimin sa më shumë të jetë e mundur.

Themelet ligjore

Baza ligjore për Asociacionin, është ligji i Kosovës dhe Marrëveshja e Brukselit. Nga këndvështrimi i Kosovës, si marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, kjo ka status si "pjesë e sistemit ligjor të brendshëm"; "ato dispozita të vetat të cilat janë të vetë-zbatueshme, janë me rend ligjor superior ndaj legjislacionit të Kosovës, ndërkohë që mbeten me rend ligjor inferior ndaj Kushtetutës".[201] Sipas marrëveshjes:

> Në pajtim me kompetencat e dhëna nga Karta Evropiane e Vetëqeverisjen Lokal, dhe ligjit të Kosovës, komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtën të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre, kolektivisht përmes Asociacionit. Asociacioni/Komuniteti, do të ketë mbikëqyrje të plotë në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.

Ky formulim kombinon gjuhë nga dy pjesë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (LVL): *partneritetet* komunale (Neni 29) dhe *asociacionet* komunale (Neni 32). Ndryshe nga asociacionet, partneritetet përfshijnë ushtrimin e kompetencave ekzekutive komunale.[202] Asociacioni i Komunave të Kosovës është një organ jo-ekzekutiv koordinues, por duke kopjuar gjuhën nga legjislacioni që administron si partneritetet komunale, ashtu edhe asociacionet, Marrëveshja e Brukselit i jep Asociacionit të drejtën të thirret në të dy tiparet e LVL-së. Në mënyrë specifike, ai i lejon komunat të ushtrojnë kompetencat përmes Asociacionit. Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale po ashtu i lejon autoritetet lokale të bashkohen "në ushtrimin e kompetencave të tyre, për të bashkëpunuar me dhe, brenda kornizës së ligjit, për të formuar konsorcium me autoritete të tjera lokale në mënyrë që të kryejnë detyra që janë të interesit të përbashkët."[203]

Si formë e partneritetit, Asociacioni do të ishte "i autorizuar të drejtonte marrëdhëniet me institucionet në Republikën e Serbisë," por deri në atë masë sa është e nevojshme; këto lloj marrëdhëniesh mund të përfshijnë "asistencë financiare dhe teknike, përfshirë personelin

[200] Intervista, zyrtarë të lartë serbë, Beograd , prill 2014.

[201] Gjykata Kushtetuese e Kosovës, gjykim, rasti nr. KO 95/13, më 9 shtator 2013 para. 52. Zyrtarët e BE-së besojnë se Marrëveshja e Brukselit tashmë ofron garanci për këtë arsye. Intervistë, Bruksel, tetor 2014. Zyrtarët e Kosovës janë penduar që kanë ratifikuar marrëveshjen, "ne duhet ta kishim miratuar atë vetëm në qoftë se Serbia do ta bënte të njëjtën ... ratifikimi ishte e vetmja mënyrë për të ndarë përgjegjësinë për një vendim të dhimbshëm të cilin PDK e kishte të pamundur ta bartte vetëm". Intervistë me zyrtar të PDK-së, Prishtinë, mars 2015.

[202] "Përgjegjësitë komunale ... mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale", të cilat mund të "marrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin dhe ushtrimin e bashkëpunimit funksional"; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale [LVL], nenet 29,1, 29,3. Shih gjithashtu Ligjin për Bashkëpunim Ndër-Komunal (04 / L-010).

[203] "Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale, Neni 10 (1), Këshilli i Evropës. Raporti shpjegues i Kartës thekson se kjo dispozitë ka për qëllim të mbulojë "bashkëpunimin ... në një bazë funksionale me qëllim që të kërkojnë efikasitet më të madh përmes projekteve të përbashkëta, apo kryerjen e detyrave të cilat janë përtej kapacitetit të një autoriteti të vetëm. Një bashkëpunim i tillë mund të marrë formën e krijimit të konsorciumeve ose federatave të autoriteteve. "

ekspert dhe pajisjet."[204] Marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe projektet i nënshtrohen shqyrtimit të qeverisë, dhe as komunat, as Asociacioni nuk mund të delegojnë përgjegjësitë e tyre tek një organ i huaj, dhe as t'i japin një entiteti të huaj të drejtën "për të ushtruar ndonjë kompetencë ekzekutive, administrative dhe legjislative".[205] Në praktikë, shumë "bashkëpunim" me Serbinë ka gjasa të bazohet në marrjen e parave nga buxheti, i cili i përket një pjese të asaj që Beogradi ka qenë duke shpenzuar për të mirëmbajtur rrjetin e vet të institucioneve në territorin e Kosovës, pjesërisht i ridrejtuar për të financuar projekte të administruara nga autoritetet lokale, në interes të njerëzve.[206]

Ligji për bashkëpunimin ndër-komunal rendit disa forma përmes të cilave komunat mund të punojnë së bashku; institucionet publike dhe ndërmarrjet, si edhe partneritetet e përbashkëta publiko-private (Neni 9.1). Kjo nuk është një listë gjithëpërfshirëse e asaj që mund të bëjnë komunat përmes Asociacionit. Organet punuese janë të caktuara për të "rishikuar disa çështje" nën kompetencat komunale, me "të drejta dhe detyrime të rregulluara përmes marrëveshjes" (Neni 10). Organet administrative "kryejnë detyrën administrative dhe profesionale për të cilën [ishin] themeluar". Ato kanë një shef dhe një staf, buxhet dhe një ulëse (Neni 11). Institucionet publike merren me "arsimin, shëndetësinë, kulturën, mbrojtjen sociale dhe aktivitete të tjera sipas kompetencave të tyre dhe atyre të zgjeruara". Ato kanë një emër, ulëse, financa, organ drejtues, menaxher dhe trup mbikëqyrës (Neni 13).

Komunat individuale mund t'i caktojnë ndonjë komune tjetër mandat për disa përgjegjësi, por ligji duhet të ndryshohet për të lejuar që edhe Asociacioni të mund të bëjë një gjë të tillë. Kjo do t'i lejonte komunave me shumicë shqiptare që t'i jepnin Asociacionit përgjegjësinë për të siguruar shkolla në gjuhën serbe dhe shërbime të tjera, në rast se ata zgjedhin të tilla. Enklavat pranë komunave me shumicë serbe, mund të mbështeten në shërbimet e tyre, por mund të jetë e udhës që enklavat e izoluara, të shërbehen prej një pike të vetme kontakti brenda në Asociacion.

Marrëveshja e Brukselit thotë se Asociacioni i ri serb "do të krijohet në të njëjtat baza" si Asociacioni i Komunave të Kosovës. Statuti i vet, është një shembull i mirë i asaj që mund të bëjë Asociacioni serb. Ai ka statusin e një personi ligjor, ndaj mund të blejë, të ketë në pronësi dhe të shesë prona të luajtshme dhe të paluajtshme, të hapë dhe të shfaqet në raste ligjore (Statuti i AKK, Neni 2.1, Subjekti ligjor). Ai mund të marrë fonde prej komunave, qeverisë qendrore ose jashtë (Neni 6.1.3); të themelojë dhe të vërë në funksion institucione publike (p.sh, teatro, akademi), të hapë zyra përfaqësuesish jashtë (Neni 3.2.8) dhe të miratojë simbolet e veta (4.14.8). Ka dy organe udhëheqëse kryesore: një Kuvend me anëtarë të

[204] LVQ, nenet 30,7, 30,2. Kjo dispozitë është zhdukur nga Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal, i cili parasheh vetëm bashkëpunimin me "komunat e huaja dhe institucionet e qeverisë vendore", Neni 18.1. Ky nen duhet të ndryshohet për të qenë në përputhje me LVL dhe Planin e Ahtisaarit.

[205] Ligji për Bashkëpunimin ndër-komunal, neni 18.3.

[206] "LSG, Artikuj 30,7, 30,2. Kjo dispozitë është zhdukur nga Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal, i cili vetëm ofron për bashkëpunim me "komunat e huaja dhe institucionet e qeverisë vendore", Neni 18.1. Ky artikull duhet të ndryshohet për të qenë në përputhje me LVL dhe Planit të Ahtisaarit.

Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal, Neni 18.3.

"Grantet për autoritetet lokale nuk do të shënohen për financimin e projekteve të veçanta. Dhënia e granteve nuk do të heqë lirinë themelore të autoriteteve vendore për të ushtruar politika brenda juridiksionit të tyre," Karta Evropiane mbi vetëqeverisje Lokale, neni 9,7..

deleguar nga komunat anëtare, një këshill kryetarësh komunash, një president me rotacion, dhe një zëvendës, si dhe disa zyrtarë të tjerë dhe organe joformale.

Marrëveshja e Brukselit po ashtu siguron se "autoritetet qendrore" të Kosovës mund të delegojnë kompetenca shtesë tek Asociacioni (Neni 5).[207] Edhe pse qeveria aktualisht nuk ka plane të tilla, është e përkushtuar ndaj mundësisë, e cila krijon ndërlikime financiare. Sipas ligjit të Kosovës, "kompetencat e deleguara, në të gjitha rastet, duhet të jenë të shoqëruara nga financimi i nevojshëm."[208] Mund të jetë e nevojshme që të ndryshohet ligji për financat publike dhe menaxhim, për ta lejuar Asociacionin që për këtë qëllim, të marrë fonde drejtpërdrejt nga autoritetet.

Asociacioni nuk duhet të konsiderohet si një OJQ. Si një organizatë ndër-komunale e themeluar me ligj dhe sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, nuk bën fort kuptim që ai t'i nënshtrohet rregulloreve për OJQ-të. Ligji për Vetëqeverisje Lokale përfshin një klauzolë e cila lejon Komunitetin, si partneritet ndër-komunal, që të "ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të zbatuar dhe ushtruar bashkëpunim funksional".[209] Kjo klauzolë (dhe "mbikëqyrja e plotë" bashkë me dispozitat e delegimit) mund t'i japin hapësirë për t'iu përshtatur me nevojat në zhvillim të serbëve. Forma e tij përfundimtare, ka gjasa që të kërkojë periudhë prove dhe gabimi.

Për të përmbledhur sa më sipër, ligji i Kosovës dhe Marrëveshja e Brukselit, mund ta lejojnë Asociacionin të:

- Krijojë organe administrative, me staf dhe buxhet;
- Themelojë institucione publike në fushat siç janë: arsimi, shëndetësia dhe kultura;
- Zotërojë, blejë dhe shesë prona;
- Hapë zyra përfaqësimi jashtë;
- Hyjë në marrëdhënie kontraktuale dhe të paraqitet në gjyq;
- Ushtrojë kompetenca të tilla dhe përgjegjësi të komunave anëtare, siç lejohet me ligj, si dhe kompetenca të tjera të tilla si i deleguari i autoriteteve qendrore;
- Themelojë ndërmarrje publike dhe të përbashkëta publiko-private;
- Punësojë staf në kapacitete këshilluese, administrative, menaxheriale dhe të tjera, me kontrata të përhershme apo të kufizuara;
- Marrë fonde prej anëtarëve të vet, buxhetit qendror, donatorëve dhe Serbisë; dhe
- Marrë personel ekspert dhe burime të tjera nga Serbia.

Cilado qoftë trajta që do të marrë Asociacioni, duhet të jetë elastik dhe vullnetar. Të dhjetë komunat me shumicë serbe ka gjasa t'i bashkohen Asociacionit, por secili anëtar duhet të jetë i lirë të vendosë për të hyrë apo për të dalë ngas bashkëpunimi në projekte specifike.

[207] Marrëveshja nuk specifikon se për "autoritetet qendrore" të cilit vend bëhet fjalë, por një zyrtar i BE-së i përfshirë në bisedime, argumentoi se kjo dispozitë i referohet vetëm qeverisë së Kosovës; Intervistë, Bruksel, tetor 2014.

[208] LVQ, Neni 18.3.

[209] LVQ, neni 29.3; Ligji për Bashkëpunimin ndër-komunal përmban këtë gjuhë, e cila është marrë prej Planit të Ahtisaarit.

Arkitektura e Asociacionit

Edhe pse serbëve iu shit si një entitet i stilit boshnjak për t'i izoluar ata nga Prishtina, dhe Kosovës iu shit si një OJQ, Asociacioni duhet të rrënjoset në mënyrë pragmatike brenda rendit ligjor të Kosovës. Ekzistojnë tre mënyra në të cilat ai mund të bëhet më efektiv sesa Prishtina apo komunat individuale. Serbët mund të përdorin forumet e Asociacionit për të sheshuar pozicione konsensusi, koordinuar politikat dhe për të rritur ndikimin e tyre. Komunat anëtare mund të fitojnë ekonomi shkalle duke ushtruar përgjegjësitë e përbashkëta së bashku, përmes Asociacionit. Një detyrë e tretë, të paktën për disa vjet, mund të jetë që të lehtësojë tranzicionin drejt punësimit të qëndrueshëm në Kosovë duke ndihmuar projektet e punësimit për disa punëtorë të cilët do të dalin si tepricë kur të mbyllen institucionet e Serbisë, dhe duke ndihmuar në zhvillimin e projekteve që krijojnë vende pune dhe të ardhura.

Roli i tij politik mund të jetë më i rëndësishëm se pozita e vet ligjore, ose kompetencat formale. Një zyrtar serb i përfshirë në krijimin e tij, e konsideron si detyrën më jetike të tij "kohezionin e përfaqësuesve serbë" në Kosovë. Prishtina e urren këtë, por e pranon për sa kohë Asociacioni vepron në harmoni me ligjet e Kosovës. Asociacioni mund të strehojë një forum për udhëheqësit serbë në të gjitha nivelet, për t'u takuar dhe për të formuluar politika dhe strategji për çështje urgjente me interesa të përbashkëta.[210]

Ideja e Beogradit është që të përdorë Asociacionin për t'u dhënë serbëve të Kosovës peshë më të madhe politike, "dhëmbë për t'u ngrënë me Prishtinën."[211] Një udhëheqës i iniciativës qytetare Srpska shprehu një ide të ngjashme: Prishtina e kupton se "kur ne themi 'jo', po thotë 'jo' Serbia."[212] Megjithatë, kriza mbi privatizimin e Trepçës dhe dorëheqja e Aleksandër Jabllanoviqit, tregon se mbështetja e Beogradit, shpeshherë është e rrezikshme dhe i nxit serbët vendas të luftojnë me shqiptarët. Nëse shumica i konsideron serbët sikur po veprojnë si agjentë të Serbisë, tensionet janë të destinuara të rriten. Beogradi duhet të jetë mbështetës, por pa provokuar, dhe të tërhiqet sa më parë që të jetë e mundur, si dhe të lejojë përfaqësuesit vendas që të marrin drejtimin.

Asociacioni po ashtu duhet të shërbejë si kanal që lidh udhëheqësit lokalë dhe kryeqytetet, duke i ushqyer lidhjet e dobëta institucionale. Ai mund të ndihmojë udhëheqësit lokalë dhe të komunitetit që të shtyjnë para agjendën e tyre me përfaqësuesit në parlament apo qeveri. Udhëheqësit komunalë serbë, dikur merreshin me qeverinë e Kosovës përmes ndërmjetësimit të zyrtarëve ndërkombëtarë dhe kolegëve të partisë, por ato lidhje janë zbehur dhe po plasariten.[213] Ndërkaq, edhe pse asnjë entitet i vetëm nuk ka gjasa të marrë përsipër rolin e SLS-së, e cila ishte ura midis Prishtinës dhe enklavave serbe, Asociacioni

[210] Kryetarët e komunave, ministra, drejtues të partive dhe ndoshta individë të tjerë të shquar, të gjithë duhet të marrin pjesë, dhe në varësi të çështjes, udhëheqësit fetarë, biznesmenët, udhëheqësit e sindikatave dhe përfaqësues të shoqërisë civile, duhet të ftohen për të kontribuar. Ajo nuk duhet të dëmtojë zhvillimin demokratik të komunitetit dhe diversitetin e ideve dhe të subjekteve politike, por duhet të përqendrohet në zhvillimin, caktimin e politikave dhe të qëndrueshmërisë për komunitetin.

[211] Intervista, zyrtarë të lartë serbë, Beograd, 14 prill 2014. Disa liderë vendorë po ashtu vlerësojnë rolin e vendosjes së konsensusit. Intervistë, kryetar i një komune me shumicë serbe, Prishtinë, prill 2014.

[212] Intervistë, Leposaviq, shtator 2014.

[213] Për rolin ndërmjetësues të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), Shih Grupin e Krizave, "Lirimi i Kosovës," op. cit., p. 11.

mund të ndihmojë zyrtarët lokalë që të kapen pas zhvillimeve të rëndësishme në qeverinë qendrore, duke filluar nga mundësitë financuese, e deri tek rregulloret e reja.

Roli i Asociacionit në politikat kombëtare, është më pak i qartë. Marrëveshja e Brukselit flet për një "shikim të plotë" të katër fushave kryesore.[214] Disa zyrtarë serbë e interpretojnë këtë edhe sikur ajo përfshin një rol në institucionet qendrore në Prishtinë, dhe thonë se ish-shefja e politikave të huaja të BE-së, Catherine Ashton, e ka theksuar rëndësinë e kësaj.[215] Nuk ka bazë për këtë në ligjin e Kosovës. Serbët vendas në fakt shpresojnë që Asociacioni do t'i izolojë nga Prishtina, dhe do të bllokojë pikat e takimit mbi të drejtat komunale.[216] Ndërkohë që nuk ka konsensus rreth domethënies së "shikimit", zyrtarë të tjerë serbë besojnë se ai do të shtrihet deri në mbikëqyrjen e çështjeve të komunave anëtare.[217] Meqenëse Asociacioni është krijimi i anëtarëve të vet, dhe i merr kompetencat prej tyre, ai mund të shërbejë si mbrojtësi i tyre në Prishtinë, dhe si ekran i zbatimit në lidhje me politikat e dakorduara.

Në aspektin funksional, pika filluese duhet të jetë pranimi se asgjë e përfshirë në Marrëveshjen e Brukselit, nuk e tejkalon fushëveprimin e dispozitave të Planit të Ahtisaarit për të drejtat e komunitetit serb. Marrëveshja është për ri-rregullimin e dispozitave ekzistuese të ligjit të Kosovës, të bazuar mbi Planin e Ahtisaarit, dhe për t'i bërë ato më efektive. Asociacioni nuk do ketë kompetenca unike, por do të jetë organi përmes të cilit do të ushtrohen disa kompetenca komunale (dhe mbase edhe qendrore). Parimi udhëheqës, duhet të jetë që ai (asociacioni) do të ushtrojë ato kompetenca që kanë të bëjnë me interesat e përbashkëta të serbëve, dhe trajtohen më së miri në një vend, ndërsa komunat merren me çështjet lokale. Për secilën nga këto fusha, Asociacioni duhet të krijojë kolegjiume, ose departamente, krerët e të cilëve do të përbëjnë këshillin ekzekutiv nën drejtimin e përgjithshëm të kryetarit të Asociacionit dhe kuvendit të tij. Departamentet e mundshme, përfshijnë:

- Zhvillimi ekonomik lokal dhe rajonal: Asociacioni duhet të zhvillojë, promovojë dhe koordinojë projekte. Shumë komuna më të vogla, kanë mungesë të stafit të aftësuar për të përgatitur dokumentacione dhe do të përpiqen të vënë në lëvizje projekte joshëse.
- Arsimi: Asociacioni duhet të mbikëqyrë sistemin shkollor në gjuhën serbe, si dhe Universitetin e Mitrovicës.
- Kujdesi shëndetësor: Asociacioni duhet të mbikëqyrë kujdesin shëndetësor për serbët.
- Të drejtat e njeriut: Asociacioni duhet të ndihmojë serbët të cilëve iu janë shkelur të drejtat, përfshirë ata jashtë komunave anëtare. Mund të sigurojë shërbime ligjore falas, si dhe ndihmë gjuhësore, dhe të shpjerë rastet në institucionet gjyqësore dhe ekzekutive qendrore.
- Mirëqenia sociale: Asociacioni duhet të ofrojë shërbime, përfshirë ri-trajnimin, vendosjen në punë, mirëqenien sociale, etj.

[214] Marrëveshja e Brukselit, 19 prill 2013, pika 4. Katër zonat janë zhvillimi ekonomik, shëndetësia, arsimi dhe planifikimi urban dhe rural.

[215] Intervistë, zyrtar i lartë serb, Beograd, prill 2014.

[216] Intervista, udhëheqës i serbëve të Kosovës, Graçanicë, prill 2014.

[217] Intervista, zyrtarë të lartë serbë, Beograd, prill 2014. Zyrtarë serbë të institucioneve komunale në Kosovë, prill 2014.

- Kultura: Asociacioni duhet të themelojë institucionet, përfshirë teatro dhe kinema, dhe të mbështesë vendet e Kishës Ortodokse serbe (LSG, Neni 22).
- Financa dhe Administrata: Komunat anëtare mund të marrin para nga Serbia përmes një banke komerciale të regjistruar në Kosovë, me njoftimin tek thesari. Komunat mund të ndajnë një pjesë, ose të gjitha fondet për Asociacionin (Plani i Ahtisaarit, Shtojca III, Neni 11.1.2).
- Shërbimet publike dhe komunale: katër komunat e pjesës veriore, dhe mbase edhe ato lindore, duhet të krijojnë ndërmarrje publike për "furnizimin me ujë, trajtim kanalizimesh, menaxhim mbeturinash, rrugë lokale, transport lokal si dhe ngrohje lokale" (LSG, Neni 17.1.f.)

Arsimi dhe kujdesi shëndetësor, deri tani janë më të rëndësishmit e këtyre interesave të përbashkëta, ndaj dhe duhet të jenë në fokus të Asociacionit. Të dhjetë komunat me shumicë serbe kanë interesa të ngjashme me njëra-tjetrën. Ligji i Kosovës ua cakton menaxhimin e kujdesit dytësor shëndetësor vetëm tre komunave, ndërsa universitetin vetëm Mitrovicës së Veriut, dhe qeveria refuzon riorganizimin e këtyre kompetencave komunale.[218] Por Marrëveshja e Brukselit dhe ligjet e tjera të Kosovës, i lejojnë komunat të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre, përfshirë edhe këto kompetenca të shtuara.[219] Asociacioni me shumë efektivitet mund të mbikëqyrë ose menaxhojë institucione me rëndësi të përgjithshme, si universiteti dhe qendra shëndetësore në Mitrovicën e Veriut. Nuk ka nevojë që t'i kërkohet të dhjetë komunave që të parashtrojnë në Ministri të Arsimit të njëjtin plan-program serb. Komunat duhet të vendosin bashkërisht për vendndodhjen e objekteve të specializuara të shëndetit dhe arsimit. Shumica e këtyre detyrimeve tashmë bien mbi ministritë e arsimit dhe të shëndetësisë së Serbisë, të cilat duhet t'ua transferojnë komunave së bashku me fondet dhe ekspertët.[220]

Marrëveshja e Brukselit po ashtu i jep Asociacionit "shikim të plotë" të politikës së zhvillimit ekonomik dhe planifikimit rural dhe urban. Zhvillimi ekonomik lokal trajtohet më mirë në nivel komunal, por Asociacioni është një vend i mirë për të organizuar projekte zhvillimore rajonale. Në disa raste, kjo duhet t'i afrojë komunat me shumicë jo-serbe. Pesë prej gjashtë komunave serbe në jug tashmë marrin pjesë në projektin e turizmit "Rajoni Lindor", së bashku me gjashtë fqinjët me shumicë shqiptare.[221] Po ashtu, Asociacioni mund të bashkëpunojë me komunat në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, për shembull, duke sponsorizuar një konkurs vjetor për projekte zhvillimore.[222] Planifikimi rural dhe urban janë çështje lokale par excellence, dhe nuk është e qartë se pse partitë i dhanë një rol të tillë asociacionit.

Vendorët kanë më shumë shpresa prozaike, veçanërisht që Asociacioni do të thithte shumicën apo të gjithë institucionet dhe punonjësit e Serbisë. Qeveria serbe është burimi i parë për punësim për serbët e Kosovës (dhe shpesh i fundit) – lista e punëve përshkruhet më

[218] Intervistë, MAPL dhe zyrtarë të lartë qeveritarë, Prishtinë, shtator-dhjetor 2014.

[219] Neni 19.3 i Ligjit për LVQ siguron se "komunat që ushtrojnë kompetenca të shtuara komunale, mund të bashkëpunojnë me komuna të tjera për të siguruar shërbime."

[220] Komunat në Serbi janë përgjegjëse për krijimin e shkollave fillore dhe klinikave, por jo për punësimin apo menaxhimin e stafit të tyre; LVQ serbe, neni 20.

[221] Shih tourismeast.org.

[222] LVQ, Neni 30. Asnjë komunë me shumicë serbe nuk është në afërsi të Shqipërisë.

poshtë. Disa mund të transferohen në buxhetin e Kosovës, por shumë prej tyre jo. Disa pozita të dobishme nuk kanë pozita paralele në sistemin e Kosovës.[223] Serbët i tremben se humbja e menjëhershme e punës në qeveri, do të shkatërronte komunitetin e tyre, dhe shohin drejt Asociacionit për të marrë përsipër zgjidhjen e kësaj amullie. Sipas një versioni, komunat mund të marrin më shumë para nga Beogradi dhe të punësojnë punonjës për të punuar në komunat e tyre, duke ua lënë në dorë kryetarëve të komunave që të vendosin se çfarë vendesh pune do t'u japin.[224] Zyrtarët serbë dyshojnë se Asociacioni do t'u sigurojë mjaft burime për të marrë përsipër të gjitha financimet aktuale serbe, dhe se ende do të duhet të merren vendime të dhimbshme.[225]

Punësimi serb në Kosovë i ka rrënjët në përgjigjen e Beogradit për humbjen e kontrollit të në vitin 1999, si dhe në pavarësinë e vitit 2008. Ai është i hartuar nga synimet politike dhe jo nga efikasiteti apo qëndrueshmëria në mendje, por shumica e serbëve të Kosovës i besojnë atij, dhe nëse institucionet serbe do të mbylleshin shpejt, do të kishte humbje masive punësh, dhe mundësisht edhe emigracion. Kompanitë e shqiptarëve janë hezituese që të punësojnë punëtorë serbë, ose të lidhin kontrata me kompani serbe.[226] Serbët ende mbeten tepër të përjashtuar nga shumica e punëve në sektorin publik të Kosovës në kompanitë më të mëdha publike. Kjo mund të jetë një çështje humanitare në çfarëdolloj rrethane, por veçanërisht dëmtuese nëse do të koincidonte me përpjekjen për të pajtuar serbët me institucionet e pavarura të Kosovës. Serbëve iu nevojitet kohë që të largohen prej punëve të qeverisë dhe të gjejnë pozita të reja dhe të krijojnë biznese të reja.

Asociacioni mund të luajë një rol të dobishëm humanitar në këtë aspekt. Qeveria e Kosovës do që institucionet serbe të mbyllen shpejt për arsye politike, për shkak se ato cenojnë sovranitetin e saj. Ndërkohë që Serbia i mbyll ato, ajo mund të transferojë financimet në komunat dhe institucionet përkatëse, të cilat mund të marrin përsipër punësimin e punëtorëve të cilët nuk e kanë të lehtë të gjejnë punë të tjera. Kur kjo nuk është e mundur, stafi që jeton në Kosovë në mënyrë të përhershme dhe nuk merr rrogë nga një institucion kosovar, mund të punësohet përkohësisht nga Asociacioni në projekte të financuara përmes tij. Prishtina e konsideron të pamundur që Asociacioni të mund të punësojë njerëz jashtë organeve të veta, por mund të koordinojë dhe të ndihmojë komunat që të zhvillojnë projekte të cilat mund të angazhojnë, të paktën edhe përkohësisht, personelin e mbetur jashtë skemës së tranzicionit.

Përmbushja e kësaj, është një proces i ndërlikuar dhe kërkon shumë punë paraprake, durim dhe negociata. Nëse bëhet gabim, tensionet mes komuniteteve mund të rriten. Prishtina dhe Beogradi duhet të përfshijnë kryetarët e komunave serbe, si dhe një spektër të gjerë të institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe udhëheqës të komunitetit. Zbatimi i dispozitave të Marrëveshjes së Brukselit për Asociacionin, policimi dhe sundimi i ligjit – të gjitha të

[223] Intervista, anëtarë të Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 2014, zyrtar serb, Graçanicë, prill 2014.

[224] Intervista, kryetari i Ranillugut, Prishtinë, prill 2014

[225] Intervistë, zyrtar serb, Beograd, prill 2014.

[226] Sidoqoftë, numri i kompanive serbe është rritur gjatë viteve të fundit. Regjistrimi i biznesit në Graçanicë është dyfishuar në 2014. Një llogaritar nga Prishtina punon për tre kompani serbe nga Graçanica dhe disa kompani tregtare të përziera (me pronarë serbë dhe shqiptarë) në territorin e Fushë Kosovës. Intervista, zyrtar i Ministrisë së Tregtisë, dhe zyra e llogaritarit, Prishtinë, shkurt 2015.

fokusuara në nivel lokal – duhet të shkojnë paralel me masat e hartuara për të integruar serbët në nivelin qendror. Krijimi i Asociacionit nuk duhet t'i largojë serbët prej institucioneve të qeverisjes qendrore në Prishtinë.

Spektri i Ndarjes

Disa tipare të Asociacionit mund të duken si një shtresë e tretë qeverie e vendosur midis komunave dhe autoriteteve qendrore. Kjo do të kalonte të gjitha vijat e kuqe që ka skicuar Prishtina rreth procesit të decentralizimit dhe do të provokonte opinionin publik kosovar.[227] Diskutimet e pashmangshme të spektrit të Asociacionit, lidhen me Republika Srpska të Bosnjës (RS), por frika kryesore vjen nga politika tradicionale e Beogradit në përpjekje për të ndarë Kosovën dhe për të ndarë serbët nga shqiptarët.[228] Kjo frikë u shtua gjatë negociatave. Shqiptarët ndjenin se po bënin lëshime për asgjë, pa fituar asnjë njohje diplomatike. Zyrtarët shqetësohen se gjatë bisedave të "pafund", Serbia do të kërkojë gjithnjë e më shumë.[229] Në Prishtinë dhe në shumë kryeqytete, RS është një sinonim për separatizëm, një autonomi e rritur përtej çdo kufiri e cila rrezikon të vrasë shtetin bartës. Realiteti i Kosovës është me më shumë nuanca.[230] Serbët pozicionohen si një minoritet i vogël që jeton në enklava të shpërndara, gjë që e bën shumë të ndryshëm me Bosnjën, aty ku serbët përbëjnë më shumë se një të tretën e popullatës, me gjysmën e territorit.

Diplomatët thonë se Asociacioni nuk do jetë aspak i ngjashëm me RS.[231] Udhëheqësit lokalë serbë, ende e mendojnë RS-në si një pikë reference, edhe pse ata nuk janë dakord nëse duhet të synojnë për të arritur atë status. Disa besojnë se, eventualisht, Asociacioni do të bëhet një "RS e vogël".[232] Të tjerë, të ndjeshëm ndaj emrit të keq ndërkombëtar të entitetit boshnjak, e shmangin këtë krahasim.[233] "Ne nuk jemi të interesuar në kompetencat e shtetit si politikat monetare apo punët e jashtme, por ne kemi nevojë për kompetenca rajonale, siç i keni ju në të gjithë Evropën," tha një udhëheqës lokal serb me përvojë.[234] Politikanët kosovarë tremben se Asociacioni do të jetë një farë prej të cilës do të rritet një status më i madh serb.[235] Duke u siguruar që diskutimi rreth rolit të Asociacionit dhe të drejtave të serbëve është balancuar me normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe midis Kosovës dhe Serbisë, do të zbuste frikën e Prishtinës dhe do të pakësonte tensionet.

Beogradi e imagjinon Asociacionin sikur po rritet në një rajon evropian, edhe pse rajon i shkëputur. Ai citon si udhëzime projekt- Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Rajonale, së bashku me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, e cila përmendet haptas në

[227] Gjatë bisedimeve të Ahtisaarit, vijat e kuqe ishin "(1) asnjë autoritet nga Beogradi në zonat me shumicë serbe; (2) asnjë entitet i ndarë serb në Kosovë; dhe (3) jo administrim me tre-shtresa". "Statusi i Kosovës: Serbët dhe Kosovarët caktojnë vijat e kuqe për çështjet e decentralizimit të statusit", Ambasada e SHBA, Vjenë email (i paklasifikuar), 24 mars 2006, publikuar nga Wikileaks.

[228] Për një krahasim me RS dhe ZSO, shih Shtojcën B më poshtë.

[229] Intervista, anëtarë të Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 2014

[230] Grupi i Krizave, "Bosnja: Çfarë Dëshiron në të Vërtetë Republika Srpska?," 6 tetor 2011.

[231] Koment nga zyrtar i lartë i EEAS, Konferenca për Kosovën dhe Serbinë, Oksford, janar 2014.

[232] Intervistë, udhëheqës Serb, Mitrovica e Veriut, prill 2014.

[233] Intervistë, udhëheqës i lartë serb i Kosovës, prill 2014.

[234] Intervistë, anëtar i ekipit menaxhues, Leposaviq, nëntor 2013.

[235] Intervistë, anëtarë të lartë të qeverisë së Kosovës dhe Shoqëria Civile, Prishtinë, shtator – dhjetor 2014

Marrëveshjen e Brukselit.[236] Korniza Referencë e Këshillit të Evropës për Demokracinë Rajonale, e ka përcaktuar vetëqeverisjen rajonale si:

> Kompetenca ligjore dhe aftësia e autoriteteve rajonale, brenda kufijve të kushtetutës dhe ligjit, për të rregulluar dhe menaxhuar një pjesë të punëve publike të cilat janë nën përgjegjësinë e tyre, në interesa të popullsisë rajonale, dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit.[237]

Po ashtu, korniza u bën thirrje autoriteteve rajonale që të respektojnë "besnikërinë federale". Meqenëse autonomia rajonale është "në gjendje të rrezikojë strukturën e Shtetit", autoritetet rajonale duhet të "zbatojnë" besnikërinë "federale", dhe, kur ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, të frenohen nga marrja e hapave që mund të rrezikojnë drejtpeshimin e përgjithshëm strukturor, dhe dëmtojnë interesat e entiteteve të tjera përbërëse."[238] Beogradi dhe serbët dëshirojnë të mendojnë për Asociacionin si një autoritet rajonal, i cili do t'i ndajë nga pjesa tjetër e Kosovës, dhe do të funksionojë si një degë virtuale e shtetit serb brenda territorit të Kosovës. Por, Asociacioni, sipas ligjeve të Kosovës, dhe sipas Marrëveshjes së Brukselit, nuk është i planifikuar të jetë autoritet rajonal, dhe Prishtina është e vendosur që të mos lejojë rrezikimin e shtetit.

Kujdesi shëndetësor mund të bëhet pjesë e rëndësishme e ekonomisë serbe në Kosovë. Sistemi i Kosovës është i varfër. Shumë shqiptarë shkojnë jashtë për trajtim, shpesh në Shkup, por disa marrin shërbime në sistemin lokal serb ose në Beograd. Udhëheqja e re e Graçanicës planifikon të tërheqë investitorë për të hapur qendra të specializuara që janë nën pronësinë e të huajve si dhe mjete të evakuimit të shpejtë mjekësor. Ligji i Kosovës e lejon këtë: gjatë viteve të fundit janë hapur ndërtesa nën pronësi turke dhe maqedonase. Doktorët me bazë në Beograd, disa prej Spitalit Ushtarak i cili është shumë i respektuar, vizitojnë rregullisht Graçanicën për të kryer operacione.[239] Serbët nga pjesa lindore e Kosovës shkojnë në Vranjë për trajtim mjekësor. Të tjerë përdorin qendrën e Mitrovicës së Veriut, e pak prej tyre shkojnë në spitalin shqiptar në Gjilan.[240] Ata jetojnë vetëm 50-60km larg nga Shtërpca dhe Graçanica, ndërkaq një klinikë është ndërtuar edhe në Partesh.[241] Për të përmirësuar shërbimet dhe kostot, serbët duhet të marrin parasysh më shumë koordinim dhe specializim. Për shembull, Shtërpca mund të përqendrohet në ortopedi dhe në traumë, Graçanica, duke pasur parasysh doktorët e famshëm që jetojnë aty pranë, kardiologjinë dhe mjekësinë e brendshme. Ky është një rol që i takon Asociacionit.

---

[236] Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Rajonale, nuk është në fuqi, por Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës a miratoi si udhëzues në takimin e Utrehtit, në vitin 2009. Komunikim përmes E-mail, zyrtarë të lartë të Këshillit të Evropës, qershor 2014.

[237] Këshilli i Evropës, "Korniza referencë për demokracinë rajonale," 2011, p.15.

[238] Ibid., p.14 n.3.

[239] Intervistë, zyrtar serb, Graçanicë, prill 2014.

[240] Intervistë, kryetari i Ranillugut, Prishtinë, prill 2014.

[241] Klinika u ndërtua me mbështetjen e qeverisë së Prishtinës dhe BE-së. Qeveria e Serbisë dhuroi pajisjet, të cilat i inauguroi Kryeministri Vuçiq gjatë vizitës së tij në Kosovë, më 14 janar 2014, për ta promovuar vetëm si investim i Serbisë për serbët.

Përfundimi

Kosova dhe Serbia kanë bërë progres të prekshëm. Dalëngadalë po ndodh një tranzicion paqësor i pjesës veriore të Kosovës nga Serbia, në juridiksionin e Kosovës. Dy raundet e zgjedhjeve në Kosovë kanë sjellë udhëheqës të rinj serbë në pozita parlamentare dhe lokale. Serbët po ashtu kanë pozita të rëndësishme qeveritare. Kjo është arritur përmes seancave epike të negociatave që janë organizuar nga BE-ja, duke i dhënë procesit pak dramë. Por zbatimi i marrëveshjes së Brukselit ka ngecur keq që prej marsit 2014. Hapat e tjerë do të merren në terren; ato do të jenë më të rrëmujshme dhe më kërkuese. Bisedimet e Brukselit kanë krijuar një hapje historike, por suksesi apo dështimi i normalizimit midis Prishtinës dhe Beogradit, dhe i integrimit serb në Kosovë, varet nga vendime të panumërta të vogla që duhet të merren ende. Këto bisedime janë të cenueshme prej gjërave si, bojkoti i vazhdueshëm serb. Ky raport është përpjekja e parë për të vendosur në detaje këto detyra jetike.

Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë duhet të shfrytëzojnë vitin 2015 për të kompletuar integrimin e institucioneve serbe, dhe për të zgjidhur çështje që lidhen me to, përfshirë ato që mbetën jashtë prej raundeve të mëhershme të dialogut. Të dyja qeveritë duhet ta bëjnë prioritet këtë gjë, duke ndarë kapital politik dhe fonde për procesin, si dhe t'i caktojnë ministritë që të koordinojnë përpjekje multi-sektoriale. Për Kosovën, suksesi do të konsolidojë shtetin, duke forcuar institucionet e veta, dhe duke respektuar njësoj sundimin e ligjit prej dhe për shumicën dhe pakicën. Për këtë arsye, do të fitonte më shumë respekt ndërkombëtar dhe do të çonte përpara si agjendën e BE-së, ashtu edhe marrëdhënien me Serbinë. Për Serbinë, progresi nënkupton arratisjen nga qarku i përpjekjeve për të arritur qëllimet e veta duke frustruar dhe anashkaluar Prishtinën – një strategji e cila ka rekordin perfekt të dështimit. Integrimi do të sillte përfitime të vërteta për serbët në terren, ndërsa do të lejonte Beogradin që të fokusohej në problemet e veta, si dhe në bisedimet për hyrjen në BE.

Serbët, veçanërisht ata në pjesën veriore të Kosovës , janë ende hezitues ndaj integrimit, por mbështetja në vazhdimësinë e institucioneve serbe, është një politikë pa të ardhme. Ishte e mundur që të mbështeteshin tek institucionet paralele, për aq kohë sa mbështetja e Beogradit për ta ishte e fuqishme, por është e pakuptimtë të bësh një gjë të tillë, meqenëse Serbia ka filluar t'i shpërbëjë ato. Beogradi dërgon mesazhe të përziera, duke shkrirë disa institucione dhe duke mbajtur të tjerat, duke ushtruar presion mbi disa serbë për t'u integruar, ndërkohë që shkurajon apo parandalon të tjerët. S'është për t'u habitur që serbët vendorë janë të hutuar dhe të palumtur me atë që ka prodhuar dialogu Prishtinë-Beograd, duke besuar se ata mund të kishin bërë më mirë nëse do të kishin biseduar drejtpërdrejt me Prishtinën. Zyrtarët e zgjedhur prej tyre rrezikojnë të përsërisin këtë gabim duke mos bashkëpunuar me Prishtinën. Ata nuk duhet të presin për Beogradin por duhet të angazhohen drejtpërdrejtë me qeverinë e Kosovës, fuqizojnë administratën e tyre lokale, dhe të udhëheqin komunitetin e tyre që të luajë një rol në këto institucione. Zyrtarët serbë duhet të marrin rol aktiv në dialogun me Brukselin, aty ku duhet të mirëpriten si përfaqësues të komunitetit të tyre, pa bërë shamatë se në cilën anë të tryezës janë ulur.

Detyrat e menjëhershme në dialogun e ri janë, që të zhvillohet një afat kohor dhe një plan për tranzicionin e institucioneve serbe, si dhe shërbimeve në ato të Kosovës. Shumë prej tyre mund të zgjidhen shumë më efektivisht në nivel lokal se sa në seancat qeveri-me-qeveri në

Bruksel. Asociacioni i Komunave Serbe mund të jetë pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Duhet të bazohet në burimet e pasura që gjenden në ligjin e Kosovës dhe në Marrëveshjen e Brukselit, të interpretuar në dritën e nevojave të popullatës. Prishtina duhet të jetë bujare ndaj Asociacionit, i cili mund të bëjë shumë për të lehtësuar integrimin e popullatës së vet serbe. Beogradi duhet t'i rezistojë tundimit për ta bërë Asociacionin që të bëjë më shumë se ç'mundet; një organ ndër-komunal nuk duhet të detyrohet të mbajë peshën e mosmarrëveshjeve të akumuluara për statusin midis Serbisë dhe Kosovës, ose të sfidojë shtetin e Kosovës dhe funksionalitetin e tij.

Kjo punë duhet të fillojë me një inventar të institucioneve serbe, shërbimeve dhe punëve, me prioritet tek komunat, kompanitë publike, arsimin dhe shërbimet shëndetësore. Ky vit duhet të përdoret për të eliminuar pjesën e tepërt të administratës serbe. Jo të gjitha mund të bëhen gjatë vitit 2015, por vonesat e panevojshme mund të dëmtojnë normalizimin. Ngjarjet e kohëve të fundit treguan se sa shpejt tensionet mund të kalojnë në nivele të rrezikshme. Ky është momenti për një investim të vullnetit politik, dhe të parave. Ato mund të sigurojnë pjesë të mëdha fitimesh për të gjithë të interesuarit, dhe mbi të gjitha, për popullin e Kosovës, si për shqiptarët, ashtu edhe për serbët.

Shtojca A: Përllogaritja e Popullsisë Serbe

Popullsia totale e banorëve të Kosovës, përllogaritet të jetë rreth 1,820,631.[242] Deri tani, meqenëse kjo bazohet në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, paraqet numër të ulët të serbëve, shumë prej të cilëve nuk pranuan të merrnin pjesë. Popullata serbe mund të përllogaritet prej disa burimeve, përfshirë zgjedhjet komunale të nëntorit 2013 dhe ato parlamentare të majit 2014; një referendum jozyrtar në pjesën veriore të Kosovës në shkurt 2012; shifrat e regjistrimit në shkollat serbe; dhe numrat e përdorura nga OSBE-ja.

Saktësia e përllogaritjeve prej rezultateve të zgjedhjeve, varet nga disa supozime, ku më e rëndësishmja është se serbët kanë votuar thuajse në të njëjtën normë si qytetarët e Kosovës në përgjithësi. (Po ashtu, supozohet se të gjithë serbët, dhe vetëm serbët, kanë votuar thjesht për partitë serbe). Nuk dihet as norma e përgjithshme e votimit serb, as norma në secilën komunë, dhe me gjasë, ka një dallim të madh nga mesatarja e Kosovës. Dëshmi të pavërtetuara, sugjerojnë se serbët kanë votuar në norma paksa më të ulëta se mesatarja, për shkak se disa e kundërshtojnë legjitimitetin e institucioneve të Kosovës. Nëse është kështu, përllogaritja prej totalit të votave do të nën-përllogarisë vetëm paksa popullsinë serbe.

Votimet përmes postës nga Serbia, duhet të zbriten nga vota totale serbe. Në zgjedhjet lokale të 2013-ës, kandidatët serbë fituan 3,437 vota postare (të vlefshme); në 2014, kishte 8,629.[243]

Përllogaritja është e thjeshtë:

$P_s = T_s/V_k$

$V_k = T_k/P_k$

ku P është popullata, T është numri i votave të hedhura, dhe komponenti i poshtëm S tregon serbët dhe partitë serbe, ndërsa K tregon të gjithë Kosovën. V_k është fraksioni i banorëve të Kosovës të cilët kanë hedhur vota të vlefshme. Mbani mend se kjo nuk është e njëjta me pjesëmarrjen e votuesve, i cili është numri i votave, i zbritur nga numri i votuesve të pranueshëm.

Në pjesën veriore të Kosovës, pjesëmarrja në votim ishte shumë e ulët, duke pasqyruar mosbesimin e madh ndaj institucioneve të Kosovës. Sipas kësaj, përllogaritja përdor numrin e votave që në fakt janë hedhur në referendumin e vetëshpallur të shkurtit 2012, për pranimin e "institucioneve të së ashtuquajturës republikë e Kosovës". 26,725 në total vota janë hedhur në 4 komunat veriore bashkë, duke prodhuar (përmes pjesëtimit nga V_k prej 2013) një popullsi të përllogaritur prej 65,183 banorësh. Kjo u pjesëtua midis të katër komunave përmes përqindjeve të marra nga profilet komunale të OSBE-së.[244]

[242] Përllogaritje të ASK, dhjetor 2013.

[243] Për 2013, "Rezultatet e grumbulluara dhe statistikat - Me kusht dhe me postë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës; për 2014, "Rezultatet për Kosovë (më pas)", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës.

[244] OSBE, Profili komunal, Mitrovica / Mitrovica e Veriut (mars 2014) jep një popullsi prej rreth 22.530 serbë, të bazuar në të dhënat nga Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë në shkurt 2010. OSBE, Profili Komunal Leposaviq (mars 2014) citon administratën komunale për shifrat e saj prej rreth 18.000 serbë. OSBE, Profili komunal Zubin Potok (mars 2014) përdor të njëjtin burim për përllogaritjen e saj të 13.900 serbëve OSBE, Profili komunal Zveçan (mars 2014) citon faqen e internetit të komunës për një popullsi prej "mbi 16.000" serbësh. Krahaso raportin e Grupit të Krizave,... "Veriu i Kosovës: Sovraniteti në Praktikë", op cit, f.1 (vlerësuar 55.000 deri 65.000 serbët).

Në 2013, T_k ishte 746,729 dhe V_k ishte rreth 0.41. Jashtë katër komunave veriore, partitë serbe morën 36,520 vota; duke ia shtuar 26,725 votave të referendumit në Veri, dhe duke zbritur votat përmes postës, prodhohet një T_s prej 59,808. Popullsia e përllogaritur serbe, është vota pjesëtuar për V_k ose 145,820.

Përllogaritja përdor shifrat e zgjedhjeve lokale të vitit 2013 në vend të zgjedhjeve kombëtare të vitit 2014, për shkak se jashtë veriut, në të parat kanë marrë pjesë shumë më tepër serbë. E njëjta procedurë mund të përdoret për të nxjerrë përllogaritjet komunale. Në disa raste, gara lokale ishte shumë e ngushtë, dhe mund të ketë shtuar pjesëmarrjen në zgjedhje goxha përmbi nivelin mesatar; në këto raste, dhe në komunat ku partitë serbe kundërshtuan zgjedhjet vendore, përllogaritja në të vërtetë, përdor shifrat e vitit 2014. Ne nuk ishim në gjendje të identifikonim totalet e votave me postë për secilën komunë, dhe hamendësuam se ato u shpërndanë barabar në të gjithë popullsinë serbe. Mbase ky është një hamendësim i dobët, i cili shpie në mbi-përllogaritje në disa zona, dhe në nën-përllogaritje në zona të tjera.

Rezultatet jepen në Tabelën 2, ku 10 komunat me shumicë serbe janë me shkronja të pjerrëta, dhe 4 komunat veriore janë të nënvijëzuara.

Tabela 1

Komuna	Popullsia totale zyrtare	Popullata e përllogaritur serbe	Përllogaritja e OSBE-së për serbët
Gracanica	11,359	21,126	21,534
Mitrovica e Veriut	12,139	19,763	22,530
Leposavig	13,485	16,175	18,000
Zvecan	7,318	14,575	16,000
Zubin Potok	6,508	12,780	13,900
Shtërpcë	6,873	11,195	9,100
Novobërdë	6,923	7,097	5,802
Partesh	1,730	5,971	5,300
Ranillug	3,792	5,402	5,718
Gjilan	91,489	4,065	624
Kamenicë	35,261	3,586	3,019
Kllokot	2,651	3,109	3,800[245]
Obilig	22,106	2,932	2,880
Vushtrri	71,212	2,651	4,000
Prishtinë	207,477	2,084	2,000
Pejë	97,706	2,006	800
Lipjan	59,196	1,803	2,000
Istog	40,126	1,502	2,300
Prizren	182,450	1,417	237
Klinë	39,555	1,343	1,517
Rahovec	57,645	1,134	800
Fushë Kosovë	37,843	1,114	900
Ferizaj	111,842	879	64
Dragash	34,363	401	7
Gjakovë	96,161	339	17
Suharekë	61,352	310	2
Viti	47,775	264	280
Skënderaj	51,363	220	350
Podujevë	89,051	190	12
Mitrovica e Jugut	73,362	174	14
Gllogovc	59,990	57	2
Kaçanik	33,875	43	1

[245] OSBE-ja nuk jep përllogaritje për serbët, por citon një shifër të përgjithshme prej rreth 5,000 vetash, dhe një popullsi shqiptare prej 1,362.

Malishevë	56,481	38	0
Decan	40,548	28	15
Shtime	28,096	21	49
Hani i Elezit	9,613	19	0
Mamushë	5,688	5	0
Junik	6,225	2	0
Totali	1,815,606	145,820	143,574

Të dhënat e regjistrimit në shkolla ofrojnë një kontroll cilësie në lidhje me këto përllogaritje. Në komunën e Gjilanit, OSBE-ja raporton se rreth 545 fëmijë vijojnë shkollën serbe në nivelin parashkollor, fillor dhe dytësor. Në SHBA përllogariten rreth 5.83 persona për çdo fëmijë të moshës shkollore. Struktura demografike e Serbisë, është më e vjetër, me vetëm 16 për qind të popullatës nën moshën 15, në krahasim me 20 për qind që janë në SHBA. Duke bërë një korrigjim, dhe duke hamendësuar se serbët e Kosovës krahasohen me demografinë e Serbisë, dalin se duhet të jenë rreth 7.3 persona për çdo fëmijë në moshën shkollore. E njëjta përllogaritje sugjeron se në Gjilan duhet të jenë 3,970 persona, e cila përafrohet me përllogaritjen e bazuar në zgjedhjet, prej 4,289 personash. Në Mitrovicën e Veriut, 5,094 studentë sugjerojnë se ka një popullsi totale prej 37,186, shumë më tepër se përllogaritjet e zgjedhjeve prej 19,763. Mbase kjo mospërputhje mund të ndodhë për shkak se shkollën serbe e vijojnë edhe fëmijë të tjerë që nuk janë shqiptarë. Sidoqoftë, tre komunat e tjera veriore kanë më pak studentë se sa sugjerohet nga përllogaritja e popullatës, ndërsa në të gjithë rajonin, përllogaritja e bazuar në shkolla është shumë pranë me shifrat e bazuara në zgjedhje. Prindërit e fëmijëve në moshë shkollore në veri mund të grupohen në Mitrovicë, ose t'i dërgojnë fëmijët në shkollë atje. I njëjti efekt ka gjasë të ndodhë në disa zona të pjesës jugore të Kosovës , ku shkollat serbe janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë.

Tabela 2

Komuna	Studentë	Përllogaritja e bazuar në shkolla	Përllogaritjet e Grupit të Ballkanit	Përllogaritjet e OSBE-së
Mitrovica e Veriut	5,094	37,186	19,763	22,530
Zveçan	1,295	9,454	14,575	16,000
Zubin Potok	1,039	7,585	12,780	13,900
Leposaviq	1,703	12,432	16,175	18,000
Totali në Kosovës e veriut	*9,131*	*66,657*	*63,293*	*70,430*
Gjilan	545	3,970	4,289	624
Skenderaj	100	730	232	350
Novobërdë	1,779	12,987	7,488	5,802
Ranillug	1,335	9,746	5,700	5,718
Partesh	741	5,409	6,300	5,300
Graçanica	4,344	31,711	22,290	21,534

Shtojca B: Krahasimi midis RS dhe Asociacionit

RS	Asociacioni
Palë në Marrëveshjet e Dejtonit, një marrëveshje ndërkombëtare që përfundoi luftën e Bosnjës.	Krijuar nga Marrëveshja e Brukselit.
Ka kushtetutë të vetën.	Ka statut, më i ulët se legjislacioni vendor.
Degë e plotë ekzekutive: president, kryeministër, agjenci ekzekutive.	Nuk ka kompetenca të vetat; disa kompetenca komunale ushtrohen përmes tij.
Degë e plotë legjislative: Kuvend kombëtar dhe Këshillin e popujve.	S'ka legjislaturë.
Degë të plotë gjyqësore: gjykata komunale, gjykata e qarkut, gjykata e lartë dhe kushtetuese; autonomi gjyqësore (gjykatat e RS nuk i nënshtrohen gjykimeve të gjykatave të shtetit të Bosnjë dhe Hercegovinës, të cilat janë poshtë nivelit kushtetues).	S'ka sistem gjyqësor, s'ka mbivendosje midis ZSO dhe juridiksioneve të gjykatave themelore të Kosovës.
Forca të armatosura (të mbyllura sipas marrëveshjes).	Nuk e ka komponentin e sigurisë.
Forcë policore kryesore.	S'ka polici.
Autoritet të fortë mbi komunat (përfshirë miratimin e buxheteve komunale).	S'ka autoritet mbi komunat.
Territor kompakt (përveç Brçkos).	Territor i shkëputur.
Veto ekzekutive dhe legjislative mbi shtetin: shumica e akteve dhe ligjeve të shtetit kërkojnë miratimin e RS.	S'ka rol federal.
Merr pjesë në caktimin e kornizës së buxhetit të shtetit.	S'ka rol buxhetor.
Udhëheqje e zgjedhur drejtpërdrejt.	Udhëheqje e caktuar.
Pjesë të madhe të shtetit dhe prona të mbrojtjes.	S'ka prona të shtetit.
Autonomi fiskale.	S'ka autoritet për të vendosur tatime.
Sistem të veçantë të postës, telekomunikimit dhe mediave.	S'ka.

Shtojca C: Një Shënim për Emrat

Zgjedhja për emrat e vendeve, prej vitesh ka qenë çështje politike në Ballkanin perëndimor, ndaj lexuesve iu takon një shpjegim për zgjedhjen e bërë nga Grupi për Ballkan. Aty ku ekzistojnë emra të pranuar në anglisht, ne i përdorim ato. Zyrtarët e qeverisë së Kosovës e quajnë kryeqytetin Prishtinë, por kjo nuk është bërë ende shqiptimi zyrtar në anglisht, ndaj ne, në versionin anglisht, kemi përdorur termin Pristina, i cili është huazuar nga ambasadat e SHBA-së dhe Britanisë, dhe nga Komisioni Evropian. Disa burime qeveritare përdorin Kosova dhe të tjerë Kosovo; ne përdorim të fundit. Aty ku nuk ka emër në anglisht, ne përdorim versionin e komunitetit të shumicës, dhe japim emrin në gjuhën tjetër në kllapa vetëm herën e parë. "Veriu", "Jugu", "Lindja" dhe "Perëndimi" gjithmonë jepen në anglisht, ndërsa kualifikuesit e tjerë lihen në gjuhët origjinale. Ndaj, qytetet binjake mbi lumin Ibër janë Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut; disa serbë jetojnë në Obiliqin (me shumicë shqiptare) (Obilić), ndërsa disa shqiptarë banojnë në Novobërdë. Ne përdorim të njëjtën skemë për qytetet në Serbi, ndaj Presheva (Preševo) dhe Bujanoci (Bujanovac) janë emrat e përdorur për qytetet me shumicë shqiptare në Serbinë jugore. Janë shmangur emrat zyrtare të vendeve sipas Serbisë, për qytetet që janë jashtë kufijve të saj (p.sh. Kosovska Mitrovica për Mitrovicën e Veriut).

Në disa zona, Grupi për Ballkan niset prej praktikës së caktuar ndërkombëtare. Agjencitë ndërkombëtare zakonisht i referohen "shqiptarët e Kosovës" dhe "serbët e Kosovës" (ose "K-Serbët në gjuhën e folur), për t'i dalluar nga banorët e Shqipërisë dhe Serbisë; po ashtu, ata flasin për kroatë, boshnjakë dhe për serbë - boshnjakë. E megjithatë, popujt në fjalë nuk i përdorin këto terma, dhe mund t'i konsiderojnë fyese. Ne e respektojmë këtë ndjenjë, dhe shmangim kualifikimin gjeografik për termat e panevojshëm. Kështu, "Integrimi i serbëve në Kosovë" është thjesht për integrimin e komunitetit serb të Kosovës, dhe jo për serbët kudo qofshin, në institucionet e Kosovës. Po ashtu, shumë shqiptarë në Kosovë i referohen vetes si kosovarë, një term të cilin ne e përdorim në të njëjtin kuptim; ai i referohet vetëm popullsisë shqiptare të Kosovës.

Shqiptarët gjithmonë e quajnë organin ndër-komunal për të cilin është rënë dakord në Bruksel, si *asociacioni* ose *shoqata*, të cilat që të dyja përkthehen në "asociacion"; Serbët gjithmonë e quajnë *zajednica*, e cila përkthehet si "komuniteti" ose "bashkimi". Në versionet shqip dhe serbisht të raporteve tona, Grupi për Ballkan ndjek ato preferenca. Në anglisht, duhet të bëjmë një zgjedhje. Teksti i hartuar nga BE-ja bën dallim midis "association/community" dhe "community/association". Ky ishte një vendim i kuptueshëm, por nuk është më i përshtatshëm në një dokument analitik që synon të sqarojë dhe jo të ngatërrojë. Ne i referohemi si "Asociacioni i komunave serbe" ose thjesht "komuniteti".

Balkans Policy Research Group Îshtî nje grup i pavarur i analistÎve i bazuar nÎ PrishtinÎ, KosovÎ. Ne ofrojmÎ analiza dhe raporte nÎ njÎ rreth tÎ gjÎrÎ tÎ ndÎrtimit tÎ paqÎs dhe problemeve qÎ ndÎrlidhen me shtetndÎrtim, gjithmonÎ tÎ bazuara nÎ punÎn e detajuar nÎ terren. Stafi ynÎ ka pervojÎ disa vjeÁare nÎ organizatat ndÎrkombÎtare, qeveritare dhe jo-qeveritare. Raportimi ynÎ rigoroz, i detajuar dhe i paanshÎm Îshtî i publikuar falas nÎ ueb-faqÎn tonÎ.

QÎllimi i Balkans Group Îshtî qÎ tÎ ofrojÎ pÎr vendimmarrÎsit dhe publikun analiza kreative, origjinale dhe tÎ besueshme, me qÎllim qÎ tÎ kenÎ ndikim nÎ vendimet politike pÎr tÎ ndihmuar shtete e EvropÎs Juglindore (Ballkanin perÎndimor), tÎ zhvillojnÎ Demokraci tÎ fortÎ si dhe shtet dhe shoqÎri tÎ ndÎrtuara mbi bazÎn e ligjit.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in Kosovo

NORWEGIAN EMBASSY